BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2015

PRISHTINË, QERSHOR 2016

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA

CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2015

PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Bordit 11
Fjala hyrëse e Guvernatorit 13
Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit 15
Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2015 19
1. Përmbledhje ekzekutive 21
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik 25
3. Ekonomia e Kosovës 27
3.1. Sektori real 27
3.2. Çmimet 27
3.3. Regjistri i ndërmarrjeve 29
3.4. Sektori fiskal 29
3.5. Sektori i jashtëm 32
3.6. Sektori financiar 35
3.7. Projeksionet makroekonomike për vitin 2016 57
4. Mbikëqyrja, rregullimi dhe licencimi i institucioneve financiare 59
4.1. Kalimi nga Bazel I në Bazel II 59
4.2. Mbështetja për Likuiditet Emergjent 60
4.3. Mbikëqyrja e bazuar në rrezik për institucionet bankare 61
4.4. Sistemi Rregullativ i Raportimit të Mbikëqyrjes nga Jashtë 61
4.5. Korniza rregullative dhe procesi i licencimit 62
4.6. Manuali për likuidimin e bankave 64
4.7. Licencimi 65
4.8. Mbikëqyrja bankare 74
4.9. Mbikëqyrja e sigurimeve 74
4.10. Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare 75
4.11. Mbikëqyrja e pensioneve dhe tregut të letrave me vlerë 76
4.12. Parandalimi i pastrimit të parasë 76
5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun 79
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme 79
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive 83
5.3. Sistemi i Pagesave 86
5.4. Menaxhimi i Mjeteve 92
5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës 97
5.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar 98
5.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë 2015 99

5.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare 101
6. Zhvillimet e Brendshme 102
6.1. Auditimi i Brendshëm 102
6.2. Burimet njerëzore 103
6.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së 104
6.4. Teknologjia Informative 104
6.5. Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut 104
7. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar 106
7.1. Marrëdhëniet ndërkombëtare 106
7.2. Aktivitetet e Edukimit Financiar 107
7.3. Asistenca teknike 107
8. Pasqyrat financiare të BQK-së 109
9. Shtojca Statistikore 145
10. Referencat 171

LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambijentit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio)
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSFAE	Departamenti për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. Euroepan Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	General Directorate of European Statistics
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBR	Great Britain Pound
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index)
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës

KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Auto-Përgjegjësisë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NPL	Kreditë Joperformuese (angl. Non Performing Loans)
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtare i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (angl. Producer Price Index)
PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse (angl. Purchasing Power Parity)
PTK	Posta dhe Telekomi i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate)
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Riskut (angl. Risk Weighted Assets)
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SRK	Sistemi i Regjistrit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommuniacation
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
USD	United States Dollar
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E FIGURAVE

1. Shkalla e inflacionit në eurozonë ---- 25
2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së ---- 26
3. Norma reale e rritjes së BPV-së ---- 27
4. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor ---- 27
5. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë ---- 28
6. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit ---- 28
7. Lëvizja e çmimeve të importit ---- 28
8. Lëvizja e çmimeve të prodhimit ---- 29
9. Regjistri i bizneseve, ---- 29
10. Struktura e ndërrmarrjeve të reja ---- 29
11. Bilanci i llogarisë rrjedhëse ---- 32
12. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar ---- 32
13. Pranimet e remitencave ---- 33
14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve ---- 34
15. Struktura e aseteve të sistemit financiar ---- 35
16. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve ---- 35
17. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar ---- 36
18. Struktura e aseteve të sektorit bankar ---- 37
19. Asetet e sektorit bankar ---- 37
20. Struktura e letrave me vlerë ---- 37
21. Kreditë sipas sektorëve ---- 38
22. Kreditë sipas sektorëve ekonomik ---- 39
23. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike ---- 39
24. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit ---- 40
25. Vlera e depozitave në sektorin bankar ---- 40
26. Struktura e depozitave ---- 41
27. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ---- 41
28. Depozitat e afatizuara ---- 42
29. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita ---- 42
30. Normat e interesit në Kosovë dhe në vendet e rajonit ---- 43
31. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve ---- 43
32. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve ---- 43
33. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik ---- 44
34. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare ---- 44
35. Norma mesatare e interesit në depozita ---- 45
36. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje ---- 45
37. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare ---- 45

38. Performanca financiare e sektorit bankar ---- 46
39. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar ---- 46
40. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar ---- 47
41. Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në Kosovë dhe në vendet e rajonit ---- 47
42. Treguesii Mjaftueshmërisë së Kapitalit në Kosovë dhe në vendet e rajonit ---- 48
43. Asetet e sektorit pensional ---- 49
44. Asetet e kompanive të sigurimit ---- 50
45. Primet e kontraktuara dhe dëmet e paguara ---- 50
46. Treguesit e profitabilitetit të sektorit të sigurimeve ---- 51
47. Asetet e sektorit mikrofinanciar ---- 51
48. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar ---- 52
49. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas maturitetit ---- 52
50. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik ---- 52
51. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve ---- 53
52. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas maturitetit ---- 53
53. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar ---- 54
54. Struktura e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar ---- 54
55. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve ---- 55
56. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar ---- 55
57. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar ---- 56
58. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar ---- 56
59. reguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar ---- 57
60. Treguesit e kualitetit të portfolioskreditore të sektorit mikrofinanciar ---- 57
61. Struktura e sistemit financiar në Kosovë ---- 66
62. Numri i bankave, degëve dhe nëndegëve të bankave ---- 67
63. Shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe rrjetit të degëve/nëndegëve të bankave sipas regjioneve 68
64. Numri i siguruesve, degëve, nëndegëve dhe agjentëve të siguruesve ---- 68
65. Shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe rrjetit të degëve të kompanive të sigurimit ---- 70
66. Numri i institucioneve mikrofinanciare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve ---- 70
67. Numri i institucioneve financiare jobankare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve 71
68. Numri i zyrave të këmbimit nëpër vite si dhe shtrirja e tyre gjeografike në vitin 2015 sipas regjioneve ---- 71
69. Numri i ankesave ndaj institucioneve financiare ---- 72
70. Furnizimi me para të gatshme ---- 79
71. Pranimi i parave të gatshme ---- 79
72. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve ---- 80
73. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve ---- 80
74. Kartëmonedha euro të pranuara sipas denominimeve ---- 80
75. Monedha euro të pranuara sipas denominimeve ---- 80

76. Eksporti i parave të gatshme ---- 81
77. Importi i parave të gatshme ---- 81
78. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi ---- 82
79. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuara ---- 82
80. Furnizimi me kartëmonedha të reja ---- 82
81. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara ---- 82
82. Parate euro te falsifikuara te konfiskuara ne nivel te Kosoves ---- 82
83. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse ---- 84
84. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse ---- 84
85. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse ---- 84
86. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse ---- 84
87. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse ---- 85
88. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse ---- 85
89. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse ---- 85
90. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse ---- 85
91. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së ---- 86
92. Numri i transaksioneve në SEKN ---- 87
93. Vlera e transaksioneve në SEKN ---- 87
94. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN ---- 87
95. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN ---- 87
96. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre ---- 88
97. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre ---- 88
98. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SEKN ---- 88
99. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SEKN ---- 88
100. Numri i kartelave të debitit sipas llojit ---- 90
101. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit ---- 90
102. Numri i terminaleve ATM ---- 90
103. Numri i terminaleve POS ---- 90
104. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave ---- 91
105. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave ---- 91
106. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së ---- 93
107. Saldoja përfundimtare e mjeteve të investuara nga ana e BQK-së sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse ---- 93
108. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundë vit ---- 93
109. Norma e kthimit në depozita të investuara nga BQK dhe norma EURIBOR 1-mujor ---- 94
110. Norma e kthimit të investimeve në portolio dhe rreziku për dy periudhat gjashtëmujore ---- 94
111. Horizonti kohor mesatar i shprehur në ditë deri në maturim për dy kategoritë e plasmaneve ---- 94
112. Struktura e Letrave me Vlerë sipas afateve tëmaturimit ---- 95
113. Struktura e pjesmarrësve në ankande ---- 95

114. Normat mesatare vjetore të kthimit ---- 96
115. Ankandet e bonove të thesarit dhe obligacioneve qeveritare ---- 96
116. Numri i përdoruesve të regjistruar ---- 97
117. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së ---- 97
118. Numri i kredive të reja ---- 97
119. Numri i i kërkesave për raporte kreditore ---- 98
120. Struktura sipas edukimit ---- 103

LISTA E TABELAVE

1. Rritja reale vjetore e BPV-së në eurozonë ---- 25
2. Numri i institucioneve financiare ---- 35
3. Struktura e aseteve të sektorit bankar ---- 38
4. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar ---- 41
5. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar ---- 47
6. Numri i bankave, degëve dhe nëndegëve të bankave ---- 67
7. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe nëndegëve të bankave ---- 68
8. Numri i siguruesve, filialeve, degëve dhe agjentëve të siguruesve ---- 69
9. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve ---- 69
10. Numri i institucioneve mikrofinanciare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve ---- 70
11. Numri i institucioneve financiare jobankare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve 71
12. Numri i ankesave sipas viteve ---- 72
13. Numri i ankesave sipas institucioneve ---- 73
14. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave ---- 83
15. Niveli i depozitave klientëve kryesor ---- 85
16. Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive ---- 86
17. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SEKN ---- 89
18. Numri i llogarive ---- 91
19. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave ---- 92

Fjala e Kryetarit të Bordit

Të nderuar lexues,

Është kënaqësi e veçantë që në emër të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përmes Raportit Vjetor 2015 t'iu prezantoj tendencat e ecurive kryesore ekonomike gjatë vitit 2015 dhe aktivitetet e BQK-së drejt nxitjes dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar. Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, e konsideron publikimin e Raportit të saj Vjetor më shumë se sa përmbushje të një detyrimi ligjor dhe institucional, si një element thelbësor të transparencës i cili kontribuon në avancimin e komunikimit me lexuesit, e të gjitha profileve, si publik i gjerë, institucione të shoqërisë civile, analist, pjesëmarrës në tregun financiar, bartës i interesit në pronësi apo investitor potencial. Në këtë kuadër besoj se leximi i këtij Raporti do t'ju mundësojë të krijoni një ide të plotë mbi punën dhe arritjet e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2015.

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e suksesshme të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Në këtë kuadër Bordi i Bankës Qendrore të Republikës se Kosovës, në vitin 2015, ka punuar në drejtim të avancimit të përgjithshëm të shumë proceseve të rëndësishme që sigurojnë një funksionim, mbikëqyrje dhe përmbushje efektive të objektivave strategjike të BQK-së. Fokus kryesor ka qenë rishikimi i rregullativës aktuale ligjore, por edhe plotësimi i kësaj rregullative më akte të reja të nevojshme. Brenda këtij viti, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës se Kosovës ka aprovuar 18 rregullore te reja, në fushën e rregullimit te sektorit financiar, atë të pensioneve, pagesave dhe të bankingut qendror. Këto zhvillime kanë ndikuar në rritjen e performancës së institucioneve financiare duke rritur cilësinë e menaxhimit të rreziqeve, ruajtur mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetit, mbeshtetjen emergjente për likuiditet, cilësinë e përgjithshme te portofolit kreditore, te investimeve, dhe mbi te gjitha duke racionalizuar koston e ndërmjetësimit financiar. Avancimi i kuadrit rregullativ ka pasur për synim mbështetjen e integrimit evropian dhe përafrimin ligjor e rregullativ me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian në domenin e bankingut qendror.

Në funksion të avancimit të një qasje profesionale dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë mekanizmave qeverisës dhe llogaridhënës Bordi i BQK-së, në vazhdimësi ka mbikëqyr zbatimin e politikave si dhe përmbushjen e detyrave të Bankës Qendrore për tu siguruar se kjo po bëhet në mënyrë adekuate dhe në përputhje me kërkesat ligjore, standardet dhe praktikat më të mira të bankingut qendror. Bordi i BQK-së ka pasuruar edhe me tej kornizën e përgjithshme qeverisëse te BQK-se duke e mbështetur atë me një buxhet të përshtatshëm, duke mbikëqyrur vazhdueshëm ekzekutimin e tij, si dhe duke ruajtur pavarësinë financiare dhe operative të BQK-së.

Avancimi i kuadrit rregullativ të brendshëm në BQK ka qenë i orientuar drejt krijimit te një mjedisi efikas dhe efektiv te kontrollit te brendshëm. Fokusi kryesor ishte në përmbushjen e përgjegjësive për sa i përket menaxhimit të rrezikut të institucionit. Në këtë kontekst është aprovuar Politika për Menaxhimin e Rrezikut e cila përcakton parimet dhe udhëzimet e nevojshme për menaxhimin e rrezikut, përderisa Rregullat e Brendshme parashihet të adresojnë rreziqet specifike.

Rritja e cilësisë së raportimit financiar të BQK-së, rritja e analizave, statistikave, dhe publikimeve tjera ne funksion te një transparence me gjithëpërfshirëse shënoj progres gjatë vitit 2015.

BQK gjatë vitit 2015, ka vazhduar me bashkëpunimin e ngushtë me mekanizmat kyqe ndërkombëtare, si: Thesari dhe USAID-i Amerikan, Banka Qendrore Evropiane, Banka Botërore,

Fondi Monetar Ndërkombëtar, etj., duke e rritur kredibilitetin e BQK-së në arenën ndërkombëtare. Bordi i BQK-së, rëndësi të theksuar i ka dhënë adresimit dhe përmbushjes në mënyrë efikase dhe të duhur të rekomandimeve dhe këshillave të pranuara nga ana e këtyre mekanizmave.

Ruajtja e stabilitetit financiar në vend, për Bordin e BQK-së dhe në përgjithësi Institucionin vazhdon të jetë çështja më e rëndësishme ne agjendën e aktiviteteve te BQK-së. Sektori financiar i Kosovës, në vitin 2015, ka reflektuar qëndrueshmëri dhe rritje domethënëse. Kjo është e dukshme në të gjithë komponentët përbërës të kapitalit, profitabilitetit, likuiditetit dhe cilësisë se menaxhimit të rreziqeve. Gjithsejtë pasuritë arritën në nivel prej 4.9 miliardë euro, apo rritje vjetore prej 8.1 %. Kjo rritje reflekton kryesisht rritjen e pasurive të bankave komerciale që përkon me një rritje vjetore prej 6.3 %, përderisa gjithsej pasuritë në sektorin pensional u rriten për 13.1 %. Sektori bankar ka vazhduar te zvogëloj normat e interesit si në kredi ashtu edhe në depozita. Norma mesatare e interesit gjatë muajit dhjetor 2015 ishte 7.7 %, ndërsa mesatarja e interesit ne depozita ishte 1.2 %. Sektori bankar vazhdon te këtë cilësi të mire të portofolit kreditor me një normë te kredive jo performuese prej 6.2 % në dhjetor 2015, e cila ishte më e ulte se sa norma prej 8.3 % në dhjetor 2014.

Puna dhe angazhimi i madhë i personelit vendor përgjatë vitit 2015 si dhe përkrahja e pa hezituar e partnerëve ndërkombëtar janë sinkronizuar lehtësisht brenda kornizave të përcaktuara nga një vizion i qartë zhvillimi dhe promovimi të vazhdueshëm të sektorit financiar të vendit. Andaj, tërë aktiviteti dinamik, që shprehet përmes këtij raporti, është refleksion i përkushtimit të lartë të punonjësve të BQK-së, organeve të saja vendimmarrëse si dhe ndihmës së partnerëve ndërkombëtar në drejtim te ngritjes së vazhdueshme të cilësisë se BQK-së. Andaj, do të doja ta përmbyllja këtë fjalë hyrëse të raportit vjetor të BQK-së për vitin 2015, duke shprehur mirënjohje të thellë, për punonjësit e BQK-së, si dhe për të gjitha institucionet financiare për përkrahjen dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm dhënë BQK-së, si Thesari Amerikan, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Fondi Zhvillimor Gjerman, Banka Qendrore Evropiane dhe Bankat Qendrore te Rajonit.

Prof. Dr. Bedri Peci

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia globale gjatë vitit 2015 u karakterizua nga zhvillime më të favorshme, ku kontribut mjaft të rëndësishëm kishte rikuperimi i ekonomisë së eurozonës. Masat e lehtësimit sasior të ndërmarra nga Banka Qendrore Evropiane forcuan kërkesën e brendshme, e cila paraqiti shtytësin kryesor të rritjes ekonomike. Zhvillimet në eurozonë u reflektuan pozitivisht në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, të cilat në përgjithësi përshpejtuan ritmin e rritjes ekonomike. Presionet deflacioniste në Eurozonë vazhduan të jenë të pranishme edhe gjatë vitit 2015, duke parashtruar nevojën e vazhdimit të masave të lehtësimit sasior. Zhvillimet e çmimeve në eurozonë vazhduan të reflektohen edhe në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ku u regjistruan norma të ulëta të inflacionit.

Ekomomia e Kosovës gjatë vitit 2015, ngjashëm me zhvillimet në eurozonë dhe në vendet e rajonit, përshpejtoi ritmin e rritjes. Rritja e konsumit dhe investimeve të sektorit privat paraqesin faktorët me kontributin kryesor në rritjen ekonomike, përderisa norma e lartë e deficitit tregtar vazhdoi të ketë ndikim negativ në rritjen e ekonomisë së vendit. Mbështetja e lartë e ekonomisë në importe po vazhdon të diktojë në masë të madhe ecurinë e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, i cili në vitin 2015 u karakterizua me deflacion. Rritja e shpenzimeve buxhetore në linjë me kufijtë e përcaktuar nga rregulla fiskale, krahas rritjes së qëndrueshme të të hyrave buxhetore, vazhdon të mbajë deficitin buxhetor dhe borxhin publik në shkallë të ulët, gjë që reflekton stabilitet të financave publike në ekonominë e vendit. Kosova vazhdon të ketë një sistem financiar të shëndoshë, i cili përfaqëson një burim shumë të rëndësishëm të rritjes dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit.

Sektori bankar ka shënuar përshpejtim të rritjes së kredimit, veçanërisht për ndërmarrjet, duke shërbyer kështu si një burim i rëndësishëm i financimit të rritjes së investimeve private gjatë vitit 2015. Ndër sektorët me rritjen më të lartë të kredive të pranuara ishin sektorët e bujqësisë dhe prodhimtarisë, gjë që tregon për një orientim të kreditimit bankar drejt financimit të sektorëve potencialisht më produktiv të ekonomisë. Përshpejtimi i ritmit të rritjes së kreditimit reflekton përmirësimin e kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe rritjen e kërkesës për kredi nga ana e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare. Përmirësimi i kushteve të kreditimit për huamarrësit është realizuar përmes rënies së theksuar të normës së interesit në kredi, e cila tani ka zbritur në nivel të përafërt me mesataren e normës së interesit në vendet tjera të rajonit. Përshpejtimi i rritjes së kredive dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit për huamarrësit tregon se Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në lehtësimin e qasjes në financa, që paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për të pasur një zhvillim më të madh ekonomik. Krahas këtyre zhvillimeve, sektori bankar ka arritur të fuqizojë edhe më tepër qëndrueshmërinë e tij, duke zvogëluar më tutje normën edhe ashtu të ulët të kredive joperformuese, si dhe duke rritur nivelin e kapitalizimit.

Për sa i përket zhvillimeve në komponentët tjerë të sistemit financiar, investimet e fondeve pensionale regjistruan kthim pozitiv gjatë vitit 2015, por më të ulët krahasuar me vitin paraprak si rrjedhojë e zhvillimeve në tregjet globale financiare. Institucionet mikrofinanciare vazhduan zgjerimin e aktivitetit kredidhënës, duke shërbyer si një burim i rëndësishëm i financimit, sidomos për individët dhe ndërmarrjet e vogla. Zhvillime më pak të favorshme karakterizuan sektorin e sigurimeve, i cili gjatë vitit 2015 regjistroi një rënie të lehtë të vlerës së primeve të shkruara, përderisa performanca financiare e sektorit vazhdon të jetë e brishtë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2015 ka realizuar objektivat e saj që dalin nga Ligji mbi Bankën Qendrore, përfshirë objektivin e saj primar që ka për qëllim ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. Gjatë këtij viti, BQK-ja ka filluar zbatimin e Planit Strategjik për periudhën 2015-2019, që përcakton qartë shtegun e zhvillimit të kapaciteteve të këtij

institucioni në të gjitha fushat e veprimit të tij. Në kuadër të aktiviteteve më të veçanta, gjatë vitit 2015, BQK-ja i lëshoi licencën përfundimtare një banke të huaj për të operuar një degë të saj në Kosovë, si dhe licencoi dy kompani të reja të sigurimit, duke krijuar kështu kushtet për zhvillimin e mëtejmë të konkurrencës në sistemin financiar të vendit. Në funksion të sigurimit të stabilitetit financiar, BQK-ja ka realizuar ekzaminimin e bankave komerciale sipas qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Kjo paraqet edhe përmbushjen e njërit prej kritereve kryesore që dalin nga programi i nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Plotësimi dhe zhvillimi i kornizës rregullative të sistemit financiar ka vazhduar të jetë aktivitet i rëndësishëm i BQK-së, përmes së cilit po përcaktohen rregullat për sigurimin e një sistemi financiar të zhvilluar dhe stabil, si dhe po plotësohen kërkesat që dalin nga procesi i integrimit të vendit drejt Bashkimit Evropian. Po ashtu, në përputhje me kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, BQK-ja për herë të parë ka filluar raportimin e statistikave të bilancit të pagesave në Eurostat. Gjatë vitit 2015, BQK-ja ka vazhduar të realizojë me sukses edhe funksionet tjera të saj, duke i kontribuuar kështu zhvillimit të një sektori financiar efikas dhe të qëndrueshëm, i cili është në gjendje të mbështetë zhvillimin e mëtejmë të ekonomisë së vendit.

Bedri Hamza

Guvernator i Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit

Bordi i Bankës Qendrore

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e suksesshme të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim Bordi ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur më ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë. Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur gjithsej 16 mbledhje.

Bordi ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar sipas kërkesave dhe propozimeve nga Bordi Ekzekutiv si në vazhdim:

- Rregulloren për Kreditë Hipotekare
- Rregulloren për vlerësimin e Pronave të Paluajtshme
- Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit
- Rregulloren për Kliringun dhe Funksionimin e Llogarive për Shlyerje
- Rregulloren për Kërkesat Minimale të Sigurisë
- Rregulloren për Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative
- Rregulloren mbi depozitimin e aseteve si garancë, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetin
- Rregulloren mbi Kasafortën
- Rregulloren mbi Llogaritë Individuale të Pjesëmarrësve
- Rregulloren për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtaritë e IFJB-ve
- Rregulloren për përcaktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia
- Rregulloren për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për tërheqje të mjeteve nga Fondi Pensional i Kosovës për pjesëmarrësit me emigrim të përhershëm
- Rregulloren për mbështetje emergjente për likuiditet
- Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të bankave
- Rregulloren për kredi hipotekare rezidenciale
- Rregullohen për sistemin e numrave standard të llogarive bankare
- Rregulloren për shpërndarjen e mjeteve të kredisë për bankat
- Rregulloren për shpërndarjen e mjeteve të kredisë për IMF-të dhe IFJB-të

Bordi i Bankës Qendrore ka miratuar gjithashtu:

- Ndryshimin e pjesshëm të Strukturës Organizative
- Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2015
- emëroi "Deloitte Kosova sh.p.k" Auditor të Jashtëm të BQK-së

- Raportin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2014
- Raportin vjetor të BQK-së për vitin 2014
- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2014 dhe Raportin e Auditorit të pavarur
- Buxhetin të BQK-së për vitin 2016
- Vendimin për llogaritë nën përkujdesje
- Planin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2016
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të përmbushjes së stabilitetit financiar; dhe
- Çështje të tjera që janë në kompetencën e Bordit të Bankës Qendrore.

Me 31 dhjetor 2015 Bordi i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët si në vijim:

Bedri Peci, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore

Bedri Hamza, Guvernator dhe anëtar i Bordit të Bankës Qendrore

Behxhet Brajshori, anëtar

Nuhi Ahmeti, anëtar

Një pozitë vakante e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore.

Bordi Ekzekutiv

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 34 pika 3 Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori (kryesues i Bordit Ekzekutiv) dhe zëvendësguvernatorët.

Më 31 dhjetor 2015, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Bedri Hamza (Guvernator/Kryesues i

Bordit Ekzekutiv), Lulzim Ismajli (Zëvendësguvernator për Operacione Bankare), Fatmir Gashi (Zëvendësguvernator për Funksione të Përgjithshme) dhe Fehmi Mehmeti (Zëvendësguvernator për Mbikëqyrje Financiare).

Gjatë vitit 2015, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka mbajtur

25 takime.

Në kuadër të kompetencave të tij Bordi Ekzekutiv gjatë vitit 2015 ka rekomanduar Bordit të BQK-së si në vijim:

- Nxjerrjen dhe plotësimin e 18 rregulloreve;
- Miratimin e Pasqyrave Financiare dhe Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2014;
- Miratimin e Pasqyrave Financiare periodike për vitin 2015;
- Ndryshimin e pjesshëm të Strukturës Organizative të BQK-së;
- Miratimin e Vendimit për llogaritë nën përkujdesje; dhe
- Miratimin e Buxhetit të BQK-së për vitin 2016.

Gjatë vitit 2015 Bordi Ekzekutiv përveç nga sa u tha më sipër, në pajtim me legjislacionin në fuqi ka ndërmarrë edhe veprimet/vendimet si në vijim:

- Ka miratuar licencën për një bankë dhe ka miratuar zgjatjen e afatit të operimit të një zyre përfaqësuese të bankës së huaj;
- Ka miratuar licencën për dy kompani të sigurimeve dhe për dy ndërmjetësues të sigurimeve, ka miratuar kërkesën për ndryshim të emrit të dy kompanive të sigurimeve dhe kërkesën e ndërrimit të pronarëve të 1 kompanie të sigurimeve si dhe ka refuzuar një kërkesë për licencë për ndërmjetësues të sigurimeve;
- Ka miratuar licencën (regjistrimin) për dy institucione financiare jobankare;
- Ka miratuar plotësimin e Planit Strategjik të BQK-së 2015-2019 konform rekomandimeve të dala nga programi i bashkëpunimit në mes të BQK-së dhe Bankës Qendrore Evropiane;
- Ka nxjerrë/ndryshuar dhe plotësuar 14 akte juridike të brendshme ku përfshihen politika dhe rregulla të brendshme, manuale, procedura etj.;
- Ka nxjerrë dy udhëzime për institucionet financiare;
- Ka shqiptuar masa administrative ndaj gjashtëmbëdhjetë institucionet financiare;
- Ka miratuar ndryshimin e tarifave të sigurimit kufitar të autopërgjegjësisë;
- Ka miratuar ndryshim/plotësimin e tarifave të BQK-së.

Bordi Ekzekutiv ka ushtruar edhe detyra tjera në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Komiteti i Auditimit

Ne pajtim me nenin 62 te Ligjit nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Statutin e Komitetit të Auditimit, vepron edhe Komiteti i Auditimit.

Objektivat e Komitetit të Auditimit janë që të ndihmojë Bordin e Bankës Qendrore në lidhje me përmbushjen e përgjegjësive në relacion me veprimin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kontrolleve të brendshme, etikën afariste dhe qeverisjen transparente, si dhe për raportin financiar te BQK-së.

Komiteti Auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhet prej tre anëtarëve (dy anëtarë joekzekutiv të zgjedhur nga radhët e Bordit te Bankës Qendrore dhe një anëtar – ekspert i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).

Me 31 dhjetor te vitit 2015, Komiteti Auditimit përbehej nga këta anëtarë:

Prof. Dr. Bedri Peci, Kryetar i Komitetit te Auditimit;

Prof. Dr. Arben Dermaku, Anëtar i Jashtëm; dhe

Nuhi Ahmeti, Anëtar.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2015 ka mbajtur gjithsej 10 takime. Ne takimet e Komitetit janë trajtuar çështje të ndryshme te cilat kanë te bëjnë me fusha të cilat gjenden nën fushëveprimin e tij në kontekst të rishikimit. Komiteti i Auditimit, gjatë vitit 2015 ka zhvilluar një numër aktivitetesh, ndër të cilat:

- Ka shqyrtuar rezultatet e auditimit të prezantuara në raportet tremujore dhe vjetor të auditimit të brendshëm;
- Ka shqyrtuar Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2015 dhe 2016 të propozuar për aprovim në Bord të BQK-së;
- Ka shqyrtuar rezultatet e auditimit te jashtëm për periudhën 2014;
- Ka kontribuar në procesin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga vlerësues të jashtëm të pavarur dhe ka ndihmuar Mënaxhmentin në këtë drejtim;
- Ka përgatitur dhe dorëzuar në Bord të BQK-së raportin vjetor të Komitetit të Auditimit; si dhe
- Ka zhvilluar aktivitete të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë më fushëveprimin e tijë.

Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2015



1. Përmbledhje ekzekutive

Aktiviteti ekonomik global është rikuperuar gjatë vitit 2015, megjithëse me diferenca të dukshme në mes të rajoneve. Eurozona u karakterizua me zgjerim të aktivitetit ekonomik, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme, që në masë të madhe mund t'i atribuohet ndikimit pozitiv që kishin masat e programit të lehtësimit sasior të ndërmarrë nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Gjithashtu, çmimet e ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, që mbretëruan gjatë gjithë vitit 2015, janë përkthyer në rritjen e të ardhurave të disponueshme të konsumatorëve dhe rritjen e profitabilitetit të firmave në sektorë të caktuar të ekonomisë, duke nxitur kështu rritjen graduale të investimeve në eurozonë. Përforcimi i kërkesës së brendshme në eurozonë gjatë vitit 2015 është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik në këtë rajon u karakterizua me rritje, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme dhe përforcimi i kërkesës së jashtme.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit gjatë vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Sipas statistikave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për BPV-në tremujore, rezulton se ekonomia e Kosovës shënoi rritje përgjatë të katër tremujorëve të vitit 2015. Për tërë vitin 2015, vlerësimet e BQK-së janë se norma reale e rritjes së BPV-së ishte 3.5 përqind, ndërkaq për vitin 2016, parashikimet e BQK-së janë se norma reale e rritjes reale ekonomike do të arrijë në 3.7 përqind. Rritja ekonomike gjatë vitit 2015 u mbështet nga rritja e kërkesës së brendshme, përderisa neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike. Në kuadër të kërkesës së brendshme, rritja reale e BPV-së në vitin 2015 vlerësohet të ketë rezultuar nga rritja e konsumit dhe investimeve private, përderisa konsumi publik dhe investimet publike vlerësohet të kenë shënuar rënie. Rritja e kreditimit bankar si dhe rritja e flukseve hyrëse të transfereve nga jashtë në formë të remitencave dhe kompenzimit të punëtorëve kishin kontribut të rëndësishëm në rritjen e konsumit privat. Gjithashtu, rritja e pagave dhe pensioneve të sektorit publik në prill 2014 kishte efekt të plotë në vitin 2015, gjë që rezultoi në rritjen e të ardhurave të disponueshme në ekonominë e vendit. Në të njëjtën periudhë, rritja e IHD-ve dhe kredive të reja investuese ndikuan në përforcimin e pozicionit të investimeve private. Sipas qasjes së prodhimit, rritja ekonomike gjatë vitit 2015 ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e ndërtimtarisë, bujqësisë dhe furnizimit me energji elektrike.

Në linjë me zhvillimet në tregjet e jashtme, ekonomia e Kosovës u karakterizua me rënie të nivelit të çmimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit, deri në shtator 2015 ishte -0.6 përqind (0.5 përqind deri në shtator 2014). Kontributin kryesor në rënien e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në Kosovë në këtë periudhë e kishte rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit, që është rrjedhojë e rënies së çmimeve të naftës.

Gjatë vitit 2015, sektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 1.46 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.3 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore në vitin 2015 arritën vlerën prej 1.55 miliardë euro, një rritje vjetore prej 5.1 përqind. Rrjedhimisht, në këtë vit, buxheti i Kosovës regjistroi deficit të përgjithshëm prej rreth 112 milionë euro (143 milionë euro në vitin 2014). Deficitit i përgjithshëm sipas rregullës fiskale, ku janë zbritur shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura dhe shpenzimet e AKP-së, ishte rreth 78 milionë euro apo -1.3 përqind e BPV-së (-2.2 përqind e BPV-së në vitin 2014). Në vitin 2015, borxhi publik ka arritur në 748.9 milionë euro (28.5 përqind rritje vjetore), përderisa si përqindje e PBB-së ka arritur në 12.98 përqind (10.63 përqind në vitin 2014).

Ekonomia e vendit ka vazhduar të ballafaqohet me disekuilibër kundrejt sektorit të jashtëm. Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme ka ndikuar në rritjen e mëtejme të importit. Rritja e konsumit dhe investimeve në nëntë muajt e parë 2015 ka ndikuar në rritjen e importit, gjë që është përkthyer në rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse. Gjithashtu, në kuadër të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, me rënie u karakterizuan bilancet pozitive të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, shënuan rritje të mëtejme të bilancit të tyre që vazhdon të jetë pozitiv. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 501.8 milionë euro në vitin 2015 (rreth 8.8 përqind e BPV-së), një rritje vjetore prej 20.7 përqind. Remitencat e pranuara në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 752.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.5 përqind. Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të e pranuara në Kosovë u karakterizuan me një rritje të theksuar në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak. Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuara në Kosovë gjatë vitit 2015 arritën vlerën prej 324.4 milionë euro (151.2 milionë euro në vitin 2014).

Në vitin 2015, sistemi financiar u karakterizua me rritje të aktivitetit, kryesisht si rezultat i rritjes së shënuar në aktivitetin bankar dhe në sektorin pensional. Vlera e gjithsej aseteve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.91 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 8.1 përqind. Gjithsej asetet sektorit bankar në vitin 2015 arritën vlerën prej 3.39 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.3 përqind. Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga bankat komerciale shënoi një rritje vjetore prej 7.3 përqind, duke arritur në 2.02 miliardë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.70 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.5 përqind. Në vitin 2015, treguesit kryesor të profitabilitetit të sektorit bankar u përmirësuan si rezultat i rritjes së theksuar të profitit. Gjithashtu, gjatë vitit 2015, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit arriti në 19.0 përqind nga 17.8 përqind sa ishte një vit më parë, duke treguar kështu përforcim të mëtejmë të pozitës së kapitalizimit të sektorit bankar. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor u zvogëlua edhe më tutje si rrjedhojë e rënies së pjesëmarrjes së kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në 6.2 përqind, krahasuar me 8.3 përqind sa ishte në vitin 2014. Gjendje të kënaqëshme të qëndrueshmërisë së sektorit bankar shfaqi edhe pozicioni i likuiditetit, i cili vazhdon të jetë i fuqishëm.

Në vitin 2015, gjithsej asetet e kompanive të sigurimit që operojnë në vend arritën vlerën prej 152.7 milionë euro, një rritje vjetore prej 9.1 përqind. Vlera e gjithsej primeve të shkruara në vitin 2015 arrti në 80.0 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.6 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) shënuan një rritje vjetore prej 13.8 përqind dhe arritën vlerën 36.8 milionë euro. Sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 7.7 milionë euro në vitin 2015, krahasuar me humbjen prej 2.5 milionë euro në vitin paraprak.[1] Thellimi i humbjes ishte rrjedhojë e humbjes së shënuar në kuadër të aktivitetit të sigurimit jo-jetë, përderisa përformanca financiare e sigurimit të jetës ishte pozitive.

Sektori mikrofinanciar në vitin 2015 shënoi rritje të aktivitetit kredidhënës. Vlera e gjithsej aseteve të IMF-ve arriti në 119.7 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.0 përqind. Në vitin 2015, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 2.5 milionë euro (0.7 milionë euro në vitin 2014), rritje kjo që i atribuohet rritjes së përshpejtuar të të hyrave, përderisa shpenzimet u rritën me ritëm të ngadalësuar.

Fondet pensionale u karakterizuan me një performancë pozitive në vitin 2015. Vlera e gjithsej aseteve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) arriti në 1.23 miliardë euro në vitin 2015, që përkon me një rritje vjetore prej 13.1 përqind. Deri në fund të vitit 2015, kthimi në

[1] Të dhënat për sektorin e sigurimeve janë të bazuara në pasqyra financiare jo të audituara.

investime arriti vlerën prej 29.6 milion euro (ose 2.3 përqind), krahasuar me kthimin prej 66.7 milion euro (ose 6.3 përqind) në vitin 2014. Kthimi më i ulët i realizuar në vitin 2015 ishte pasojë e kthimit negativ nga investimet në sektorin e jashtëm veçanërisht gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015.

Në kuadër të aktivitetit të licencimit të institucioneve financiare, gjatë vitit 2015, BQK-ja aprovoi licencën përfundimtare për T.C. Ziraat Bankasi A.S. nga Turqia, për hapjen e degës në Prishtinë. Në këtë mënyrë, numri i bankave që operojnë në Republikën e Kosovës është rritur në 10, prej të cilave 4 janë filiala të grupeve të njohura bankare me origjinë të kapitalit nga Bashkimi Evropian, 4 janë degë të bankave të huaja, dhe dy janë banka me kapital vendor. Gjithashtu, në vitin 2015 janë dhënë dy licenca për kompani të sigurimeve, gjegjësisht kompanitë Scardian dhe Prisig, duke rritur numrin e kompanive të sigurimit në vend në 15.

Në funksion të një sistemi bankar stabil, gjatë vitit 2015 janë bërë ekzaminimet e bankave komerciale konform planit të paraparë. Në përputhje me praktikat ndërkombëtare në fushën përkatëse, vëmendje e veçantë i është kushtuar rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit, rrezikut të tregut dhe rreziqeve tjera, duke u bazuar në qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. BQK-ja edhe gjatë vitit 2015 është angazhuar në adaptimin e praktikave më të mira të mbikëqyrjes së sigurimeve, duke u bazuar në parimet e Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve dhe mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës së operacioneve të siguruesve ndaj publikut. Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, gjatë vitit 2015, BQK-ka ka vazhduar me ekzaminimet e rregullta edhe të fondeve pensionale dhe institucioneve tjera financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjegjësisht mbikëqyrja financiare, luan rol kyç në mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në Kosovë. Në këtë kontekst, nga prilli i vitit 2015 ka hyrë në fuqi rregullorja për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave. Gjatë vitit 2015, në BQK janë shqyrtuar rreth 442 ankesa të shfrytëzueseve të shërbimeve financiare (persona fizik e juridik), ku 221 ankesa kanë qenë të deponuara për bankat, IMF-të dhe IFJB-të, përderisa pjesa e mbetur prej 221 ankesave kanë qenë të deponuara për kompanitë e sigurimeve.

Në fund të vitit 2015, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Sigurimet, duke krijuar kështu bazën për avancimin e rregullimit të këtij sektori. Gjatë vitit 2015, BQK-ja ka aprovuar një numër të akteve të reja rregullative për mbikëqyrjen bankare dhe mbikëqyrjen e Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare, me qëllim të fuqizimit të mëtejmë të kornizës së përgjithshme rregullative dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare. Gjatë këtij viti, po ashtu është vazhduar me amandamentimin e kornizës rregullative për mbikëqyrjen e pensioneve në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për fondet pensionale. Në vitin 2015, në kuadër të funksionit për parandalimin e pastrimit të parasë (PPP), është funksionalizuar sistemi i monitorimit të transaksioneve. Qëllimi i realizimit të këtij aktiviteti është rritja e monitorimit të transaksioneve përmes sistemeve informative të BQK-së.

Ngjashëm me vitet paraprake, edhe gjatë vitit 2015, BQK-ja siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme për sektorin bankar për të mundësuar kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Ndër aktivitetet me rëndësi në fushën e sistemeve të pagesave gjatë vitit 2015 ishte fillimi i implementimit të sistemit të ri të pagesave (ATS). Në vitin 2015, në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) janë shtuar edhe dy institucione pjesëmarrëse, gjegjësisht "Ziraat Bank" dhe "Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës". Në vitin 2015, në SEKN janë procesuar rreth 9.8 milionë transaksione me vlerë totale prej afërsisht 7.5 miliardë euro. Krahasuar me vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve është rritur për 8.7 përqind, përderisa vlera e transaksioneve është rritur për 9.4 përqind. Edhe Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) ka shënuar progres gjatë vitit 2015, ku janë regjistruar 183

përdorues, si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare, përderisa hulumtimi mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor arriti në 602,642 hulumtime.

Në vitin 2015, të gjitha mjetet nën menaxhimin e BQK-së janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta dhe likuide. BQK realizoi kthime pozitive nga investimet, me ç'rast kthimi i realizuar ishte më i favorshëm nga investimet në depozita bankare në raport me kthimin nga investimet në letra me vlerë. Kriza e borxheve në Eurozonë ka bërë që letrat me vlerë qeveritare të jenë më pak të favorshme për investim në raport me depozitat bankare.

Në funksion të realizimit të objektivave të saj, BQK-ja ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë analizave rreth zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në vend si dhe analizave që kanë të bëjnë me vlerësimin e stabilitetit financiar dhe me aktivitetin e sistemit financiar të vendit. Përveç publikimeve periodike, BQK tashmë realizon në baza të rregullta edhe projeksionet makroekonomike, duke pasuruar kështu analizën për zhvillimet makroekonomike në vend dhe duke ofruar një pasqyrë mbi zhvillimet e pritura në ekonominë e vendit. Në vitin 2015, është arritur për herë të parë të publikohet Raporti i Mbingarkueshmërisë me Borxh, raport ky që mund të shërbejë si burim i rëndësishëm informacioni për BQK-në në procesin e vlerësimit të stabilitetit financiar dhe po ashtu mund t'i shërbejë edhe bankave në procesin e hartimit të politikave të tyre.

Gjatë vitit 2015, është bërë progres i madh në funksionin statistikor të BQK-së duke avancuar harmonizim e mëtejmë të statistikave sipas acquis. Këtë vit, për herë të parë, BQK ka filluar raportimin e të dhënave në Eurostat për bilancin e pagesave dhe statistikat e shërbimeve ndërkombëtare. Në përpjekje për të përmirësuar kualitetin e statistikave, BQK ka zgjeruar listën e mbulueshmërisë, duke futur në raportim institucione dhe kompani të reja në vitin 2015, si dhe ka avancuar sa i përket periodicitetit dhe shkurtimit të kohës së publikimit të statistikave.

BQK-ja ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucione të rëndësishme ndërkombëtare duke përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Botërore (BB) si dhe me institucione të tjera financiare ndërkombëtare si Banka Qendrore Evropiane (BQE), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), bankat qendrore të vendeve të rajonit dhe me institucione tjera me të cilat BQK-ja ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë vitit 2015, ka përfunduar programi i bashkëpunimit teknik të BQE-së me bankat qendrore të regjionit të Ballkanit Perëndimor, i cili kishte për qëllim përgatitjen e bankave qendrore të vendeve të regjionit për inkuadrim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Ngjarje tjetër e rëndësishme në fushën e marrëdhënieve me jashtë është edhe vazhdimi i programit të edukimit financiar dhe shënimi i Javës Ndërkombëtare të Parasë.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Norma reale e rritjes ekonomike në eurozonë në vitin 2015 ishte 1.6 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 0.9 përqind të shënuar në vitin 2014, gjë që tregon për përmirësim të mëtejmë të aktivitetit ekonomik krahasuar me vitin paraprak (tabela 1). Gjatë vitit 2015, rritja ekonomike në eurozonë është mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, që mund t'i atribuohet ndikimit pozitiv që kishin masat e programit të lehtësimit sasior të ndërmarrë nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Gjithashtu, çmimet e ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, që mbretëruan gjatë gjithë vitit 2015, janë përkthyer në rritjen e të ardhurave të disponueshme të konsumatorëve dhe rritjen e profitabilitetit të firmave, duke nxitur kështu rritjen graduale të investimeve në eurozonë.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së në vende të zgjedhura të Eurozonës

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Eurozona	-0.9	-0.3	0.9	1.6
Gjermania	0.4	0.3	1.6	1.7
Franca	0.2	0.7	0.2	1.2
Italia	-2.8	-1.7	-0.3	0.8
Austria	0.8	0.3	0.4	0.9
Spanja	-2.6	-1.7	1.4	3.2
Greqia	-7.3	-3.2	0.7	-0.2

Burimi: Eurostat (2016)

Në mesin e vendeve të eurozonës, rritje më të theksuar ekonomike kishin Gjermania, Franca dhe Spanja (Tabela 1). Në vitin 2015, ekonomitë në zhvillim si Kina, Rusia dhe Brazili u përballën me ngadalësim të rritjes së aktivitetit ekonomik. Zvogëlimi i kërkesës nga këto vende shkaktoi dobësim të pozicionit të neto eksporteve të eurozonës. Megjithatë, rritja e kërkesës nga vendet e zhvilluara si dhe dobësimi i valutës euro kundrejt valutave tjera ka neutralizuar deri në një masë ndikimin negativ nga vendet në zhvillim. Për vitin 2016, BQE-ja ka parashikuar rritje të BPV-së prej 1.4 përqind, një rritje më e ngadalëshme krahasuar me pritjet fillestare, si pasojë e dobësimit të rritjes ekonomike globale si dhe forcimit të valutës euro kundrejt valutave tjera.

Figura 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje



* Parashikim i BQE-së
Burimi: Eurostat (2016)

Sipas Eurostat-it, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në eurozonë në vitin 2015 ishte 0.0 përqind. Për vitin 2016, BQE parashikon se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë do të jetë 0.1 përqind (figura 1).

BQE-ja vazhdoi të mbajë të pandryshuar normën bazë të rifinancimit gjatë vitit 2015. Megjithatë, lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2015 ka ndikuar në rënien e normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në vitin 2015, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht -0.07 përqind nga 0.12 përqind në vitin 2014. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhë 12 mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.17 përqind në vitin 2015, nga mesatarja prej 0.48 përqind në vitin 2014 (figura 2).

Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2016) dhe BQE (2016)

Përforcimi i kërkesës së brendshme në eurozonë gjatë vitit 2015 është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik në këtë rajon u karakterizua me rritje, e cila u bazua në rritjen e kërkesës së brendshme dhe përforcimin e kërkesës së jashtme. Në vitin 2015, rritja reale e BPV-së në Ballkanin Perëndimor vlerësohet të ketë qenë rreth 2.4 përqind, përderisa për vitin 2016, FMN-ja parashikon një përshpejtim të rritjes mesatare të BPV-së në 3.2 përqind.

Çmimet e ulëta të naftës, energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare ndikuan edhe në nivelin e çmimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku norma mesatare e inflacionit, vlerësohet të ketë qenë 0.9 përqind në vitin 2015. Në kuadër të vendeve të rajonit, Shqipëria kishte shkallën më të lartë të inflacionit prej 2.2 përqind në vitin 2015, përderisa vetëm Kosova u karakterizua me deflacion prej 0.5 përqind. Për vitin 2016, për vendet në Ballkanin Perëndimor, FMN-ja ka parashikuar një rritje të normës mesatare të inflacionit në 1.7 përqind.

Gjatë vitit 2015, programi i lehtësimit sasior nga BQE dhe politika e lehtësuar monetare janë përkthyer në dobësimin e monedhës së euros kundrejt valutave kryesore. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan në vitin 2015 kundrejt vitit 2014 u zhvlerësua për 16.6 përqind. Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro u zhvlerësua për 9.3 përkatësisht 12.2 përqind. Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, në vitin 2015, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb për mesatarisht 3 përqind, përderisa është zhvlerësuar kundrejt kunës kroate dhe lekut shqiptar për 0.2 përqind.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real

Ekonomia e Kosovës në vitin 2015 ndoqi një ritëm të përshpejtuar të rritjes. Sipas vlerësimeve të BQK-së, vlera nominale e BPV-së në vitin 2015 ka qenë 5.73 miliardë euro, që paraqet një normë reale të rritjes prej 3.5 përqind (1.2 përqind në vitin 2014) (figura 3). Rritja ekonomike gjatë këtij viti ishte rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht konsumit privat dhe investimeve. Në anën tjetër, neto eksportet rritën ndikimin e tyre negativ në normën e rritjes ekonomike. Sipas qasjes së prodhimit, rritja ekonomike në vitin 2015 ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e ndërtimtarisë, furnizimit me energji elektrike dhe vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e hoteleve dhe restoranteve.

Sipas statistikave preliminare të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në tremujorin e parë të vitit 2015, BPV shënoi rritje vjetore prej 1.7 përqind, kundrejt rritjes prej 0.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në tremujorin e dytë 2015, ekonomia e Kosovës u karakterizua me një rritje më të shpejtë vjetore prej 4.7 përqind (rënie vjetore prej 1.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), përderisa në tremujorin e tretë 2015 rritja reale e BPV-së ishte 4.0 përqind (3.0 përqind në tremujorin e njëjtë të vitit 2014). Mbështetur në vlerësimet për rritjen e konsumit privat si dhe përforcimin e pozicionit të investimeve, për tremujorin e katërt të vitit 2015, të dhënat preliminare të ASK-së sugjerojnë se rritja reale e BPV-së ishte 5.0 përqind.

Figura 3. Norma reale e rritjes së BPV-së



* Vlerësim i BQK-së
Burimi: ASK (2016)

Rritja e kreditimit bankar si dhe rritja e flukseve hyrëse të transfereve nga jashtë në formë të remitencave dhe kompenzimit të punëtorëve rezultuan në rritjen e konsumit privat gjatë vitit 2015. Gjithashtu, rritja e pagave dhe pensioneve të sektorit publik në prill 2014 kishte efekt të plotë në vitin 2015, gjë që rezultoi në rritjen e të ardhurave të disponueshme në ekonominë e vendit. Në të njëjtën periudhë, rritja e IHD-ve dhe kredive të reja investuese kontribuan në përforcimin e pozicionit të investimeve private.

Figura 4. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

3.2. Çmimet

Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), në vitin 2015 është karakterizuar me deflacion prej 0.5 përqind, krahasuar me inflacionin prej 0.4 përqind në vitin 2014 (figura 4).

Rënia e nivelit të përgjithshëm të çmimeve është ndikuar nga rënia e çmimeve të shërbimeve arsimore për 22.6 përqind, shërbimeve të transportit për 7.5 përqind, shërbimeve të restoranteve dhe hoteleve për 2.1 përqind, rekreacionit dhe kulturës për 0.6 përqind dhe mjetet e komunikimit për 0.2 përqind. Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universiteteve publike, ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet rënies së çmimit të derivateve të naftës. Në anën tjetër, çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit u rritën për 6.5 përqind, si dhe çmimet e strehimit, ujit, rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse shënuan rritje për 1.6 përqind. Me rritje u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike të cilat ishin për 0.4 përqind më të larta krahasuar me vitin paraprak. Kjo kategori e produkteve përfaqëson rreth 40.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar (figura 5).

Figura 5. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit dhe indeksit të çmimeve të konsumit në Kosovë (figura 6).

Figura 6. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2016)

Çmimet e importit në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak shënuan rënie mesatare prej 1.0 përqind. Çmimet e produkteve minerale (kryesisht naftës dhe derivateve të saj), të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rënien më të lartë (15.6 përqind), pasuar nga çmimet e plastikës (5.2 përqind), metaleve bazë (4.0 përqind) si dhe mjeteve të transportit (1.7 përqind). Në anën tjetër, çmimet e produkteve bimore dhe vajrave ushqyese shënuan rritjen më të lartë të çmimeve (25.6 përqind përkatësisht 8.2 përqind), pasuar nga pajisjet e makinerisë (6.9 përqind) (figura 7).

Figura 7. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Indeksi i çmimeve të prodhimit në vitin 2015 shënoi rritje mesatare vjetore prej 2.7 përqind. Rritja e çmimeve të prodhimit ishte më e theksuar te çmimet e prodhimit të produkteve kimike, pastaj çmimet energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar, çmimet e

prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të prodhimit më së shumti ishte evidente te prodhimi i produkteve metalike, prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura, rënia e çmimeve të prodhimit të letrës dhe produkteve të letrës (figura 8).

Figura 8. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

3.3. Regjistri i ndërmarrjeve

Sa i përket regjistrit të ndërmarrjeve, është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në vitin 2015 ishte 9,833, që paraqet 429 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 2,205 ndërmarrje apo 534 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak (figura 9).

Edhe gjatë vitit 2015 numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara ishte në sektorin e tregtisë me 2,903 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimtarisë me 1,047 ndërmarrje, hotelerisë me 1,018 ndërmarrje dhe bujqësisë me 945 ndërmarrje (figura 10). Kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, sektori i bujqësisë ka shënuar rritjen më të lartë të ndërmarrjeve të regjistruara prej 271 ndërmarrje më shumë, pasuar nga tregtia ku është shënuar rritje prej 89 ndërmarrjeve si dhe sektori i prodhimit i cili ka shënuar rritje të ndërmarrjeve të regjistruara prej 69 sosh më shumë se sa në vitin paraprak. Në anën tjetër, në sektorin e ndërtimtarisë janë regjistruar 50 ndërmarrje më pak krahasuar me vitin paraprak, në sektorin e hotelerisë 16 ndërmarrje më pak dhe në sektorin e transportit 10 ndërmarrje më pak.

Figura 9. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2016)

Figura 10. Struktura e ndërrmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2016)

3.4. Sektori fiskal

Gjatë vitit 2015, sektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat buxhetore[2] në vitin 2015 arritën vlerën bruto prej 1.49 miliardë euro. Nëse zbriten 35.7 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto

[2] Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, pranimet nga privatizimi, të hyrat e dedikuara të AKP-së, pranimet nga grantet e përgjithshme të donatorëve, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

prej 1.46 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.3 përqind. Shpenzimet buxhetore[3] në vitin 2015 arritën vlerën prej 1.55 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1 përqind. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi deficit të përgjithshëm prej rreth 112 milionë euro, krahasuar me deficitin prej rreth 143 milionë euro të shënuar në vitin 2014. Deficitit i përgjithshëm sipas rregullës fiskale, ku janë zbritur shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë prej 29 milionë euro dhe shpenzimet e AKP-së në vlerë prej 6 milionë euro ishte rreth 78 milionë euro apo -1.3 përqind e BPV-së (-2.2 përqind e BPV-së në vitin 2014).

3.4.1. Të hyrat buxhetore

Struktura e të hyrave buxhetore në Kosovë dominohet nga të hyrat tatimore, të cilat gjatë vitit 2015 kishin një pjesëmarrje prej rreth 87.1 përqind në gjithsej të hyrat buxhetore ndërsa pjesa tjetër prej 12.9 përqind janë të hyra jo-tatimore. Të hyrat tatimore shënuan rritje për 9.2 përqind dhe arritën vlerën prej 1.27 miliardë euro. Sa i përket strukturës së të hyrave tatimore vërehet rritje e të hyrave të mbledhura nga tatimet e brendshme por edhe e të hyrave të mbledhura nga tatimet kufitare. Të hyrat e mbledhura nga tatimet vendore arritën vlerën bruto prej 332.8 milionë euro. Nëse zbriten kthimet e administratës tatimore prej 28.8 milionë euro atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore shënuan rritje prej 11.5 përqind dhe arritën vlerën neto prej 304.0 milionë euro. Të hyrat e mbledhura nga tatimet kufitare arritën vlerën bruto prej 951.8 milionë euro. Nëse zbriten kthimet e doganës prej 6.9 milionë euro atëherë të hyrat neto të mbledhura në kufi arritën vlerën prej 944.9 milionë euro apo 8.8 përqind më shumë krahasuar me vitin 2014.

Gjithashtu, të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 9.9 përqind dhe arritën vlerën prej 187.8 milionë euro. Në kuadër të të hyrave jo-tatimore, komponentët kryesorë janë të hyrat vetanake të komunave dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror. Të hyrat vetanake të nivelit qendror shënuan rritje prej 35.2 përqind dhe arritën vlerën prej 49.3 milionë euro, ndërsa të hyrat vetanake të komunave, përjashtuar tatimin në pronë prej 19.8 milionë euro, shënuan rënie prej 5.8 përqind dhe arritën vlerën prej 38.1 milionë euro.

Realizimi i të hyrave buxhetore shënoi përmirësim krahasuar me vitin paraprak. Niveli i realizimit ishte 96 përqind e planit për vitin 2015, që është për 6.8 pikë përqindje më i lartë se sa shkalla e realizimit në vitin 2014.

3.4.2. Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet rrjedhëse, që kryesisht përbëhen nga pagat e mëditjet, mallrat e shërbimet dhe subvencionet e transferet arritën vlerën prej 1.15 miliardë euro, që korrespondon me një rritje vjetore prej 9.2 përqind. Në anën tjetër, investimet kapitale, të cilat në vitin 2015 përfaqësuan rreth 26 përqind të gjithsej shpenzimeve, shënuan vlerën prej 403.9 milionë euro që paraqet një rënie vjetore prej 1.8 përqind.

Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, pagat e mëditjet dhe subvencionet e transferet shënuan rritje krahasuar me vitin paraprak, ndërsa mallrat e shërbimet shënuan rënie. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 8.2 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 525.0 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 15.8 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 418.1 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 0.2 përqind dhe kanë shënuar vlerën prej 205.5 milionë euro.

[3] Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat e kryegjësë së borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pagesat nga depozitat në mirëbesim.

Ekzekutimi i shpenzimeve buxhetore të planifikuara në vitin 2015 ishte rreth 95 përqind e planit (91 përqind në vitin 2014). Pagat e mëditjet si dhe subvencionet e transferet shënuan nivel më të lartë të realizimit krahasuar me planin (98 përqind secila kategori), ndërsa shpenzimet kapitale u realizuan në masën prej 88 përqind të planit krahasuar me shkallën prej 80 përqind të realizimit në vitin paraprak.

3.4.3. Borxhi publik

Borxhi publik, në fund të vitit 2015, ka arritur në 748.9 milionë euro që është për 28.5 përqind më i lartë krahasuar me vitin paraprak, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në 12.98 përqind nga 10.63 përqind sa ishte në vitin paraprak. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sipas vlerësimeve të FMN-së, mesatarja e borxhit publik në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2015 ka arritur normën prej 60.5 përqind të BPV-së. Borxhi i brendshëm i qeverisë, i cili në pjesën më të madhe është borxh në formë të letrave me vlerë ndaj bankave (67 përqind e gjithsej borxhit të brendshëm) dhe fondeve pensionale (25 përqind), arriti vlerën 377.8 milion euro në vitin 2015, një rritje vjetore prej 47.3 përqind. Në të njëjtën periudhë, borxhi i jashtëm i qeverisë shënoi një rritje vjetore prej 13.7 përqind, duke arritur vlerën prej 371.2 milionë euro. Përderisa në vitet e kaluara borxhi publik dominohej nga borxhi i jashtëm, në fund të vitit 2015 borxhi i brendshëm kishte pjesëmarrje më të lartë, duke përfaqësuar 50.4 përqind të gjithsej borxhit publik.

3.4.4. Tregu i letrave me vlerë të qeverisë

Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, gjatë vitit 2015 janë mbajtur 21 ankande për emetimin e letrave me vlerë, në vlerë nominale prej 398.6 milionë euro. Numri i përgjithshëm i ankandeve ishte i njëjtë me vitin 2014, ndërsa vlera nominale e emetuar ishte për 0.4 përqind më e ulët.

Gjatë vitit 2015, qeveria e Kosovës ka emetuar numër dhe vlerë më të vogël të bonove të thesarit krahasuar me vitin paraprak. Deri në dhjetor 2015, numri i bonove të thesarit të emetuara ishte 14 krahasuar me 17 deri në dhjetor 2014. Krahas rënies në numër, emetimi i bonove të thesarit tregoi rënie edhe në vlerë në 278.6 milionë euro nga 345.0 milionë euro sa ishte në dhjetor 2014. Në anën tjetër, emetimi i fletëobligacioneve shënoi rritje në numër dhe vlerë gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin paraprak. Deri në dhjetor 2015, u emetuan 7 fletëobligacione qeveritare në vlerë prej 119.95 milion euro krahasuar me 4 të tilla në vlerë prej 52.0 milionë euro deri në dhjetor 2014. Për më tepër, gjatë vitit 2015 për herë të parë janë emetuar tri obligacione qeveritare me afat maturimi 3 dhe 5 vite.

Që nga themelimi i tregut të letrave me vlerë në vitin 2012, shuma e ofertuar në shumicën e rasteve ka tejkaluar shumën e kërkuar (shpallur) në ankande nga Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Në dhjetor 2015, shuma e ofertuar ishte për 1.55 herë më e lartë se sa shuma e kërkuar (shpallur), krahasuar me vitin paraprak kur ky raport qëndroi në 1.36. Rritja e raportit ndërmjet shumës së ofruar dhe asaj të shpallur ishte rezultat i ofertimit më të lartë nga ana e pjesëmarrësve në ankande krahas shumës më të ulët të shpallur nga ana e qeverisë gjatë vitit 2015. Ky raport reflekton interesimin e lartë të subjekteve pjesëmarrëse në tregun e brendshëm në kushtet kur mundësitë për investime në letrat me vlerë të qeverive të huaja janë më pak atraktive si rezultat i normave të ulëta mbizotëruese në këto tregje.

Norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë vitit 2015 ishte më e lartë (1.94 përqind) krahasuar me vitin paraprak (1.57 përqind). Në rritje kontribuoi emetimi për herë të parë i obligacioneve 3 dhe 5 vjeçare, të cilat edhe bartin norma të interesit më të larta krahasuar me ato të bonove të thesarit. Norma më e lartë e interesit prej 4.9 përqind u regjistrua

në obligacionet me afat maturimi 5 vite, ndërsa norma më e ulët prej 0.6 përqind u regjistrua në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2015, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 182 dite u karakterizua me rritje, përderisa, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë shënoi rënie të lehtë. Ndërsa, norma mesatare e interesit në bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë dhe atyre me afat maturimi prej 2 vite nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin paraprak.

3.5. Sektori i jashtëm

Sektori i jashtëm në Kosovë u karakterizua me përkeqësim të pozicionit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak, përderisa në të njëjtën periudhë, pozicioni i llogarisë financiare u përmirësua. Llogaria rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2015 shënoi rritje të deficitit si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në këtë periudhë, bilanci pozitiv i shërbimeve u karakterizua me rritje.

Figura 11. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 501.8 milionë euro në vitin 2015, një rritje vjetore prej 20.7 përqind. Përkeqësimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse në masën më të madhe i atribuohet rritjes se deficitit në mallra për 2.5 përqind, si dhe rënies së shënuar në bilancet pozitive të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore prej 31.5 përkatësisht 1.9 përqind. Në vitin 2015, bilanci i llogarisë së tregtisë në shërbime u karakterizua me rritje vjetore prej 5.5 përqind (figura 11).

Deficiti i llogarisë së mallrave arriti vlerën prej 2.3 miliard euro në vitin 2015, që paraqet një rritje prej 4.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 12). Gjithsej eksportet në vitin 2015 arritën vlerën 325.3 milionë euro, që përkon me një rritje të dobët vjetore prej 0.2 përqind. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe i atribuohet rritjes së vlerës së eksporteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksporteve të pijeve dhe duhanit. Megjithatë, në vitin 2015, të gjitha kategoritë e mëdha të mallrave që eksporton Kosova u karakterizuan me rënie. Kategoria e metaleve bazë, që njëherësh ka pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej mallrat që eksporton Kosova (49 përqind), shënoi një rënie vjetore prej 5.8 përqind në vitin 2015. Gjithashtu, me rënie vjetore prej 6.9 përqind u karakterizua kategoria e produkteve minerale, që kanë një pjesëmarrje prej rreth 13 përqind në gjithsej eksportet e vendit. Përderisa rënia e vlerës së eksporteve të metaleve bazë në vitin 2015 më së shumti i atribuohet rënies së çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombëtare, rënia e

Figura 12. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në miliardë euro



Burimi: ASK (2016)

eksporteve të produkteve minerale gjatë kësaj periudhe i atribuohet rënies së eksportit të energjisë elektrike.

Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, në vitin 2015, arriti në 2.6 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 përqind. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e makinerive dhe pajisjeve elektrike, kategoria e metaleve bazë, kategoria e pijeve dhe duhanit, produkteve kimike si dhe kategoria e mallrave të plastikës dhe gomës. Në vitin 2015, me rënie të vlerës së importuar u karakterizuan produktet minerale. Përkundër rritjes së shënuar në sasinë e importuar të produkteve të naftës në vitin 2015, që përfaqësojnë nënkategorinë kryesore në kuadër të produkteve minerale, rënia e vlerës së importuar në këtë kategori ishte rrjedhojë e çmimeve të ulëta të naftës në tregjet ndërkombëtare.

Në kuadër të strukturës së importeve, pjesëmarrja e mallrave kapitale në vitin 2015 ishte rreth 9 përqind, kategori që u karakterizua me një rritje vjetore prej 9.1 përqind. Vlera e importit të mallrave të ndërmjetme është rritur në vitin 2015 për 2.5 përqind, përderisa vlera e importit të mallrave të konsumit gjatë kësaj periudhe është rritur për 4.3 përqind. Mallrat e ndërmjetme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të strukturës së gjithsej mallrave të importuara në vend (49 përqind), përderisa mallrat për konsum kanë një pjesëmarrje prej 36 përqind. Pjesëmarrja e mbetur prej rreth 6 përqind i takon mallrave të pa kategorizuara të importit. Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës në vitin 2015 vazhduan të mbesin shtetet e BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Si pasojë e rritjes më të shpejtë të vlerës së importeve në vitin 2015, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u zvogëlua në 12.3 përqind, nga 12.8 përqind sa ishte në vitin 2014.

Tregtia në shërbime u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv në vitin 2015. Bilanci i shërbimeve arriti vlerën prej 354.4 milionë euro, një rritje vjetore prej 5.5 përqind, që ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të eksporteve të shërbimeve kundrejt shërbimeve të importuara. Eksporti i shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 3.8 përqind, duke arritur vlerën prej 796.4 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e importit të shërbimeve shënoi rritje prej 2.5 përqind dhe arriti vlerën prej 442.0 milionë euro. Në kuadër të shërbimeve të eksportuara, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje vjetore prej 12.0 përqind në vitin 2015, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit si dhe kategoria e shërbimeve të biznesit u karakterizuan me rënie prej 29.4 përkatësisht 18.8 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, dy kategoritë kryesore të shërbimeve, gjegjësisht shërbimet e transportit dhe të udhëtimit shënuan rritje prej 47.3 përqind përkatësisht 12.2 përqind.

Figura 13. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2016)

Llogaria e të ardhurave parësore në vitin 2015 kishte bilanc pozitiv prej 78.0 milionë euro, i cili është për 31.5 përqind më i ulët krahasuar me bilancin e vitit paraprak. Bilanci më i ulët i të ardhurave parësore i atribuohet nivelit më të lartë të pagesave që kanë bërë ndërmarrjet e huaja në Kosovë tek investitorët, kryesisht në formë të dividentës. Të ardhurat e realizuara nga investitorët e huaj, në vitin 2015 kanë arritur në 119.2 milionë euro nga 74.4 milionë euro sa ishin në vitin paraprak. Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompenzimi i punëtorëve. Të ardhurat nga kompenzimi i punëtorëve, struktura e të

cilave dominohet nga të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit, arritën vlerën prej 210.3 milionë euro në vitin 2015, një rritje vjetore prej 1.8 përqind.

Në vitin 2015, llogaria e të ardhurave dytësore shënoi vlerën 1.1 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.9 përqind. Bilanci më i ulët i të ardhurave dytësore i atribuohet nivelit më të ulët donacioneve dhe granteve të ndryshme, si dhe reduktimit të shpenzimeve nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Në anën tjetër, remitencat e pranuara në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 752.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.5 përqind (figura 13). Remitencat që pranohen në Kosovë më së shumti vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 37 përqind përkatësisht 22 përqind të gjithsej remitencave të pranuara në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave në vitin 2015 është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 8 përqind e gjithsej remitencave të pranuara në Kosovë.

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Bilanci i IHD-ve në vitin 2015 ishte 287.3 milionë euro, që paraqet një rritje të lartë krahasuar me vlerën prej 123.8 milionë euro në vitin paraprak. Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuara në Kosovë gjatë vitit 2015 arritën vlerën prej 324.4 milionë euro (151.2 milionë euro në vitin 2014). Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit. Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 71.0 përqind të gjithsej IHD-ve, shënoi vlerën prej 243.7 milionë euro apo 109.1 përqind më shumë se sa në vitin paraprak. Normë më të lartë të rritjes (133.2 përqind) kanë shënuar edhe IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit të cilat arritën në 80.7 milionë euro në vitin 2015 (figura 14).

IHD-të në Kosovë janë të përqendruara në sektorët si patundshmëria (58 përqind të gjithsej IHD-ve), shërbimet financiare (20 përqind), ndërtimtaria (14 përqind), dhe industria (7 përqind). Në vitin 2015, pothuajse të gjithë sektorët janë karakterizuar me rritje sa i përket pranimit të IHD-ve. Vlera e investimeve në patundshmëri ishte më e lartë për 47.5 milionë euro krahasuar me vitin 2014, investimet në sektorin financiar ishin më të larta për 22.4 milionë euro. Edhe investimet në ndërtimtari dhe industri, të cilat në vitin 2014 patën shënuar tërheqje të kapitalit (blerje të disa kompanive të huaja nga pronarët vendorë), në vitin 2015 kanë shënuar rritje të konsiderueshme. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në vitin 2015 (72.9 milionë euro), pasuar nga Turqia me 57.8 milionë euro, Gjermania me 45.3 milionë euro, Shqipëria me 40.7 milionë euro, Austria me 33.5 milionë euro etj.

3.6. Sektori financiar

3.6.1 Karakteristikat e përgjithshme

Në vitin 2015, vlera e gjithsej aseteve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.91 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.1 përqind (7.3 përqind në vitin 2014). Sektori bankar dhe sektori pensional vazhdojnë ta kenë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend. Sektori i sigurimeve, pavarësisht zgjerimit të aktivitetit, kishte kontribut të vogël në rritjen e gjithsej aseteve të sistemit financiar. Ndërsa, asetet e sektorit mikrofinanciar dhe ndihmësve financiar kishin kontribut pothuajse neutral në rritjen e gjithsej aseteve të sistemit financiar.

Figura 15. Struktura e aseteve të sistemit financiar



Burimi: BQK (2016)

Struktura e aseteve të sistemit financiar në vitin 2015 vazhdoi të jetë e dominuar nga asetet e sektorit bankar, pasuar nga fondet pensionale (figura 15). Sa i përket numrit të institucioneve, gjatë vitit 2015, tregut financiar në vend i është shtuar një kompani e sigurimeve me kapital vendor (të cilës i është dhënë licenca). Po ashtu, gjatë vitit 2015 numri i ndihmësve financiar është rritur në 44 (42 në vitin 2014) (tabela 2).

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare[4]

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Bankat komerciale	9	9	10	10
Kompanitë e sigurimeve	13	13	14	15
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	38	39	42	44
Institucionet mikrofinanciare	17	17	18	18

Burimi: BQK (2016)

Figura 16. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Vlera e Aseteve të Jashtme Neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës në vitin 2015 arriti në 1.39 miliardë euro (1.37 miliardë euro në vitin 2014), që përkon me një rritje vjetore prej 1.3 përqind. Kjo normë e rritjes pasqyron një ngadalësim të dukshëm të rritjes së AJN-ve, krahasuar me vitin 2014, norma vjetore e rritjes ishte 32.3 përqind (figura 16).[5] Ky ngadalësim i normës së rritjes i atribuohet rënies së investimeve në tregjet e jashtme nga ana e sektorit bankar. Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej AJN-të vazhdojnë ta kenë fondet pensionale (rreth

[4] Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës.

[5] Në këtë kontekst, sektori financiar nuk përfshinë Bankën Qendrore.

78 përqind të AJN-ve), ndërsa pjesa e mbetur në masën më të madhe përbëhet nga AJN-të e sektorit bankar.

Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm në vitin 2015 arritën vlerën 1.65 miliardë euro (1.61 miliardë euro në vitin 2014), duke shënuar rritje vjetore prej 2.6 përqind, që paraqet një ngadalësim të theksuar të normës së rritjes në krahasim me rritjen vjetore prej 26.8 përqind[6] në vitin 2014. Në të njëjtën periudhë, detyrimet ndaj sektorit të jashtëm arritën vlerën prej 267.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.7 përqind (2.4 përqind në vitin 2014). Rritja më e lartë e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm erdhi si rezultat i përshpejtimit të rritjes së depozitave të jorezidentëve në bankat e vendit, të cilat shënuan rritje vjetore prej 28.0 përqind në vitin 2015 (0.2 përqind në vitin 2014).

Ekspozimi i sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm vazhdon të mbetet më i theksuar në kuadër të aseteve, krahas ekspozimit më të ulët në kuadër të detyrimeve. Më konkretisht, asetet e jashtme ndaj gjithsej aseteve të sistemit financiar në vitin 2015 kishin një pjesëmarrje prej 33.8 përqind, ndërsa detyrimet e jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sistemit financiar kishin një pjesëmarrje prej 5.5 përqind. Sa i përket sektorit bankar, asetet e jashtme përfaqësojnë 16.7 përqind të gjithsej aseteve, përderisa detyrimet ndaj sektorit të jashtëm përfaqësojnë vetëm 6.0 përqind të gjithsej detyrimeve.

3.6.2 Sektori bankar

Struktura e sektorit bankar në Kosovë në vitin 2015 ishte e ngjashme me periudhat paraprake. Sipas pronësisë, struktura e sektorit bankar vazhdoi të dominohet nga bankat me kapital të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 90.1 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga bankat me kapital vendor.

Figura 17. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar



Burimi: BQK (2016)

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin bankar ka vazhduar trendin rënës në asete dhe kredi, dhe po ashtu në depozita për dallim nga viti paraprak kur shkalla e koncentrimit të tregut në depozita kishte shënuar rritje. Rënia e koncentrimit në asete ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të aseteve të bankave më të vogla krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të aseteve të tri bankave më të mëdha (figura 17). Ndërkaq, rënia e shkallës së koncentrimit në depozita erdhi si pasojë e rënies së depozitave në dy nga bankat më të mëdha, krahasuar me rritjen më të lartë të nivelit të depozitave në bankat tjera.

Aktiviteti i sektorit bankar

Asetet

Sektori bankar në vitin 2015 zgjeroi vlerën e aseteve në 3.39 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.3 përqind (4.1 përqind në vitin 2014) (figura 18). Kontributin më të lartë në rritjen e aseteve të sektorit bankar e kishte zgjerimi i portfolios së kredive që vazhdon të jetë kategoria dominuese në strukturën e aseteve të sektorit bankar. Përshpejtimi i rritjes së

[6] Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria "paraja e gatshme". Kjo për faktin se euro në statistikat monetare dhe financiare konsiderohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve), mirëpo këto mjete janë në Kosovë.

aktivitetit të sektorit bankar reflekton edhe ecurinë e qëndrueshme të depozitave, të cilat po ashtu shënuan përshpejtim të ritmit të rritjes.

Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, rritjen më të theksuar vjetore prej 23.4 përqind e shënoi kategoria e letrave me vlerë (8.3 përqind në vitin 2014) (figura 19). Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kategorisë së letrave me vlerë në gjithsej asetet e sektorit bankar arriti në 14.0 përqind, nga 12.0 përqind sa ishte në vitin 2014. Zgjerimi i portfolios së letrave me vlerë gjatë vitit 2015 i atribuohet kryesisht rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, për dallim nga viti paraprak kur kontributin kryesor në rritje e kishin investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në vitin 2015, investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja u karakterizuan me rritje prej 29.4 përqind krahasuar me rënien prej 25.0 përqind të shënuar në vitin 2014. Ndërsa, investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 17.4 përqind, e cila paraqet rritje më të ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 92.6 përqind të shënuar një vit më parë. Kjo u reflektua edhe në ulje të pjesëmarrjes së letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës në 47.8 përqind, krahas zgjerimit të letrave me vlerë të qeverive të huaja në 52.2 përqind në gjithsej portfolion e letrave me vlerë të sektorit bankar në vitin 2015 (figura 20). Këto zhvillime mund të jenë rrjedhojë e ofertës më të ulët të Qeverisë së Kosovës për emetimin e letrave me vlerë krahasuar me vitin paraprak.

Figura 18. Struktura e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Figura 19. Asetet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Figura 20. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në po ashtu shënoi rritje të theksuar gjatë vitit 2015. Në vitin 2015, paraja e gatshme u karakterizua me rritje vjetore prej 9.9 përqind krahasuar me rënien prej 3.5 përqind të shënuar në vitin 2014. Rritja e kësaj kategorie reflekton rritjen e depozitave në sektorin bankar dhe po ashtu normat e ulëta të interesit, madje edhe negative, në tregjet ndërkombëtare të cilat kanë kufizuar mundësitë e bankave komerciale për investime në këto tregje. Këto zhvillime ndikuan edhe në zvogëlimin e bilancit me bankat komerciale, që përfshinë depozitat dhe linjat kreditore në bankat jashtë vendit. Kjo kategori regjistroi rënie vjetore prej 19.1 përqind në vitin

2015, gjë që shkatoi zbritjen e pjesëmarrjes së kësaj kategorie në 9.3 përqind të gjithsej aseteve në vitin 2015 (tabela 3).

Tabela 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	2012		2013		2014		2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	425.7	15.0%	463.3	15.1%	447.1	14.0%	491.2	14.5%
Bilanci me bankat komerciale	287.9	10.2%	339.9	11.1%	390.7	12.3%	316.0	9.3%
Letrat me vlerë	256.6	9.1%	354.5	11.6%	383.8	12.0%	473.5	14.0%
Kreditë bruto	1,763.4	62.3%	1,805.8	59.0%	1,882.4	59.1%	2,019.4	59.6%
Asetet Fikse	57.7	2.0%	55.5	1.8%	53.7	1.7%	57.3	1.7%
Asetet Tjera	38.1	1.3%	40.3	1.3%	27.9	0.9%	29.8	0.9%
Gjithsej	**2,829.3**	**100%**	**3,059.3**	**100%**	**3,185.6**	**100%**	**3,387.3**	**100%**

Burimi: BQK (2016)

Kreditë

Kreditë e sektorit bankar vazhduan të karakterizohen me rritje të përshpejtuar që nga viti paraprak. Në vitin 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.02 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.3 përqind (4.2 përqind në vitin 2014) (figura 21). Rritja e kreditimit gjatë vitit 2015 i atribuohet lehtësimit kushteve të kreditimit nga ana e bankave, të realizuar përmes uljes së normave të interesit, zgjerimit të shumës së kredisë si dhe afatit të maturimit në kreditë e ofruara, si dhe rritjes së kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Rritja e kërkesës për kredi në masë të konsiderueshme është nxitur nga rënia e normave të interesit në kredi gjatë këtij viti.

Figura 21. Kreditë sipas sektorëve, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të gjithsej kredive, kreditë ndaj ekonomive familjare në vitin 2015 shënuan rritje prej 9.7 përqind (10.2 përqind në vitin 2014). Rritja e kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet rritjes prej 27.7 përqind të kredive të reja hipotekare dhe rritjes prej 55.8 përqind të kredive të reja me kushte favorizuese, krahas rënies prej 2.8 përqind të kredive të reja konsumuese.

Kontributin kryesor në rritjen e përshpejtuar të gjithsej kreditimit të sektorit e kanë dhënë kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat edhe kanë peshën kryesore në kuadër të gjithsej kredive (65.9 përqind të gjithsej kredive). Këto kredi shënuan rritje vjetore prej 6.1 përqind në vitin 2015 (3.2 përqind në vitin 2014) (figura 21).

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e kryesuar nga kreditë e destinuara për sektorin e tregtisë (me pjesëmarrje prej 51.2 përqind), pasuar nga ato për sektorin e prodhimtarisë (12.3 përqind) dhe sektorin e ndërtimtarisë (7.5 përqind). Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje më të ulët në financimin bankar me pjesëmarrje prej 4.5 përqind, por gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me rritje të përshpejtuar (figura 22).

Sa i përket tendencave të fundit të kreditimit të sektorëve ekonomik, deri në vitin 2015, kreditimi i të gjithë sektorëve shënoi rritje, duke përjashtuar sektorin e ndërtimtarisë i cili vazhdon të karakterizohet me trend rënës që nga viti 2013. Vlen të theksohet që sektorët të cilët përgjithësisht kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, siç janë sektori i bujqësisë dhe i shërbimeve financiare, gjatë vitit 2015 shënuan rritje më të theksuar, gjë që paraqet zhvillim të rëndësishëm për mbështetjen e zhvillimit ekonomik në vend.

Figura 22. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (dhjetor 2015)



Burimi: BQK (2016)

Rritjen më të theksuar vjetore prej 55.1 përqind në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve e regjistroi kreditimi për sektorin e shërbimeve financiare që paraqet përmirësim të theksuar krahasuar me rënien prej 11.9 përqind të shënuar në vitin 2014. Kjo rimëkëmbje deri në një masë mund t'i atribuohet rritjes së regjistrimit të ndërmarrjeve të reja me aktivitet financiar dhe sigurime, ku viti 2015 reflekton numrin më të madh të regjistrimeve në këtë sektor në krahasim me të gjitha periudhat paraprake. Më specifikisht, deri në vitin 2015, numri i ndërmarrjeve të reja te regjistruara gjatë vitit 2015 ishte 95 ndërmarrje, që paraqet dyfishin e ndërmarrjeve të reja të regjistruara në këtë sektor gjatë vitit paraprak (43 deri në vitin 2014).

Normën e dytë më të lartë të rritjes prej 20.3 përqind e regjistroi kreditimi i sektorit të bujqësisë që paraqet një përmirësim të theksuar krahasuar me rritjen prej 8.7 përqind të shënuar në vitin 2014 (figura 23). Përmirësimi mund të jetë ndikuar nga dyfishimi i buxhetit të qeverisë për vitin 2015 për programin e subvencioneve dhe granteve në këtë sektor, gjë që u reflektua edhe në rritjen e numrit të bizneseve të reja të regjistruara në këtë sektor. Deri në vitin 2015, janë raportuar rreth 40 përqind më shumë biznese të reja në sektorin e bujqësisë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Njëkohësisht, edhe norma e interesit në kreditë e reja ndaj sektorit të bujqësisë në vitin 2015 shënoi rënien më të theksuar prej 4.3 pikë përqindje krahasuar me sektorët tjerë. Si rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar, në vitin 2015, norma e interesit në kreditë për ndërmarrjet bujqësore ishte më e ulëta nga të gjithë sektorët e tjerë për dallim nga vitet paraprake kur normat e interesit për ndërmarrjet bujqësore ishin më të lartat.

Figura 23. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Kreditimi i sektorit të tregtisë në vitin 2015 shënoi rritje prej 1.3 përqind që paraqet ngadalësim krahasuar me rritjen prej 5.3 përqind të shënuar në vitin 2014 (figura 23). Ritmi më i ngadalësuar i rritjes, mes tjerash, reflekton ecurinë e ngjashme të aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera, ku vërehet performancë më e dobët si te eksportet ashtu edhe te importet. Rritje të kredive të pranuara regjistroi edhe sektori i prodhimtarisë, që megjithëse me ritëm më të ngadalësuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak, ishte ndër sektorët me rritjen më të lartë të

kreditimit gjatë vitit 2015. Norma vjetore e rritjes së kredive për këtë sektor në vitin 2015 ishte 7.3 përqind (16.2 përqind në vitin 2014) (figura 23).

Në anën tjetër, përkundër rënies së normave të interesit dhe lehtësimit të standardeve të përgjithshme të kreditimit nga ana e bankave, kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë vazhdon të zvogëlohet. Në vitin 2015, kreditë për sektorin e ndërtimtarisë regjistruan rënie vjetore prej 7.0 përqind (rënie prej 9.9 përqind në vitin 2014).

Figura 24. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, gjegjësisht kreditë me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' (figura 24). Megjithatë, krahasuar me periudhat e kaluara, vërehet një tendencë e zhvendosjes drejt kreditimit afatgjatë. Në vitin 2015, kreditë afatshkurtra 'deri në 1 vit' shënuan rënie të pjesëmarrjes në strukturë ndërsa, kategoria e kredive afatgjata 'mbi 5 vite' vazhdoi të rritet me ritëm më të shpejtë.

Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë rreth 79.8 përqind të gjithsej detyrimeve, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektorit bankar. Mbështetja e lartë në depozitat e mbledhura brenda vendit, dhe veçanërisht në depozita të ekonomive familjare të cilat konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit, eviton ekspozimin e sektorit ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme financiare.

Figura 25. Vlera e depozitave në sektorin bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Kategoria e bilancit me bankat tjera në vitin 2015 arriti në 43.4 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 37.2 përqind. Kategoria e huazimeve tjera (përfshirë çertifikatat e depozitave) regjistroi rritje prej 24.7 përqind në vitin 2015 dhe arriti vlerën prej 17.6 milionë euro (tabela 4).

Me rritje të theksuar u karakterizuan edhe mjetet vetanake të sektorit bankar, që janë kategoria e dytë për nga pjesëmarrja me 11.6 përqind në gjithsej detyrimet e sektorit. Në vitin 2015, mjetet vetanake shënuan rritje vjetore prej 21.9 përqind (16.3 përqind në vitin 2014). Rritja e mjeteve vetanake ishte kryesisht si rezultat i profitit të lartë të realizuar nga sektori bankar gjatë vitit 2015.

Tabela 4. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2012		2013		2014		2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	6.0	0.2%	16.5	0.5%	31.6	1.0%	43.4	1.3%
Depozitat	2,279.0	80.6%	2,449.0	80.1%	2,537.5	79.7%	2,701.4	79.8%
Huatë tjera	18.9	0.7%	13.4	0.4%	14.1	0.4%	17.6	0.5%
Detyrimet tjera	223.6	7.9%	246.2	8.0%	232.1	7.3%	194.3	5.7%
Borxhi i ndërvarur	31.0	1.1%	56.3	1.8%	47.3	1.5%	36.8	1.1%
Mjetet vetanake	270.8	9.6%	277.8	9.1%	323.0	10.1%	394.0	11.6%
Gjithsej detyrimet	**2,829.3**	**100%**	**3,059.3**	**100%**	**3,185.6**	**100%**	**3,387.3**	**100%**

Burimi: BQK (2016)

Depozitat

Vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.70 miliardë euro në vitin 2015, që paraqet rritje vjetore prej 6.5 përqind (3.6 përqind në vitin 2014) (figura 25). Kjo normë e rritjes paraqet rimëkëmbje të ecurisë së depozitave krahasuar me vitet paraprake, kur ritmi i rritjes së depozitave ishte ngadalësuar. Rritjes së depozitave, ndër tjerash, ka mund t'i ketë kontribuuar edhe ndërprerja e trendit rënës së normave të interesit në depozita që nga tremujori i dytë i vitit 2015.

Figura 26. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Struktura e gjithsej depozitave të sektorit dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 72.7 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat e ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 21.6 përqind janë kategoria e dytë për nga pesha në strukturë. Ndërsa, pjesa tjetër prej 5.7 përqind përbëhet nga depozitat e tjera (depozitat e jorezidentëve, organizatave jo-qeveritare, qeveritë qendrore dhe lokale) (figura 26).

Figura 27. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket ecurisë së depozitave, ritmi i rritjes së gjithsej depozitave më së shumti diktohet nga depozitat e ekonomive familjare si kategoria dominuese. Në vitin 2015, depozitat e ekonomive familjare regjistruan normë vjetore të rritjes prej 6.3 përqind (4.1 përqind në vitin 2014).

Rritje shënuan edhe depozitat e ndërmarrjeve që në vitin 2015 ishin për 4.2 përqind krahasuar me vitin 2014 (rritje vjetore prej 0.7 përqind në vitin 2014). Depozitat tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare, qeveritë qendrore dhe lokale, etj.) gjithashtu u karaterizuan me rritje të përshpejtuar, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 19.0 përqind në vitin 2015 (9.4 përqind në vitin 2014), si rrjedhojë e rritjes së theksuar të depozitave të jorezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë.

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime të theksuara krahasuar me vitet paraprake. Depozitat e afatizuara vazhdojnë të ngushtojnë pjesëmarrjen në strukturë me një ritëm të theksuar që nga viti 2013, që mund të jetë si rezultat i rënies së normave e interesit gjatë asaj periudhe. Në vitin 2015, depozitat e afatizuara ngushtuan pjesëmarrjen në 24.7 përqind të gjithsej depozitave (nga 31.7 përqind në vitin 2014), përderisa depozitat e transferueshme zgjeruan pjesëmarrjen në 54.7 përqind (47.2 përqind në vitin 2014). Kategoria e mbetur, ajo e depozitave të kursimit, në vitin 2015 lehtësisht ka zvogëluar pjesëmarrjen në 20.6 përqind të gjithsej depozitave (nga 21.1 përqind në vitin 2014) (figura 27).

Figura 28. Depozitat e afatizuara



Burimi: BQK (2016)

Edhe pse gjithsej depozitat e afatizuara janë karakterizuar me rënie, në kuadër të strukturës së tyre vërehet një zhvendosje e theksuar drejt afateve më të gjata të maturimit. Depozitat me afat të gjatë maturimi 'mbi 2 vite' dhe ato afatmesme 'mbi 1 deri në 2 vite' kanë rritur pjesëmarrjen në strukturë, ndërsa depozitat afatshkurta 'deri 1 vit' kanë zvogëluar pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej depozitave të afatizuara (figura 28). Këto lëvizje janë konform lëvizjeve të normave të interesit, të cilat mbesin më të larta në depozitat me maturitet më të gjatë.

Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi gjatë vitit 2015 shënuan rënie më të theksuar. Në vitin 2015, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 7.7 përqind nga 9.3 përqind sa ishte në vitin 2014. Në anën tjetër, normat e interesit në depozita shënuan rritje të lehtë, për dallim nga viti 2014 kur kishin shënuar rënie të theksuar. Në vitin 2015, norma mesatare e interesit në depozita arriti në 1.2 përqind nga 1.1 përqind sa ishte në vitin 2014. Dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe normës së interesit në depozita në vitin 2015 u zvogëlua në 6.5 përqind nga 8.2 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 29).

Figura 29. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2016)

Figura 30 tregon se normat e interesit në Kosovë, si ato në kredi ashtu edhe ato në depozita, kanë konvergjuar me normat e aplikuara nga vendet tjera të rajonit.[7] Në vitin 2015, norma e interesit për kredi në Kosovë ishte më e ulët se sa në Shqipëri dhe Mal të Zi, ndërsa ishte më e lartë se sa norma e interesit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni. Për sa i përket depozitave, Kosova dhe Mali i i Zi kishin normat më të ulëta të interesit në mesin e vendeve të rajonit.

[7] Normat e interesit për Serbinë nuk janë përfshirë për shkak të mungesës së të dhënave të krahasueshme me vendet tjera.

Normat e interesit në kredi

Gjatë vitit 2015, norma e interesit në kredi shënoi rënie si në kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe në kreditë ndaj ekonomive familjare. Megjithatë, që nga tremujori i dytë i vitit 2015, rënia ishte më e shprehur në kreditë ndaj ndërmarrjeve, krahasuar me ato ndaj ekonomive familjare. Në vitin 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 7.4 përqind nga 9.6 përqind sa ishte në vitin 2014. Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese vazhdojnë të karakterizohen me normat më të ulëta të interesit me një mesatare prej 7.2 përqind në vitin 2015, përderisa mesatarja e interesit për kreditë jo-investuese ishte 7.8 përqind në vitin 2015 (figura 31).

Niveli më i ulët i normave të interesit për kreditë investuese mund të ketë nxitur rritjen më të shpejtë të kredive të reja të kësaj kategorie, të cilat shënuan rritje vjetore prej 20.8 përqind në vitin 2015, krahasuar me kreditë e reja jo-investuese, të cilat shënuan rritje vjetore prej 7.1 përqind në vitin 2015. Me rënie të normave të interesit u karakterizuan edhe kategoritë tjera si mbitërheqjet dhe linjat e ndryshme kreditore ndaj ndërmarrjeve. Norma e interesit për linjat e ndryshme kreditore ndaj ndërmarrjeve shënoi rënie më të theksuar, duke arritur në 8.5 përqind nga 11.8 përqind sa ishin në vitin 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit në mbitërheqjet e ndërmarrjeve u zvogëlua në 7.1 përqind nga 9.4 përqind në vitin 2014.

Figura 30. Normat e interesit në Kosovë dhe vendet e rajonit



Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2016)

Figura 32. Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve, sipas maturimit



Burimi: BQK (2016)

Sipas afatit të maturimit të kredive, rënia më e theksuar e normës së interesit prej 2.8 pikë përqindje u regjistrua te kreditë me afat të mesëm maturimi (figura 32). Në vitin 2015, norma më e ulët e interesit prej 6.9 përqind u regjistrua te kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' gjë që edhe u reflektua në rritjen e lartë vjetore prej 62.6 përqind të kredive të reja në këtë kategori gjatë së njëjtës periudhë. Norma më e lartë e interesit prej 8.0 përqind u regjistrua te kreditë me afat maturimi 'deri 1 vit'.

Sipas veprimtarive ekonomike, me rënie të normave të interesit u karakterizuan kreditë për të gjithë sektorët e ekonomisë, por rënia më e theksuar u shënua te kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe të shërbimeve. Në vitin 2015, norma mesatare e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë u zvogëlua në 7.1 përqind nga 11.3 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 33). Zvogëlimi i normës së interesit për këto kredi vlerësohet të ketë qenë kontribues i rëndësishëm i përshpejtimit të rritjes së kredive për sektorin e bujqësisë, që në vitin 2015 ishte sektori me rritjen më të lartë të kreditimit. Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë që përfaqëson 70.2 përqind të gjithsej stokut të kredive të shërbimeve) u zvogëlua në 7.4 përqind (10.0 përqind në vitin 2014), gjë që u reflektua gjithashtu në rritje të përshpejtuar të kreditimit për shërbimet tjera (përfshirë shërbimet financiare në krahasim me vitin paraprak, përderisa për tregti kreditimi është ngadalësuar. Rënie shënuan edhe normat e interesit për kreditë ndaj sektorit të industrisë, të cilat u zvogëluan në 7.4 përqind në vitin 2015 (8.9 përqind në vitin 2014).

Figura 33. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)

Figura 34. Norma mesatare e interesit në kreditë e ekonomive familjare



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket kredive për ekonomitë familjare, në vitin 2015, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 8.4 përqind nga 8.9 përqind sa ishte në vitin 2014. Rënia më e theksuar u regjistrua te kreditë hipotekare, kur norma mesatare e interesit u zvogëlua në 7.0 përqind nga 7.9 përqind në vitin 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese u zvogëlua në 8.7 përqind nga 9.1 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 34).

Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me maturim më afatgjatë kishin norma më të ulëta të interesit krahasuar me ato afatshkurtra. Norma më e ulët e interesit prej 5.9 përqind u regjistrua te kreditë hipotekare me afat maturimi 'mbi 10 vite', ndërsa më e larta prej 7.4 përqind u regjistrua te kreditë me afat maturimi 'mbi 2 vite deri në 5 vite'. Në kuadër të kredive hipotekare, kreditë me afat maturimi 'mbi 10 vite' shënuan rënien më të theksuar vjetore të normës mesatare të interesit prej 1.9 pikë përqindje.

Normat e interesit në depozita

Trendi rritës i normës së interesit në gjithsej depozitat që nga tremujori i dytë i vitit 2015 kryesisht reflekton rritjen e normës së interesit në depozitat e ekonomive familjare, të cilat dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar. Ndërsa, norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ndërpreu trendin rënës vetëm në tremujorin e katërt të vitit 2015. Megjithatë, vlen të theksohet që gjatë pjesës më të madhe të vitit 2015 (përjashtuar tremujorin e tretë), norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ishte më e lartë krahasuar me interesin për depozitat e ekonomive familjare (figura 35).

Figura 35. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2016)

Figura 36. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive



Burimi: BQK (2016)

Në vitin 2015, norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëlua në 1.5 përqind në vitin 2015 nga 1.6 përqind sa ishin në vitin 2014 (figura 35). Norma e interesit në depozitat e afatizuara u zvogëlua në 1.5 përqind në vitin 2015 (1.6 përqind në vitin 2014), ndërsa për depozitat e kursimeve norma e interesit u zvogëlua në 0.1 përqind në vitin 2015 (0.7 përqind në vitin 2014) (figura 36).

Sipas afatit të maturimit, normat më të ulëta të interesit ishin të pranishme në depozitat me afat maturimi 'mbi 1 muaj deri në 3 muaj' (0.7 përqind), kurse normat më të larta u hasën në depozitat me afat maturimi 'mbi 2 vite' (3.2 përqind).

Figura 37. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2016)

Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare në vitin 2015 arriti në 1.1 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në vitin 2014. Trendi pozitiv i normës mesatare të interesit në depozita kryesisht reflekton rritjen e lehtë të normës së interesit në depozitat e afatizuara. Në vitin 2015, norma e interesit në depozitat e afatizuara arriti në 1.1 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 37).

Në kuadër të depozitave të afatizuara, norma më e ulët e interesit prej 0.2 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi 'deri në 1 muaj', përderisa ajo më e larta prej 2.2 përqind u regjistrua në depozitat me afat maturimi 'mbi 2 vite'. Ndërsa, rritjen më të theksuar vjetore prej

0.6 pikë përqindje e shënoi norma e interesit në depozitat me afat maturimi 'mbi 1 vit deri në 2 vite'.

Në anën tjetër norma e interesit në depozitat e kursimeve të ekonomive familjare në vitin 2015 u zvogëlua në 0.3 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në vitin 2014. Normat e ulëta të interesit në depozitat e afatizuara dhe të kursimeve në dy vitet e fundit kontribuan në zhvendosjen e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve drejt depozitave të transferueshme, të cilat kanë arritur të bëhen kategoria me peshën më të madhe në gjithsej depozitat.

Performanca e sektorit bankar

Profiti i realizuar nga sektori bankar në vitin 2015 arriti vlerën prej 94.7 milionë euro (60.5 milionë euro në vitin 2014), që paraqet shumën më të lartë të profitit të regjistruar që nga fillimi i funksionimit të këtij sektori (figura 38). Rritja e profitit gjatë këtij viti rezultoi nga zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve të sektorit bankar.

Figura 38. Performanca financiare e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 39. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2016)

Në vitin 2015, të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën 238.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.9 përqind (figura 39). Kontributin kryesor në rënien e gjithsej të hyrave kishin të hyrat nga interesi që në vitin 2015 shënuan rënie vjetore prej 5.7 përqind. Rënia e të hyrave nga interesi në masë të madhe i atribuohet zvogëlimit të të hyrave nga interesi në kredi kryesisht si rrjedhojë e rënies së normave të interesit, pavarësisht përshpejtimit të aktivitetit kreditor gjatë kësaj periudhe. Të hyrat nga jo-interesi në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet, që ndër tjerash reflekton shtrenjtimin e shërbimeve të ofruara në degët bankare.

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar në vitin 2015 arriti në 143.5 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 22.3 përqind (figura 39). Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve në masë të madhe ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve të jo-interesit, që shënuan rënie vjetore prej 88.6 përqind. Në kuadër të tyre, rënie më të theksuar shënuan shpenzimet për provizione në kredi të cilat regjistruan rënie vjetore prej 141.1 përqind, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të kredive joperformuese. Gjithashtu, në rënien e gjithsej shpenzimeve ndikim të konsiderueshëm kishin edhe shpenzimet e interesit që shënuan rënie vjetore prej 48.7 përqind, kryesisht si rezultat i rënies për 54.0 përqind të shpenzimeve të interesit në depozita. Pavarësisht rritjes së lehtë të normave të interesit në depozita gjatë pjesës më të madhe të vitit 2015, ulja e theksuar e tyre gjatë dy viteve të fundit u reflektua në rënien e shpenzimeve në vitin 2015. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve,

ishin e vetmja kategori e cila shënoi rritje, duke regjistruar një normë vjetore të rritjes prej 5.2 përqind në vitin 2015. Kjo rritje kryesisht i atribuohet shpenzimeve tjera nga jo interesi (marketingut, shpenzimeve ligjore, shpenzimeve të pashpalosura etj.), ndërsa në një shkallë më të ulët i atribuohet edhe rritjes së shpenzimeve të personelit.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i rënies së theksuar të shpenzimeve. Në vitin 2015, ky indikator u përmirësua në 60.3 përqind, krahasuar me 75.3 përqind sa ishte në vitin paraprak. Profiti i realizuar në vitin 2015 ka ndikuar në përmirësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA arriti në 2.9 përqind, nga 2.0 përqind sa ishte në 2014, derisa ROAE arriti në 26.4 përqind, nga 20.3 përqind sa ishte në 2014 (figura 40).

Figura 40. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Rreziqet e sektorit bankar

Rreziqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar i Kosovës mbeten në nivel të ulët edhe në vitin 2015. Për më tepër, sektori bankar regjistroi rënie të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor dhe solvencës.

Tabela 5. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK)	14.2%	16.7%	17.8%	19.0%
Raporti i kredive joperfomruese (KJP) ndaj gjithsej kredive	7.5%	8.7%	8.3%	6.2%
Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione	112.6%	110.6%	114.4%	115.1%
Raporti kredi/depozitë	77.4%	73.7%	74.2%	74.8%
Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra	40.8%	48.0%	43.6%	44.9%
Raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë	93.4%	129.7%	97.1%	67.1%

Burimi: BQK (2016)

Në vitin 2015, raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive zbriti në 6.2 përqind nga 8.3 përqind sa ishte në vitin 2014. Kjo rënie ishte rezultat i zvogëlimit të vlerës së kredive joperformuese, si dhe rritjes së përshpejtuar të stokut të kredive gjatë vitit 2015 (tabela 5). Kosova vazhdon të jetë vendi me cilësinë më të mirë të portofolit kreditor krahasuar me vendet e tjera të rajonit, të cilat kanë një mesatare të raportit të KJP-ve ndaj

Figura 41. Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në Kosovë dhe vendet e rajonit, 2015



Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

gjithsej kredive prej rreth 16 përqind (figura 41). [8]

Për më tepër, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë në vitin 2015 është rritur, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione në vitin 2015 është rritur në 115.1 përqind nga 114.4 përqind në vitin 2014. Sektori bankar gjithashtu u karakterizua me rënie të trendit të koncentrimit të rrezikut kreditor. Shkalla e ekspozimit kreditor në sektorin bankar, që matet si raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë, në vitin 2015, u zvogëlua në 67.1 përqind nga 97.1 përqind në vitin 2014. Rënia i atribuohet kryesisht rritjes së theksuar të kapitalit të klasit të parë si rrjedhojë e rritjes së lartë të profitit të realizuar gjatë vitit 2015 mirëpo kontribut kishte edhe rënia e vlerës së ekspozimeve të mëdha.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit vazhdon të mbetet i ulët përkundër rritjes së përshpejtuar të kreditimit, kryesisht rezultat i rritjes së përshpejtuar të depozitave. Në vitin 2015, raporti i kredive ndaj depozitave shënoi rritje të lehtë në 74.8 përqind nga 74.2 përqind në vitin 2014 si rezultat i rritjes më të lartë vjetore të kredive në krahasim me rritjen e depozitave. Rritja e përshpejtuar e depozitave ka ndikuar në rritjen e lehtë të treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra, që mbetet mjaft mbi nivelin minimal të përcaktuar me kërkesat rregullatore. Raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtra u rrit në 44.9 përqind në vitin 2015 krahasuar me 43.6 përqind në vitin 2014, dhe vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore.

Kapitali i sektorit bankar shënoi rritje gjatë vitit 2015 si rrjedhojë e rritjes së fitimit neto, duke rezultuar në ngritje të cilësisë së kapitalit si dhe treguesve të kapitalizimit të sektorit. Në vitin 2015, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, që paraqet raportin ndërmjet gjithsej kapitalit rregullator dhe aseteve të peshuara ndaj rrezikut, arriti në 19.0 përqind krahasuar me 17.8 përqind sa ishte një vit më parë. Krahasuar me shtetet tjera të rajonit, Kosova vazhdon të jetë në mesin e shteteve me shkallën më të lartë të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (figura 42).[9] Në vitin 2015, shkalla mesatare e këtij treguesi në shtetet tjera të rajonit ishte 16.8 përqind.

Figura 42. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në sektorin bankar në Kosovë dhe vendet e rajonit, 2015



Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut, marrë parasysh faktin se pothuajse të gjitha kreditë dhe depozitat vazhdojnë të bartin norma fikse të interesit (91.5 përqind e gjithsej kredive përkatësisht 100.0 përqind e depozitave) si dhe për faktin se bilanci i gjendjes së sektorit bankar pothuajse në tërësi është i denominuar në valutën euro (99.7 përqind në vitin 2015) dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Edhe gjatë vitit 2015, sektori bankar ka vazhduar në zhvillimin e kanaleve elektronike të ofrimit të shërbimeve të klientëve me një shkallë të lartë të automatizimit në njërën anë, e cila është e shoqëruar edhe me një shkallë në rritje të ekspozimit të tyre ndaj rrezikut operacional. Sidoqoftë,

[8] Treguesi për Malin e Zi nuk është paraqitur për shkak të disponueshmërisë së të dhënave.

[9] Treguesi për Malin e Zi nuk është paraqitur për shkak të disponueshmërisë së të dhënave.

bankat janë treguar aktive në ndërmarrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të BQK-së, të cilat kanë për qëllim sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat rregullative dhe uljen e rrezikut operacional në sektorin bankar.

3.4.3 Sektori pensional

Vlera e aseteve të sektorit pensional në vitin 2015 arriti në 1.24 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.1 përqind (figura 43). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën m ë të madhe të aseteve të sektorit (99.4 përqind), ndërsa pjesa e mbetur (0.6 përqind) menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

Figura 43. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Në vitin 2015, vlera e gjithsej aseteve të FKPK-së arriti në 1.23 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 13.1 përqind, rritje kjo më e ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 19.1 përqind të regjistruar në vitin 2014. Ngadalësimi i rritjes së aseteve të FKPK-së i atribuohet ecurisë së arkëtimeve të reja dhe performancës së kthimit në investime. Arkëtimet e reja deri në vitin 2015 arritën vlerën 137.5 milionë euro nga rreth 508.0 mijë kontribues, që përkon me një rritje vjetore prej 6.8 përqind (rritje vjetore prej 8 përqind në vitin 2014).

Kthimi nga investimet e FKPK-së në vitin 2015 shte pozitiv, por në vlerë më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Deri në vitin 2015, kthimi në investime arriti vlerën prej 29.6 milion euro (ose 2.3 përqind), krahasuar me kthimin prej 66.7 milion euro (ose 6.3 përqind) deri në vitin 2014. Kjo ishte si rezultat i kthimit negativ nga investimet në sektorin e jashtëm gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015. Kthimi më i ulët në investime gjatë vitit 2015 u ndikua nga lëvizjet e mëdha në tregjet financiare globale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015 si rezultat i zhvillimeve ekonomike dhe politike në disa vende të eurozonës dhe parashikimet për ngadalësim të rritjes së ekonomisë kineze, që u reflektuan edhe në ekonominë e SHBA-ve, dhe rrjedhimisht ndikuan në performancën e investimeve të jashtme të FKPK-së. Më 31 dhjetor 2015, çmimi i aksionit të FKPK-së arriti në 1.317 euro (1.288 euro në vitin 2014).

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve shënoi rritje vjetore të aseteve dhe kthim pozitiv nga investimet. Në vitin 2015, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 6.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.0 përqind, që po ashtu është më e ulët se sa rritja prej 9.2 përqind në vitin 2014. Ngadalësimi i rritjes së vlerës së aseteve të FSKP-së ishte pasojë e rritjes më të ngadalshme të arkëtimeve të reja dhe po ashtu rritjes më të ulët të kthimit nga investimet. Vlera e kontributeve të arkëtuara në vitin 2015 arriti në 461.4 mijë euro nga 4,025 kontribues, që përkon me një rritje vjetore prej 1.8 përqind. Kjo paraqet një ngadalsim të lehtë krahasuar me vitin 2014 kur u arkëtuan 453.2 mijë euro (2.1 përqind rritje vjetore) nga 393.0 mijë kontribues.

Kthimi bruto nga investimet e FSKP-së deri në vitin 2015 arriti në 158.7 mijë euro, që është dukshëm më i ulët krahasuar me kthimin prej 371.9 mijë euro të regjistruar në vitin 2014. Ngjashëm me FKPK-në, performanca e investimeve të FSKP-së u ndikua nga lëvizjet në tregjet

financiare globale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2015. Në ditën e fundit të vitinit 2015, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 145.30 euro (145.16 euro në vitin 2014).[10]

3.4.4 Sektori i sigurimeve[11]

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind, duke arritur vlerën 152.7 milionë euro (figura 44). Sigurimet jo-jetë përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit (90.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit), dhe shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind, për dallim nga viti paraprak kur kishin shënuar rritje vjetore prej 5.1 përqind. Rritja e aseteve të sigurimit jo-jetë kryesisht rezultoi nga fillimi i operimit të dy kompanive të reja në këtë sektor. Ndërsa, pjesa tjetër e sektorit të sigurimeve përfaqësohet nga sigurimet e jetës, të cilat përfaqësojnë 10.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve. Asetet e sigurimit të jetës në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.7 përqind (9.2 përqind në vitin 2014).

Figura 44. Asetet e kompanive të sigurimit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Vlera e gjithsej primeve të shkruara në vitin 2015 arrti në 80.0 milionë euro që paraqet një rënie vjetore prej 2.6 përqind, për dallim nga viti i kaluar kur primet e shkruara kishin shënuar rritje vjetore prej 3.8 përqind. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë të cilat përfaqësojnë 96.6 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Rrjedhimisht edhe ecuria e gjithsej primeve diktohet nga trendi i primeve të sigurimit jo-jetë. Primet e shkruara jo-jetë në vitin 2015 arritën vlerën 77.3 milionë euro që përkon me një rënie vjetore prej 3.0 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 3.4 përqind të regjistruar në vitin 2014.

Primet e sigurimit jetë përfaqësojnë vetëm 3.4 përqind të gjithsej primeve të sektorit. Në vitin 2015, primet e sigurimit jetë arritën vlerën 2.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind (18.9 përqind në vitin 2014). Rritja e primeve të sigurimit jo-jetë kontribuoi në zbutjen e rënies vjetore të gjithsej primeve të shkruara.

Figure 45. Primet e kontraktuara dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në vitin 2015 arritën vlerën 36.8 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 13.8 përqind, për dallim nga viti i kaluar kur vlera e dëmeve të paguara kishte shënuar rënie vjetore prej 16.8 përqind. Ndikim të rëndësishëm në rritjen e gjithsej dëmeve të paguara ka pasur rritja e dëmeve të paguara për sigurimet jo-jetë, që shënuan rritje vjetore

[10] Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

[11] Të dhënat për sektorin e sigurimeve janë të bazuara në pasqyra financiare jo të audituara.

prej 14.6 përqind, krahasuar me rënien vjetore prej 16.6 përqind në vitin 2014. Po ashtu, rritje kanë shënuar edhe pagesat për dëmet e sigurimet të jetës, të cilat shënuan rritje vjetore prej 38.3 përqind, krahasuar me rënien vjetore prej 5.0 përqind të regjistruar në vitin 2014. Dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) po ashtu shënuar rritje, duke regjistruar një normë vjetore të rritjes prej 6.8 përqind (-18.2 përqind në vitin 2014).

Rritja e dëmeve të paguara dhe zvogëlimi i vlerës së primeve të shkruara rezultoi në rritje të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara, që, në vitin 2015 arriti në 46.0 përqind krahasuar me 39.4 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 45).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Në vitin 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 7.7 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 2.5 milionë euro në vitin paraprak. Thellimi i humbjes ishte rrjedhojë e humbjes së shënuar në kuadër të aktivitetit të sigurimit jo-jetë, përderisa përformanca financiare e sigurimit jetë ishte pozitive. Gjatë vitit 2015, sigurimi jo-jetë shënoi humbje prej 8.1 milionë euro (humbje prej 3.0 milionë në vitin 2014), ndërsa sigurimi jetë regjistroi fitim në vlerë prej 377.9 mijë euro në vitin 2015 (487.5 mijë euro në vitin 2014). Thellimi i humbjes së sektorit ndikoi në përkeqësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROA). ROAA u përkeqësua në -5.3 përqind (-1.8 përqind në vitin 2014), kurse ROAE në -16.0 përqind (-5.5 përqind në vitin 2014) (figura 46). Sektori i sigurimeve gjithashtu u karakterizua me rënie të nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 101.1 përqind në 2015 (në vitin 2014 ishte 119.3 përqind), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve shënoi rënie në 91.9 përqind (në vitin 2014 ishte 102.3 përqind).

Figura 46. Treguesit e profitabilitetit të sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2016)

3.4.5 Sektori mikrofinanciar[12]

Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me zgjerim të përshpejtuar të aktivitetit, ku vlera e gjithsej aseteve të sektorit në vitin 2015 arriti në 119.7 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.0 përqind (figura 47). Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 68.8 përqind të gjithsej aseteve të këtij sektori. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet me pjesëmarrje

Figura 47. Asetet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

[12] Ne kuadër të sektorit mikrofinanciar i referohet edhe pesë insitutcioneve financiare jo-bankare që janë të licencuara për aktivitet kredidhënës.

prej 18.2 përqind në gjithsej asetet e sektorit (figura 48). Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar mbështetet kryesisht në huamarrjen nga sektori i jashtëm. Në vitin 2015, gjithsej huamarrjet e jashtme shënuan vlerën prej 62.7 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 1.4 përqind (rënie prej 1.4 përqind në vitin 2014).

Figura 48. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Kreditë

Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në vitin 2015 arriti në 82.4 milionë euro, që paraqet rritje të përshpejtuar vjetore prej 10.7 përqind (2.9 përqind në vitin 2014). Gjatë vitit 2015, kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan normë më të lartë të rritjes vjetore (15.6 përqind) krahasuar me kreditë ndaj ekonomive familjare (8.2 përqind). Megjithatë, ishin kreditë ndaj ekonomive familjare, si kategoria kryesore e kredive të sektorit mikrofinanciar, ato të cilat dhanë kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kredive të lëshuara nga ky sektor.

Figura 49. Kreditë ndaj ekonomive familjare sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Kreditë ndaj ekonomive familjare në vitin 2015 regjistruan rritje vjetore prej 8.2 përqind, që paraqet rimëkëmbje të theksuar krahasuar me rënien vjetore prej 0.4 përqind të shënuar në vitin 2014. Kreditë për ekonomitë familjare përfaqësuan 64.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në vitin 2015.

Figura 50. Kreditë e sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Struktura e kredive të ekonomive familjare sipas afatit të maturimit vazhdon të dominohet nga kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri në 2 vite' që përfaqësojnë 47.0 përqind të gjithsej kredive, pasuar nga ato me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' që përfaqësojnë 29.9 përqind të gjithsej kredive. Kreditë afatshkurtëra 'deri në 1 vit' përfaqosojnë 21.4 përqind të gjithsej kredive, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël në kreditë ndaj ekonomive familjare e kanë kreditë me afat maturimi 'mbi 10 vite' të cilat përfaqësohen me 0.2 përqind (figura 49).

Kreditimi i ndërmarrjeve, gjatë vitit 2015, shënoi rritje vjetore prej 15.6 përqind krahasuar me rritjen prej 9.9 përqind të shënuar në vitin 2014. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kategoria kryesore mbeten kreditë e destinuara për shërbime tjera të cilat, në vitin 2015, përbënë 26.5 përqind të gjithsej

kredive të sektorit mikrofinanciar. Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, tek institucionet mikrofinanciare bujqësia gëzon një mbështetje më të madhe duke përfaqësuar kategorinë e dytë për nga pesha, me pjesëmarrje prej 25.4 përqind. Kreditë për ndërtimtari, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 19.9 përqind në gjithsej kreditë e sektorit mikrofinanciar, mbeten kategoria e tretë për nga pjesëmarrja në gjithsej kreditë e sektorit mikrofinanciar. Ndërsa, kreditimi i sektorit të tregtisë përfaqëson 18.9 pë rqind të gjithsej kreditimit mikrofinanciar për dallim nga kreditimi bankar ku ka pjesëmarrjen më të madhe. Sektori i industrisë mbetet sektori me qasjen më të ulët në financimin mikrofinanciar me pjesëmarrje prej vetëm 9.0 përqind (figura 50).

Figura 51. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket ecurisë së kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë, kreditë për sektorin e tregtisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore prej 22.7 përqind në vitin 2015 (19.1 përqind në vitin 2014) (figura 51). Kreditimi i sektorit të industrisë u karakterizua me rritje vjetore prej 21.7 përqind (20.6 përqind në vitin 2014), përderisa kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë shënoi rritje vjetore prej 18.3 përqind (12.8 përqind në vitin 2014). Rritja më e theksuar kreditimit mikrofinanciar për sektorin e tregtisë në kohën e ngadalësimit të rritjes së kreditimit bankar për sektorin e tregtisë; si dhe rritja e theksuar e kreditimit mikrofinanciar për sektorin e ndërtimtarisë krahas rënies së kreditimit bankar për këtë veprimtari mund të shërbejë si evidencë për rritjen e aftësisë së sektorit mikrofinanciar për të plotësuar kreditimin bankar dhe në të njëjtën kohë mund të paraqes rritje të presioneve konkurruese të sektorit mikrofinanciar kundrejt sektorit bankar.

Kreditimi i sektorit të bujqësisë gjithashtu shënoi rritje vjetore të përshpejtuar prej 15.4 përqind (3.6 përqind në vitin 2014). Kreditimi për sektorin e shërbimeve tjera[13], që edhe dominon strukturën e gjithsej kredive, në vitin 2015 shënoi rritje vjetore prej 6.4 përqind të ngjashme me vitin paraprak (6.0 përqind në vitin 2014).

Struktura e kredive të sektorit ndaj ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit vazhdon të jetë e dominuar nga kreditë me maturim afatmesëm. Në vitin 2015, kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri në 2 vite' përfaqësuan 42.8 përqind të gjithsej kredive, pasuar nga kreditë me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' që u përfaqësuan me 40.3 përqind. Kategoria e tretë për nga pesha në strukturën e gjithsej aseteve mbeten kreditë afatshurtëra 'deri në 1 vit' me pjesëmarrje prej 15.6 përqind.

Figura 52. Kreditë ndaj ndërmarrjeve sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

[13] Në kategorinë shërbimet tjera përfshihen: minierat, energjetika, hoteleria, tregtia tjetër, shërbimet financiare dhe patundshmëritë.

Pjesëmarrjen më të vogël në strukturë me 1.2 përqind e kanë kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' (figura 52).

Lizingjet

Lizingjet, si kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e gjithsej aseteve të sektorit mikrofinanciar, në vitin 2015 shënuan vlerën 21.8 milionë euro (figura 53), duke regjistruar një rënie vjetore prej 2.5 përqind. Rënia e gjithsej lizingjeve i atribuohet kryesisht rënies së lizingjeve për ekonomitë familjare, të cilat shënuan rënie vjetore prej 3.7 përqind në vitin 2015. Gjatë vitit 2015, linzingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rënie si në kategorinë hipotekare ashtu edhe në kategorinë e lizingjeve tjera.

Figura 53. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Kontributin më të madh në rënien e lizingjeve për ekonomitë familjare e kishin lizingjet hipotekare, të cilat shënuan një rënie vjetore prej 3.7 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 110.8 përqind të shënuar në vitin 2014. Lizingjet tjera regjistruan një rënie vjetore prej 2.9 përqind (rritje vjetore prej 15.2 përqind në vitin 2014). Lizingjet për ekonomitë familjare diktojnë ecurinë e gjithsej lizingjeve sepse përbëjnë kategorinë dominuese me 52.8 përqind të strukturës së lizingjeve (figura 54). Struktura e lizingjeve për ekonomitë familjare sipas afatit të maturimit vazhdon të dominohet nga lizingjet afatgjata 'mbi 10 vite' me pjesëmarrje 46.8 përqind në strukturë, pasuar nga lizingjet me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' me pjesëmarrje prej 39.5 përqind.

Figura 54. Struktura e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Kontribut në rënien e gjithsej lizingeve kishin edhe lizingjet për ndërmarrjet të cilat u karakterizuan me rënie vjetore të lehtë prej 1.0 përqind dhe përbëjnë 47.2 përqind të gjithsej lizingjeve të sektorit mikrofinanciar. Në kuadër të lizingjeve për ndërmarrjet ishte kategoria e lizingjeve për pajisje që ndikoi në rënien e kësaj kategorie. Në të njëjtën kohë, lizingjet tjera, si kategoria më e madhe në peshë (pjesëmarrje prej 83.2 përqind në strukturën e gjithsej lizingjeve), ndikoi që kjo rënie të jetë jo shumë e ndjeshme për këtë kategori. Deri në vitin 2015, lizingjet për pajisje shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 36.5 përqind, pasuar nga lizingjet hipotekare të cilat shënuan rënie prej 12.6 përqind. Për dallim nga këto kategori, lizingjet tjera u karakterizuan me rritje vjetore prej 9.8 përqind duke zbutur rënien e ndjeshme të gjithsej lizingjeve ndaj ndërmarrjeve.

Struktura e lizingjeve të ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit u dominua nga lizingjet afatmesme ngjajshëm me periudhën e njejtë të vitit paraprak. Më saktësisht, dominuan lizingjet me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' me 89.4 përqind pjesëmarrje në strukturë, pasuar nga lizinigjet me afat maturimi 'mbi 1 deri në 2 vite' me pjesëmarrje prej 7.6 përqind.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2015 shënoi rënie, duke ndërprerë kështu trendin rritës të ndjekur gjatë tri viteve të fundit. Në vitin 2015, norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar u zvogëlua në 22.3 përqind nga 23.3 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 55). Kjo ecuri reflekton rënien e normës mesatare të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, përderisa norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare vazhdoi të përcjellë trendin rritës të tre viteve të fundit. Mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në vitin 2015 u zvogëlua në 19.9 përqind, nga 22.6 përqind sa ishte në vitin 2014. Në anën tjetër, në vitin 2015 norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare është rritur në 24.4 përqind, nga 23.8 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. (figura 56).

Figura 55. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 56. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të kredive ndaj nërmarrjeve, norma më e ulët e interesit ishte te kreditë për sektorin e shërbimeve. Kjo kategori njëkohësisht u karakterizua më rënien më të theksuar të normës së interesit prej 1.8 pikë përqindje, e cila zbriti në 19.9 përqind në vitin 2015 nga 21.7 përqind në vitin 2014. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë po ashtu shënoi rënie, duke zbritur në 23.6 përqind në vitin 2015 nga 23.8 përqind sa ishte në vitin 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë mbeti në nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke qëndruar në 25.5 përqind (figura 56).

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përmirësim të performancës financiare në krahasim me vitet e fundit. Deri në vitin 2015, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 2.5 milionë euro, krahasuar me profitin prej 0.7 milionë euro të realizuar në vitin 2014. Rritja e theksuar e profitit ishte rezultat i rritjes së përshpejtuar të të hyrave, përderisa shpenzimet u rritën me ritëm të ngadalësuar.

Deri në vitin 2015, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra në vlerë prej 21.1 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të konsiderueshme prej 9.4 përqind krahasuar me rritjen prej 0.5 përqind të shënuar deri në vitin 2014. Ndërsa, shpenzimet deri në vitin 2015 arritën në 18.7 milionë euro, duke paraqitur një rritje të lehtë prej 0.5 përqind për dallim nga rënia prej 4.9 përqind deri në vitin 2014 (figura 57).

Rritja e përshpejtuar e të hyrave deri në vitin 2015 ishte rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi, të cilat ishin për 7.0 përqind më të larta se sa në vitin paraprak (rritje vjetore prej 3.3 përqind në vitin 2014), si dhe të hyrave nga jo interesi të cilat shënuan rritje vjetore prej 21.4 përqind (rënie prej 11.4 përqind në vitin 2014). Në kuadër të të hyrave nga jo interesi, të hyrat nga shërbimet shënuan rritje vjetore prej 164.9 përqind për dallim nga rritja prej 11.2 përqind në vitin 2014. Të hyrat administrative në vitin 2015 patën një rritje prej 23.2 përqind në krahasim me rritjen vjetore prej 5.6 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, të hyrat tjera operative shënuan rritje të konsiderueshme prej 2.0 përqind në krahasim me rënien prej 18.0 përqind në vitin 2014.

Figura 57. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)

Figura 58. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Në anën tjetër, rritja e shpenzimeve ishte si rezultat i rritjes së shpenzimeve nga jointeresi të cilat në vitin 2015 arritën në 12.3 milionë euro, rritje prej 0.1 përqind në krahasim me rënien prej 8.5 përqind në vitin paraprak, si dhe shpenzimeve nga interesi të cilat arritën në 4.0 milionë euro që paraqet një rritje prej 5.0 përqind. Në kuadër të shpenzimeve nga jo interesi, shpenzimet për provizionet për humbjet nga kreditë shënuan rritje vjetore prej 8.7 përqind për dallim nga rënia prej 46.7 përqind në vitin 2014. Ndërsa, shpenzimet e personelit dhe shpenzimet administrative u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.7 përqind (rënie prej 1.5 përqind në vitin 2014). Shpenzimet tjera operative po ashtu shënuan rënie prej 4.5 përqind në krahasim me rritjen prej 7.3 përqind në vitin paraprak. Rënia e shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve tjera operative ndikoi i kontribuoi ngadalësimit të rritjes së gjithsej shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Në vitin 2015, ky indikator u zvogëlua në 88.4 përqind, krahasuar me 96.2 përqind sa ishte deri në vitin 2014. Kjo ishte si rezultat i rritjes së përshpejtuar të të hyrave të sektorit mikrofinanciar deri në vitin 2015 dhe ngadalësimit të shpenzimeve gjatë kësaj periudhe.

Profiti i realizuar deri në vitin 2015 ndikoj në përmirësimin e konsiderueshëm të treguesve të profitabilitetit ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) u përmirësua në 2.1 përqind (0.6 përqind në vitin 2014), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 7.6 përqind (2.4 përqind në vitin 2014) (figura 59).

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive jo-performuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive jo-performuese. Në vitin 2015, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 4.2 përqind, në krahasim me normën prej 4.8 përqind sa ishte në vitin 2014. Gjithashtu, mbulueshmëria me provizione u përmirësua konsiderueshëm në 124.7 përqind në vitin 2015, krahasuar me nivelin prej 113.1 përqind në vitin 2014 (figura 60).

Figura 59.Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Figura 60. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

3.7. Projeksionet makroekonomike për vitin 2016

Projeksionet e BQK-së për vitin 2016 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me rritje reale prej 3.7 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e BPV-së.

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 2.3 përqind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 2.9 përqind dhe konsumi publik do të mbetet në nivel të ngjashëm me atë të vitit të kaluar. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit privat, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave dhe rritja e kredive. Deri në fund të vitit 2016, remitencat pritet të shënojnë rritje vjetore prej rreth 3.0 përqind, që është rritje më e ulët krahasuar me rritjen prej 8.4 përqind të shënuar në vitin e kaluar. Kjo rritje më e ngadalësuar e remitencave kryesisht i atribuohet faktit se rritja e lartë e remitencave në vitin e kaluar ka ndikuar në ngritjen e bazës së remitencave. Gjithashtu, kreditë për ekonomitë familjare, të cilat në dy vitet e fundit kanë shënuar rritje të konsiderueshme (10.2 përqind në vitin 2014 dhe 9.7 përqind në vitin 2015), pritet të vazhdojnë këtë trend të rritjes edhe në vitin 2016.

Investimet në vitin 2016 parashihet të shënojnë rritje më të lartë se sa në vitin 2015. Norma reale e rritjes së investimeve të përgjithshme në vitin 2016 pritet të jetë 9.7 përqind krahasuar me 9.1 përqind sa vlerësohet të ketë qenë në vitin 2015. Për dallim nga viti 2015, kur investimet publike shënuan rënie të lehtë, viti 2016 pritet të karakterizohet me rritje të konsiderueshme të investimeve publike, të cilat pritet të shënojnë rritje reale prej 11.7 përqind. Poashtu, investimet private, të cilat në vitin e kaluar përbënin rreth 74.6 përqind të gjithsej investimeve, pritet të shënojnë rritje në vitin 2016. Norma reale e rritjes së investimeve private pritet të jetë rreth 9.0 përqind. Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve private pritet të vazhdojë të ketë

kreditimi bankar, i cili po karakterizohet me ritëm më të shpejtë të rritjes dhe me norma më të ulëta të interesit. Po ashtu, ndryshimet në politikën tatimore si lirimi nga TVSH-ja i linjave të prodhimit dhe makinerive që ndërlidhen me atë prodhim, si dhe lirimi nga TVSH-ja i pajisjeve të teknologjisë informative, pritet të nxisin investimet private. Rritjes së pozicionit të përgjithshëm të investimeve pritet t'i kontribuojë edhe rritja e IHD-ve, të cilat edhe në vitet paraprake kanë qenë të lidhura pozitivisht me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.

Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2016 pritet të vazhdojnë të kenë ndikim negativ në rritjen e BPV-së. Ky ndikim negativ i neto eksporteve i atribuohet rritjes së kërkesës së brendshme e cila pritet të ndikojë në rritjen e importit. Në kuadër të mallrave, parashikimet aktuale janë se eksportet do të rriten për rreth 3.4 përqind në terma real, ndërsa importet pritet të rriten për rreth 3.7 përqind. Rrjedhimisht, deficiti tregtar i mallrave pritet të thellohet për rreth 3.8 përqind në terma real. Në anën tjetër, pozicioni tregtar pozitiv në kuadër të shërbimeve pritet të mbetet në nivel të ngjashëm me vitin e kaluar.

Trendi i çmimeve në Kosovë është kryesisht në linjë me lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht çmimet e ushqimit dhe të naftës. Këto dy kategori të produkteve, të cilat përbëjnë rreth 50 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, janë karakterizuar me rënie të çmimeve në vitin 2015 dhe pritet të mbesin stabile në vitin 2016. Rrjedhimisht, ekonomia e Kosovës e cila ishte karakterizuar me deflacion prej 0.5 përqind në vitin e kaluar, pritet të karakterizohet me një shkallë të ulët të inflacionit prej rreth 0.6 përqind në vitin 2016.

Norma vjetore e rritjes së kreditimit bankar në vitin 2016 pritet të jetë e ngjashme me vitin e kaluar, rreth 7 përqind. Lehtësimi i standardeve të kreditimit nga bankat, rënia e normave të interesit në kredi, por edhe rritja e kërkesës së përgjithshme në vend pritet të nxisin rritjen e kërkesës për kredi. Parashikimet e BQK-së për rritje të kreditimit janë gjithashtu në linjë me raportimet e bankave në kuadër të anketës së kreditimit bankar, rezultatet e së cilës sugjerojnë se do të ketë përshpejtim të aktivitetit kreditor gjatë periudhave në vazhdim. Edhe depozitat pritet të vazhdojnë trendin e rritjes që i ka karakterizuar në vitet e fundit. Bartësit kryesorë të rritjes së depozitave do të vazhdojnë të jenë ekonomitë familjare. Rritja e depozitave të ekonomive familjare gjatë vitit 2016 pritet të jetë rreth 6.4 përqind. Rrjedha e pritur e depozitave është e lidhur me të ardhurat kombëtare të disponueshme të cilat pritet të rriten për 4.1 përqind në vitin 2016.

4. Mbikëqyrja, rregullimi dhe licencimi i institucioneve financiare

Edhe gjatë vitit 2015, mbikëqyrja financiare ka vazhduar me projekte zhvillimore për të avancuar më tej mbikëqyrjen financiare në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare dhe për të krijuar një kornizë të përshtatshme rregullative, e cila mundëson një mbikëqyrje adekuate të institucioneve financiare në Republikën e Kosovës. Këto projekte janë pjesë e reformave dhe përpjekjeve të vazhdueshme të mbikëqyrjes financiare për të plotësuar rekomandimet e nxjerra të misionit për vlerësimin e sektorit financiar FSAP të kryer nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore në vitin 2012. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 banka qendrore ka qenë pjesë e grupeve punuese dhe diskutimeve të vazhdueshme në kuadër të aktiviteteve të qeverisë lidhur me marrëveshjen e stabilizim associmit – MSA, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe identifikimit të çështjeve që duhet të adresohen për përafrim të mëtejmë të legjislacionit me Direktivat e BE-së, për sa i përket rregullimit të sektorit financiar, banka qëndrore ka kontribuar në përgatitjen e planit të veprimit për sa i përket aktiviteteve të parapara për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga MSA.

Projektet në vijim, janë mbështetur nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare duke adaptuar praktikat më të reja ndërkombëtare, që kanë marrë në konsideratë edhe ndryshimet e fundit në fushën e rregullimit të institucioneve financiare pas krizës së fundit financiare të vitit 2008. Në vijim janë të paraqitura më hollësisht projektet e zhvilluara gjatë vitit 2015.

4.1. Kalimi nga Bazel I në Bazel II

Mbikëqyrja financiare ka zgjedhur një qasje graduale drejt përafrimit me standardet ndërkombëtare me fokus të veçantë direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian për mbikëqyrjen e bankave, të cilat rregullojnë veprimtaritë e institucioneve kreditore dhe përcaktojnë kërkesat për kapitalin e tyre. Ky është një proces gradual, duke marrë në konsideratë se pas krizës së fundit financiare të vitit 2008, standardet ndërkombëtare të njohura si Korniza e Bazel II, kanë pësuar mjaft ndryshime, për adresimin e çështjeve të cilat janë konsideruar si faktor nxitës të krizës financiare, si dhe duke konsideruar zhvillimin dhe nevojat e sistemit bankar të Kosovës.

Në këtë drejtim, BQK-ja gjatë viteve 2014 dhe 2015 ka vazhduar me nxjerrjen e rregulloreve ekzistuese dhe adaptimin e disa rregulloreve të reja me që rast janë adresuar një numër i kërkesave për bankat në pajtim me standardet e Bazel-it II sipas qasjeve të standardizuara. Megjithatë, harmonizimi i rregullativës ekzistuese për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave me Kornizën e Bazel-it për kërkesat e kapitalit dhe direktivat evropiane është një projekt kompleks dhe kërkon kohë, prandaj, me strategjinë e BQK-së është paraparë të finalizohet përgjatë periudhës 2015 – 2019.

Gjatë vitit 2015, në drejtim të kornizës së Bazel II janë bërë ndryshime të rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, me anë të së cilës përcaktohen kërkesat për kapital për të adresuar kërkesat ndaj kredive hipotekare rezidenciale. Ky ndryshim ka rrjedh si rezultat i adaptimit të rregullores së re për kreditë hipotekare rezidenciale, e cila është e bazuar në Direktivën e BE-së dhe standardet e Bazel-it. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 janë përgatitur dy rregullore të rëndësishme për sa i përket adaptimit të kërkesave të Basel-it, rregullorja për përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore për qëllim të llogaritjes së kapitalit rregullativ, e cila tani veç është në fuqi pasi është miratuar nga Bordi i BQK-së me 28 janar 2016, si dhe rregullorja për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, , e miratuar nga Bordi me 29 prill 2016, pasi që janë kryer të gjitha përgatitjet dhe studimet e impaktit të saj në sektorin bankar.

Mësimet e krizës së vitit 2008 nxorën në pah nevojën për rishikimin e Bazel II, që sot në termat e një kornize të rishikuar njihet si Bazel III (ose Direktiva IV e kapitalit dhe rregullorja të njohura si "The Single Rule Book"). Këto ndryshime kryesisht përfshijnë rishikimin e kërkesave për kapital dhe elementeve përbërëse të kapitalit me qëllim të ngritjes së cilësisë, vendosjen e kërkesave për qëllime të monitorimit të rrezikut të likuiditetit, raportit të leverazhit etj.

Sipas planit të mbikëqyrjes bankare për harmonizimin e rregullativës me Bazel II dhe Direktivat e BE-së, do të vazhdohet me plotësimin e kornizës rregullative për të adaptuar kërkesat e nevojshme të nxjerra nga këto standarde edhe gjatë viteve në vijim, me fokus të veçantë në adaptimin e plotë të shtyllës së parë dhe avancimin e mëtejmë të adaptimit të shtyllës së dytë të Bazel II.

Me këto ndryshime parashihet një adaptim i plotë i qasjes së standardizuar për peshimin me rrezik të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, duke zgjeruar numrin e klasave të ekspozimit për të reflektuar ndaj zhvillimeve të tregut bankar në Kosovë, si dhe duke adaptuar parimet dhe rregullat më të sofistikuara për përllogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezik, për secilën klasë ekspozimi; parimet dhe metodat e njohjes së teknikave të zbutjes ndaj rrezikut kreditor. Gjithashtu, do të adaptohen edhe kërkesat për kapital për mbulimin e rrezikut të tregut, si dhe do të rishikohet përkufizimi i kapitalit sipas kornizës së re të Bazel III.

Si hap tjetër i rëndësishëm i këtij projekti është edhe përshtatja e kërkesave të shtyllës së dytë – lidhur me rishikimin nga mbikëqyrësi të procesit të brendshëm të bankave për vlerësimin e nevojave të bankës për kapital. Gjithashtu me hyrjen në fuqi të kërkesave të reja për kapital, do të rishikohen dhe përditësohen edhe kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat, të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës për palët e interesit dhe të cilat janë të njohura si kërkesat e shtyllës së tretë të Kornizës së Bazelit me qëllim rritjen e disiplinës së tregut përmes kërkesave për shpalosje dhe rritjen e transparencës.

Në këtë drejtim, në shtator të vitit 2014, BQK-ja ka startuar me projektin specifik për adaptimin dhe implementimin e kornizës rregullative të njohur si Korniza Bazel-it për Kapitalin. Si një objektiv afatgjatë i Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe si një ndër qëllimet kryesore strategjike, BQK-ja ka filluar këtë projekt duke marrë mbështetje të fuqishme nga institucioni Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ.

Gjatë tremujorit të parë është bërë një studim i hollësishëm krahasues i kornizës ligjore dhe rregullative ekzistuese në raport me standardet e Bazel-it për të identifikuar fushat të cilat nuk janë në pajtueshmëri, dhe të cilat kërkojnë ndryshime dhe plotësime të nevojshme. Gjatë dy viteve në vijim do të punohet me intensitet të shtuar në adaptimin e standardeve të Bazel-it dhe për të harmonizuar kornizën ligjore dhe rregullative me direktivat specifike të BE-së rreth kësaj fushe. Duke marr parasysh se Kosova ka një sektor bankar jo shumë kompleks në krahasim me vendet e zhvilluara, nga aspekti i zhvillimit të shërbimeve financiare dhe ekspozimit ndaj instrumenteve të avancuara financiare, vlerësohet se brenda kësaj periudhe dyvjeçare do të arrihet adaptimi i plotë i standardeve dhe kërkesave kryesore, për aq sa janë të aplikueshme për specifikat e sektorit bankarpër avancimin e mëtejmë të rregullimit dhe mbikëqyrjes së bankave që operojnë në Republikën e Kosovës.

4.2. Mbështetja për Likuiditet Emergjent

Mbështetja për Likuiditet Emergjent (MLE) ka të bëjë me krijimin e kornizës mbrojtëse për sektorin bankar në raste kur bankat janë solvente por jolikuide. Angazhimi në këtë fushë është shtrirë në dy drejtime, në atë të zhvillimit të metodologjisë dhe të rregullores. MLE është një skeme që përbëhet nga tri burime të financimit, duke përfshirë: Buxhetin e Kosovës, BQK-në dhe rezervat e detyrueshme të bankave komerciale.

Me datë 30 shtator 2015, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës miratoi Rregulloren për Mbështetje Emergjente për Likuiditet, e cila përfshinë edhe dy formularët e veçantë. Përveç rregullores në fjalë, BQK miratoi edhe Procedurën për Mbështetje Emergjente për Likuiditet, që fuqizon më tutje rregulloren në aspektin operacional.

4.3. Mbikëqyrja e bazuar në rrezik për institucionet bankare

Me qëllim të zbatimit të strategjisë mbikëqyrëse dhe përafrimit të standardeve dhe praktikave mbikëqyrëse të Bashkimit Evropian, BQK-ja gjatë vitit 2015 me përkrahje të asistencës teknike nga FMN ka finalizuar metodologjinë e re mbikëqyrëse - mbikëqyrja e bazuar në rrezik. Kjo metodologji, ka si qëllim identifikimin e rreziqeve kritike dhe potenciale, me të cilat ballafaqohet një institucion, ku përmes rishikimit të fokusuar nga mbikëqyrja, vlerësohet menaxhimi i këtyre rreziqeve nga ana e institucioneve dhe aftësia financiare e institucionit për të përballuar pasojat potenciale negative. Me qëllim të zbatimit të kësaj metodologjie është përpiluar Manuali i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për banka, ku gjatë viteve 2014 dhe 2015, përjashtuar disa banka që janë të vogla dhe hapur së fundmi, pothuajse të gjitha bankat janë ekzaminuar (ekzaminimi i plotë) konform Manualit të ri të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për banka.

Manuali i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për banka, në gusht 2015 është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së, që njëherësh rrumbullakëson punën e bërë në këtë dokument, si dhe konsiderohet avancim substancial në fushën e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për banka.

Si rrjedhojë, kjo çasje e mbikëqyrjes është treguar shumë pro aktive, e cila ka mundësuar përcjelljen më të afërt të bankave, duke u fokusuar në rreziqet më të mëdha me të cilët janë duke u shoqëruar ato. Manuali përfshin një kombinim të matricës së rreziqeve, e cila merr parasysh katër llojet e rreziqeve bankare si: rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional në njërën anë, si dhe aplikimin e sistemit "CAMELS" të vlerësimit të bankave në anën tjetër.

4.4. Sistemi Rregullativ i Raportimit të Mbikëqyrjes nga Jashtë

Mbikëqyrja Financiare gjatë vitit 2015 ka finalizuar ndërtimin e kornizës së re raportuese për institucionet financiare. Fillimisht është punuar në krijimin e kornizës së re raportuese duke nënkuptuar formularët e raportimit dhe udhëzimet për raportim, për të vazhduar me ndërtimin e softuerit për raportimin të drejtpërdrejtë (on-line) të informatave financiare, përpunimin e tyre si dhe gjenerimin e raporteve. Projekti është finalizuar në pjesën e parë të vitit 2016 duke përfshirë të gjitha ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore, përfshirë edhe aprovimin e ndryshimeve në Rregulloret për Raportimin e Bankave, Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare në BQK.

Implementimi i Sistemit Rregullativ të Raportimit të Mbikëqyrjes nga Jashtë për mbikëqyrjen financiare dhe institucionet financiare në përgjithësi do të ndikojë në përafrimin e raportimit të institucioneve financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe realizimin e një qasje prudente në mbikëqyrjen e këtyre institucioneve, dhe në rritjen e sigurisë së të dhënave, përpunimin elektronik të tyre, mbikëqyrjen më efektive dhe raportimin më të saktë nga institucioneve financiare në BQK.

4.5. Korniza rregullative dhe procesi i licencimit

4.5.1. Korniza rregullative

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, që nga themelimi i saj, e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, Thesari Amerikan, KfW, GIZ, Banka Qendrore Evropiane, etj., ka ndërtuar një kornizë rregullative për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. BQK-ja, gjatë viteve të fundit, ka filluar një proces gradual drejt përafrimit me Principet bazike për mbikëqyrjen e bankave të nxjerra nga BIS – Bank for International Settlements, Principet bazike për mbikëqyrjen e kompanive të sigurimeve të nxjerra nga IAIS – International Association for Insurance Supervision dhe direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë, që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim të drejtë të këtyre standardeve për nevojat e sektorit financiar në Kosovë. Kjo duke marr parasysh edhe faktin se këto standarde kanë pësuar ndryshime të shumta edhe në vendet e zhvilluara kryesisht në dekadën e fundit, kështu që vazhdimisht kërkohet rishikimi dhe plotësimi i tyre.

Përpilimi dhe rishikimi i rregulloreve të mbikëqyrjes financiare (banka, institucione mikro-financiare, institucione financiare jobankare, sigurime dhe fonde pensionale) bëhet nga grupet punuese, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të departamenteve përkatëse, si departamentit të mbikëqyrjes bankare, licencimit, sigurimeve, pensioneve, departamentit juridik si dhe departamentet tjera varësisht nga fusha që adresohet dhe ndërlidhja e saj me departamentet përkatëse të BQK-së. Gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe çdo instrumenti rregullativ, BQK-ja bashkëpunon me industrinë, përmes takimeve dhe komunikimit të vazhdueshëm me subjektet e rregulluara, kryesisht përmes shoqatave përkatëse të institucioneve, si Shoqatën e Bankave të Kosovës, Shoqatën e Sigurimeve, Shoqatën e Institucioneve Mikrofinanciare, në një proces transparent , me anë të cilit i'u ofrohet mundësia të gjitha palëve të interesit të japin komentet e tyre gjatë procesit të përgatitjes. Ky proces ka ndihmuar vazhdimisht në qartësimin e çështjeve specifike, të cilat adresohen me rregullore dhe rregullimin e drejtë të tyre, duke marr parasysh ndikimin e tyre në stabilitetin e sistemit financiar në Kosovë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

4.5.2. Aktet e reja rregullative bankare gjatë vitit 2015

Gjatë vitit 2015 janë përgatitur rregulloret në vijim për rregullimin e institucioneve bankare:

Rregullore për vlerësimin e pasurive të paluajtshme (e aprovuar nga Bordi i BQK-së më 26 shkurt 2015)

Rregullore për kreditë hipotekare rezideniale (e aprovuar nga Bordi i BQK-së më 22 dhjetor 2015)

Amandamentimi i Rregullores për shpërndarjen e mjeteve të kredisë (e aprovuar nga Bordi i BQK-së më 22 dhjetor 2015)

Rregullorja për kasafortën e bankave (e aprovuar nga Bordi i BQK-së më 30 prill 2015)

Rregullore për përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore për qëllim të llogaritjes së kapitalit rregullativ (e aprovuar nga Bordi i BQK-së më 28 janar 2016)

Rregullore për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankave (e aprovuar nga Bordi i BQK-së më 29 prill 2016)**.**

4.5.3. Aktet e reja rregullative për mbikëqyrjen IMF-ve dhe IFJB-ve

Gjatë vitit 2015 janë përgatitur dhe miratuar edhe rregulloret në vijim për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare:

Rregullore për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e institucioneve financiare jobankare (e aprovuar më 28 maj 2015);

Rregullore për shpërndarjen e mjeteve të kredisë për IMF dhe IFJB (aprovuar më 22 dhjetor 2015);

4.5.4. Plotësimi i Kornizës rregullative për mbikëqyrjen e kompanive të sigurimit

Më 30 nëntor të vitit 2015 është miratuar në kuvend Ligji për sigurimet dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me 24 dhjetor 2015. Gjithashtu, më 23 qershor të vitit 2015 është miratuar rregullorja për përcaktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës së primit, që siguruesit duhet të zbatojnë në caktimin e primit për sigurimin e detyrueshëm.

Gjatë vitit 2015 kanë vazhduar punën grupet punuese të caktuara për ndryshimin e rregulloreve për mbikëqyrjen e sigurimeve, në mënyrë që rregullat ekzistuese të transformohen në rregullore të bazuara në Ligjin e ri për sigurimet. Këto grupe kanë finalizuar amandamentimet e pothuajse të gjitha rregullave të sigurimeve duke transformuar ato në rregullore të bazuara në ligjin e ri dhe duke bërë plotësimet/ndryshimet e nevojshme, varësisht nga nevojat e identifikuara gjatë ekzaminimit dhe mbikëqyrjes së kompanive të sigurimet përgjatë kësaj periudhe mbi dhjetëvjeçare të ekzistimit të tyre.

Në kuadër të këtij procesi janë finalizuar dhe janë miratuar nga Bordi i BQK-së rregulloret në vijim:

- Rregulloren për depozitimin e aseteve si garancë, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetin (30 prill 2015);
- Rregulloren për përcaktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia (23 qershor 2015);
- Rregulloren për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve (25 shkurt 2016);
- Rregulloren për bashkimet dhe përvetësimet (25 shkurt 2015);
- Rregulloren për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit (31 mars 2016);
- Rregulloren për hapjen e zyrave përfaqësuese brenda Republikës së Kosovës nga siguruesit e jashtëm (31 mars 2016);
- Rregulloren për auditimin e jashtëm të sigurimeve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (28 prill 2016);
- Rregulloren për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të siguruesve (28 prill 2016);
- Rregulloren për vlerësimin dhe mbajtjen e provizioneve teknike dhe matematike për siguruesit jetë dhe jojetë (28 prill 2016);

Aktualisht janë në proces të finalizimit rregulloret në vijim për mbikëqyrjen e sigurimeve:

- Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të siguruesve;
- Rregullore për publikimin e informacionit;

- Rregullore për delegimin e funksioneve
- Rregullore për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime;
- Rregullore për licencimin e trajtuesve të dëmeve në sigurime;
- Rregullore për kontratat e sigurimit;
- Rregullore për arbitrazhin;
- Rregullore për drejtorët dhe menaxherët e lartë;
- Rregullore për publikimin e informacionit;
- Rregullore për vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve;
- Rregullore për raportimin e siguruesve; dhe
- Rregullore për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Republikës se Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të siguruesve; dhe
- Rregullore për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve të siguruesve.

Përgatitja dhe miratimi i amandamentimit të këtyre rregulloreve është përcaktuar me prioritet të lartë për vitin 2016 në mënyrë që të përgatitet korniza e nevojshme rregullative për adaptimin e kërkesave të reja të Ligjit të ri të sigurimeve.

4.5.5. Plotësimi i Kornizës rregullative për mbikëqyrjen e fondeve pensionale

Gjatë vitit 2015 është vazhduar me amandamentimin e kornizës rregullative për mbikëqyrjen e pensioneve në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për fondet pensionale dhe adresimin e çështjeve që ndërlidhen me mbikëqyrjen e fondeve pensionale të cilat është vlerësuar e nevojshme të adresohen me anë të legjislacionit sekondar bazuar në kërkesat e Ligjit për fondet pensionale.

Divizioni për rregullativë në bashkëpunim me Divizionin për mbikëqyrjen e fondeve pensionale gjatë vitit 2015 kanë përgatitur rregulloret në vijim, të cilat edhe janë miratuar nga Bordi i BQK-së:

Rregullore mbi llogaritë individuale të pjesëmarrësve (e miratuar nga Bordi i BQK-së më 30 prill 2015);

Rregullore për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për tërheqjen e mjeteve nga FKPK-ja për pjesëmarrësit me emigrim të përhershëm (e miratuar nga Bordi i BQK-së më 23 qershor 2015);

4.5.6. Plotësimi i Rregullores për PPP/FT dhe përgatitja e manualit

Gjatë vitit 2015 është finalizuar rishikimi i Rregullores për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, nga grupi punues i përbërë nga anëtarët e Divizionit për PPP/FT dhe Divizionit të standardizimit dhe rregullimit. Drafti i kësaj rregulloreje me ndryshimet e reja me qëllim të adaptimit të kërkesave të ndryshimeve të fundit të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave është i finalizuar dhe janë marrë në konsideratë edhe komentet e industrisë rreth këtij drafti, i cili pritet që të aprovohet nga Bordi i BQK-së gjatë vitit 2016. Gjithashtu, janë shqyrtuar edhe amandamentet në proces të Ligjit për AML të cilat BQK i ka dorëzuar te grupi punues, i caktuar në kuadër të Ministrisë së Financave.

4.6. Manuali për likuidimin e bankave

Gjatë vitit 2015 është vazhduar me rishikimin e manualit për likuidimin e bankave, në mënyrë që të adresohen kërkesat e reja ligjore dhe të krijohet një kornizë e qartë operacionale për

adresimin e rasteve kur bankat mund të hasin në vështirësi, në mënyrë që të krijohen procedurat adekuate për adresimin e shpejt dhe të drejtë të tyre. Me anë të ndryshimeve të reja do të krijohet një infrastrukturë e qartë institucionale në kuadër të BQK-së dhe do të specifikohen saktë procedurat që duhet ndjekur në rast të marrjes nën administrim apo likuidimit të bankave. Këto procedura specifike do të lehtësojnë dhe shpejtojnë veprimet e mundshme të BQK-së në bashkëpunim me akterët relevantë siç është Fondi për Sigurimin e Depozitave, duke qartësuar mënyrën e komunikimit ndërmjet tyre dhe përgjegjësitë e veprimit për secilin autoritet. Kjo do të lehtësojë zgjidhjen e problemeve të mundshme dhe adresimin e drejtë të tyre në të ardhmen, në rastet kur është e nevojshme ndërhyrja e BQK-së për të përmirësuar dhe zgjidhur problemet e bankave.

4.7. Licencimi

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka për objektiv parësor nxitjen dhe mbajtjen e një sistemi të shëndoshë dhe të qëndrueshëm financiar. Ky objektiv është i lidhur ngushtë me detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Licencimit dhe Standardizimit (DLS). Përgjegjësi kryesore e DLS-së është licencimi i të gjitha institucioneve financiare, aspektet e rregullimit dhe standardizimit të tyre, si dhe të mbrojtjes së klientëve të këtyre institucioneve. Kriteret e licencimit të përcaktuara me legjislacion, synojnë sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar të drejtat e tyre dhe trajtimin e barabartë të të gjithë investitorëve sipas kërkesave ligjore në Kosovë të bazuara në standardet e Bashkimit Evropian.

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2015 është si në vijim: numri i bankave që operojnë në Republikën e Kosovës është 10, prej të cilave 4 janë filiala të grupeve të njohura bankare me origjinë të kapitalit nga vendet e Bashkimit Evropian, përderisa 4 janë degë të bankave të huaja dhe dy janë banka me kapital vendor. Bankat në Kosovëushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Përveç këtyre dhjetë bankave, struktura e sistemit financiar në Kosovë përbëhet edhe nga 1 zyrë përfaqësimi e bankës së huaj, 13 institucione mikrofinanciare, si dhe 49 institucione financiare jobankare, të ndara sipas aktiviteteve: 4 me aktivitet të kredidhënies/lizingut, 1 me aktivitet të faktoringut, 6 me aktivitet të shërbimit të transferit dhe pagesave dhe 38 me aktivitet të këmbimit të valutave.

Figura 61. Struktura e sistemit financiar në Kosovë



Në përputhje dhe në zbatim të kërkesave që rrjedhin nga Ligji nr. 03/L-093 për banka, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe të funksionimit normal të aktivitetit bankar, BQK-ja, gjatë vitit 2015 ka marrë vendime që lidhen me:

- dhënien e licencës përfundimtare për bankën e huaj për hapjen e degës në Prishtinë;
- aprovimin lidhur me zgjatjen e afatit për operimin e zyrës përfaqësuese "Atlas Bank" në Prishtinë;
- aprovimin për regjistrimin e dy institucioneve financiare jobankare;
- aprovimin për shtimin e aktivitetit të lizingut operativ për një institucion financiar jobankar;
- aprovimi për ndryshimin e emrit të një institucioni financiar jobankar;
- aprovimin e ndryshimeve për statute të bankave dhe institucioneve financiare;
- aprovimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të bankave dhe institucioneve financiare;
- aprovimin e shitblerjes së aksioneve të institucioneve financiare;
- aprovimin për hapje, zhvendosje, mbyllje të degëve dhe nëndegëve të bankave;
- aprovimin për hapje, zhvendosje të zyrave / agjenteve të IMF-ve dhe IFJB-ve;
- aprovimin e auditorëve të jashtëm të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve dhe siguruesve.

Aktiviteti licencues i BQK-së, gjatë vitit 2015 konsistoi në dhënien e licencës përfundimtare për T.C. Ziraat Bankasi A.S. Ankara, Turqi, për hapjen e degës në Prishtinë, si dhe aprovimin e zgjatjes së afatit të operimit të zyrës përfaqësuese në Prishtinë të Atlas Bankës AD, Mali i Zi, në Prishtinë.

Gjithashtu janë aprovuar regjistrimet për 2 institucione financiare jobankare për ushtrimin e aktivitetit të këmbimit valutor. Në funksionin e zgjerimit të aktiviteteve gjatë këtij viti BQK-ja ka aprovuar shtimin e aktivitetit të lizingut operativ për institucionin financiar jobankar Raiffeisen Leasing Kosova.

Në procesin licencues, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave, duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësive. Bazuar në rregullativën në fuqi, BQK-ja ka aprovuar 5 anëtar të rinj të Bordit të drejtorëve, 1 anëtar të Komitetit të auditimit, 1 drejtor të degës së bankës së huaj si dhe 4 menaxherë të lartë të bankave.

Në të njëjtën kohë, BQK-ja ka aprovuar drejtorë dhe menaxherë të lartë të institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare. Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar 6 anëtarë të ri të Bordit të drejtorëve, 4 kryeshef ekzekutiv dhe 1 menaxher i lartë. Po ashtu është refuzuar edhe një kërkesë për emërimin e kryeshefit ekzekutiv si kryetar i Bordit të drejtorëve.

Figura 62. Numri i bankave, degëve dhe nëndegëve të bankave



Burimi: BQK (2016)

Bankat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me degë/nëndegë të hapura brenda territorit të vendit (shih tabelën 1). BQK-ja në këtë vit ka aprovuar hapjen e 4 nëndegëve, 12 zhvendosje të degëve dhe nëndegëve, si dhe mbylljen e 16 nëndegëve. Bankat edhe këtë vit kanë vazhduar me mbylljen e nëndegëve, ku janë mbyllur 13 nëndegë, kryesisht njësi të vogla pas vlerësimit të performancës dhe efikasitetit të tyre, si dhe për arsye se bankat kohëve të fundit kanë investuar në zgjerimin e shërbimeve të automatizuara në mënyrë, që t'ju ofrojnë klientëve mundësi për të kryer transaksionet përmes: e-banking, bankomatëve, terminaleve të shitjes.

Tabela 6. Numri i bankave, degëve dhe nëndegëve të bankave

Vitet	Banka	Degët	Nëndegët
2004	7	45	194
2005	7	35	171
2006	6	33	170
2007	9	34	183
2008	8	46	233
2009	8	49	238
2010	8	49	254
2011	8	43	259
2012	9	43	258
2013	9	44	245
2014	9	45	223
2015	10	45	210

Burimi: BQK (2016)

Shpërndarja gjeografike e degëve dhe nëndegëve të bankave përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit. Vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe nëndegëve bankare në regjionin e Prishtinës (35%), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (25%).

Tabela 7. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe nëndegëve të bankave

Vitet	Prishtinë		Prizren		Pejë		Gjilan		Mitrovicë		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2004	60	24%	37	15%	60	24%	59	24%	30	12%	246
2005	68	32%	39	18%	35	16%	39	18%	32	15%	213
2006	68	33%	37	18%	37	18%	41	20%	26	12%	209
2007	70	31%	39	17%	40	18%	45	20%	32	14%	226
2008	97	34%	44	15%	51	18%	59	21%	36	13%	287
2009	97	33%	46	16%	52	18%	64	22%	36	12%	295
2010	100	32%	49	16%	57	18%	66	21%	39	13%	311
2011	102	33%	50	16%	59	19%	64	21%	35	11%	310
2012	101	33%	50	16%	59	19%	67	22%	33	11%	310
2013	102	34%	47	16%	52	17%	62	21%	35	12%	298
2014	97	35%	45	16%	46	17%	55	20%	34	12%	277
2015	93	35.1%	40	15.1%	45	17.0%	52	19.6%	35	13.2%	265

Burimi: BQK (2016)

Ndërsa, sa i përket aktivitetit të industrisë së sigurimeve, gjatë vitit 2015, janë pranuar gjithsej 488 kërkesa për aprovim, të formave të ndryshme duke filluar nga aplikacione për sigurues, ndërmjetësues (kompani brokerimi, kompani të agjentëve, rregullues/trajtues të dëmeve dhe agjent në sigurime), shpërndarje dividende dhe ndryshim emri kompanie dhe shitblerje të aksioneve të kompanisë dhe vendime për transferim të tyre dhe kapitalit themeltar, aprovim të statuteve dhe ndryshimi i tyre dhe vendimeve, aprovim kryetareve/anëtareve të bordit dhe menaxhmentit të lartë (zëvendës kryeshefa ekzekutive, dhe drejtorë të departamenteve përkatëse), auditorëve të brendshëm dhe jashtëm, brokër individual, agjentë të brendshëm dhe jashtëm, aprovime të hapjes (rivendosjeve) së zyrave dhe licencimin dhe aprovimin e produkteve të reja dhe ndryshimin e kushteve dhe tarifave për produkte.

Figura 63. Shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe rrjetit të degëve/nëndegëve të bankave sipas regjioneve



Burimi: BQK (2016)

Figura 64. Numri i siguruesve, degëve, nëndegëve dhe agjentëve të siguruesve



Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të aprovimeve dhe refuzimeve (anulimeve të aplikacioneve nga vetë institucionet që merren me sigurime dhe anulimeve nga ana e BQK-së për mos përmbushje të kritereve për aprovim), janë procesuar si vijon:

Janë dhënë dy 2 licenca kompani të sigurimeve, për Kompaninë e sigurimeve Scardian dhe Prisig dhe 2 ndërmjetësues të sigurimeve, "L.I.F.E Kosova" SH.P.K (kompani e agjentëve për sigurimet jetë), TEB - ndërmjetësuesi në sigurime (aktivitet shtesë) dhe është refuzuar kërkesa për licencimin e një ndërmjetësuesi të sigurimeve.

Janë aprovuar 14 drejtorë të departamenteve-menaxhmentit të lartë të industrisë të sigurimeve (ku 2 nga këta janë të BKS-së).

Janë aprovuar 2 anëtarë të bordit (kompanive të sigurimit) dhe 8 anëtarë të bordeve, dhe refuzuar një anëtar bordi;

Është aprovuar ndryshimi i emrit dhe shitblerja e aksioneve të Kompanisë së Sigurimeve Dardania SH.A. tek kompania e sigurimeve EUROSIG SH.A; aprovimi i ndryshimit të emrit të kompanisë së sigurimeve "SIGMA" SH.A, në "SIGMA Interalbanian Vienna Innsurance Group" SH.A.; aprovimi i shpërndarjes së dividendës së kompanisë së sigurimeve "SIGMA Interalbanian Vienna Insurance Group" SH.A, si dhe është aprovuar ndryshimi i statutit të kompanisë së sigurimeve Croatia Sigurimi.

Janë aprovuar gjithsej 26 auditorë të jashtëm, 15 nga të cilët ju takojnë kompanive të sigurimeve, 8 ndërmjetësuesve për sigurime dhe pjesa tjetër prej 3, BKS-së, Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Fondit Slloveno-Kosovar, ndërsa në kuadër të auditorëve të brendshëm janë aprovuar 6 auditorë, që të gjithë janë të kompanive të sigurimeve.

Në të njëjtën kohë janë aprovuar 2 brokerë të pavarur për ndërmjetësime në sigurime.

Gjithashtu, janë aprovuar 171 agjentë të brendshëm në sigurime (refuzuar një (1) agjent i brendshëm në sigurime dhe për 9 agjentë të brendshëm është anuluar procedura nga vetë kompanitë apo BQK-ja për mungesë dokumentacioni dhe mospërmbushje kritereve), dhe po ashtu janë aprovuar 53 agjentë të jashtëm në sigurime të kompanive të sigurimeve.

Gjatë vitit 2015, janë aprovuar 91 hapje të zyrave të reja (zyra qendrore, filiala dhe zyra të reja), dhe 20 rivendosje (zhvendosje) të zyrave aktuale.

Në kuadër të aprovimeve për produkte të reja, janë aprovuar 29 produkte të reja vullnetare, ndryshim i kushteve dhe tarifave ekzistuese, si dhe është aprovuar TPL për dy kompanitë e reja të sigurimeve "Scardian" dhe "Prisig".

Tabela 8. Numri i siguruesve, filialeve, degëve dhe agjentëve të siguruesve

Vitet	Zyre qendrore	Filiale	Degë	Agjent (agjent / operator)	Nga të cilat Agjent të jashtëm
2008	8	48	179	364	na
2009	9	48	186	390	na
2010	10	49	206	424	na
2011	11	51	224	447	na
2012	11	56	240	458	na
2013	12	56	268	492	na
2014	13	69	316	538	20
2015	15	74	436	717	71

Burimi: BQK (2016)

Tabela 9. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve

Vitet	Prishtinë		Prizren		Pejë		Gjilan		Mitrovicë		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2008	7	14%	9	18%	14	28%	14	28%	7	14%	51
2009	7	14%	9	18%	14	28%	14	28%	7	14%	51
2010	9	17%	9	17%	13	25%	14	27%	7	14%	52
2011	10	19%	9	17%	14	26%	14	26%	7	13%	54
2012	10	17%	10	17%	15	25%	15	25%	9	15%	59
2013	10	17%	10	17%	15	25%	15	25%	9	15%	59
2014	10	16%	10	16%	16	25%	17	27%	10	16%	63
2015	10	16%	10	16%	16	25%	17	27%	10	16%	63

Burimi: BQK (2016)

Sa i përket institucioneve të tjera financiare, në fund të vitit 2015, kanë operuar 13 institucione mikrofinanciare[14], të shpërndara thuajse në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

IMF-të, në fund të vitit 2015, aktivitetin e tyre e ushtruan në 100 degë/nëndegë të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2015 është aprovuar hapja e 4 nëndegëve, 2 mbyllje të nëndegëve, si dhe 12 zhvendosje të degëve dhe nëndegëve të IMF-ve.

Figura 65. Shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe rrjetit të degëve të kompanive të sigurimit



Burimi: BQK (2016)

Tabela 10. Numri i institucioneve mikrofinanciare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve

Viti	Regjioni Prishtinë	Regjioni Prizren	Regjioni Pejë	Gjithsej
2004	6	2	5	13
2005	7	2	5	14
2006	8	2	5	15
2007	8	2	5	15
2008	7	2	5	14
2009	7	2	5	14
2010	7	2	4	13
2011	8	3	4	15
2012	8	2	4	14
2013	8	2	4	14
2014	7	2	4	13
2015	7	2	4	13

Burimi: BQK (2016)

Në fund të vitit 2015 numri i institucioneve financiare jobankare, që operuan në Kosovë arriti në 49, prej të cilave 4 me kapital të huaj e 45 me kapital vendor. Sipas aktiviteteve janë të ndara si në vijim: 2 institucione kryejnë aktivitetin e kredidhënies, 2 institucione aktivitet të lizingut, 1 institucion aktivitet të faktoringut, 6 institucione shërbimin e transferit të parave dhe pagesave[15] si dhe 38 institucione aktivitetin e këmbimit valutor.

Figura 66. Numri i institucioneve mikrofinanciare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve



Burimi: BQK (2016)

[14] Njëri nga institucionet mikrofinanciare ka të pezulluar regjistrimin.

[15] Katër institucione kryejnë aktivitetin e pagesave dhe transferit, 1 institucion kryen vetëm aktivitetin e transferit dhe 1 institucion kryen vetëm aktivitetin e pagesave;

Tabela 11. Numri i institucioneve financiare jobankare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve:

Vitet	Regjioni i Prishtinës	Regjioni i Prizrenit	Regjioni i Pejës	Regjioni i Gjilanit	Regjioni i Mitrovicës	Gjithsej
2004	5	1	0	0	1	7
2005	7	3	0	1	0	11
2006	9	4	3	6	0	22
2007	11	7	6	6	0	30
2008	15	6	5	6	0	32
2009	14	6	6	6	0	32
2010	14	7	7	6	0	34
2011	15	7	10	7	0	39
2012	15	7	11	7	0	40
2013	16	6	12	9	0	43
2014	17	6	12	12	0	47
2015	17	7	12	13	0	49

Burimi: BQK (2016)

Regjistrimi i institucioneve financiare jobankare që kryejnë aktivitetin e këmbimit të valutave vazhdoi edhe gjatë vitit 2015, ndonëse me një ritëm më të ngadaltë të rritjes në krahasim me një vit më parë. Konkretisht, u licencuan 2 institucione të reja për veprimtarinë e këmbimit valutor. Në fund të vitit 2015, në tregun e këmbimeve valutore kryejnë aktivitet 38 zyra të këmbimit valutor të regjistruara.

Figura 67. Numri i institucioneve financiare jobankare si dhe shpërndarja e tyre gjeografike sipas regjioneve



Burimi: BQK (2016)

Për sa i takon shpërndarjes gjeografike të zyrave të këmbimit valutor, ato janë të lokalizuara dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre po thuajse në të gjithë vendin, me përjashtim të regjionit të Mitrovicës. Përqendrimi më i madh i tyre mbetet në regjionin e Gjilanit dhe atë të Pejës.

Figura 68. Numri i zyrave të këmbimit nëpër vite si dhe shtrirja e tyre gjeografike në vitin 2015 sipas regjioneve



Burimi: BQK (2016)



Burimi: BQK (2016)

4.7.1 Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare

Si licencues, rregullues dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjegjësisht mbikëqyrja financiare, ka rolin kyç në mbrojtjen e të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në Kosovë.

Në kuadër të mbikëqyrjes financiare funksionon divizioni i cili bën pranimin, sistemimin dhe shqyrtimin e ankesave për pajtueshmerinë e aktiviteteve të institucioneve financiare me ligjet dhe rregullat në fuqi, si dhe standardet që orientojnë mbikëqyrjen financiare duke përcjell dhe monitoruar sjelljen në treg të tyre. Objektivi i këtij divizioni është vendosja e bazave të mirëfillta për shpalosjen adekuate ndaj konsumatorëve dhe mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve dhe produkteve të institucioneve financiare në Kosovë. Ky divizion shqyrton ankesat e adresuara nga policëmbajtësit, depozitorët / huamarrësit dhe shfrytëzuesit e të gjitha shërbimeve dhe produkteve të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe furnizon mbikëqyrjen dhe rregullativën me rekomandimet konkrete për praktikat e identifikuara, si jo të favorshme për konsumatorët për adresimin e tyre me veprime të ardhshme.

Tabela 12. Numri i ankesave sipas viteve

Industria financiare		Numri i ankesave		
	2015	2014	2013	2012
Bankat komerciale/IMF, IFJB, Fondet pensionale	221	158	74	36
Kompanitë e sigurimeve	221	195	153	70
Total	442	353	227	106

Burimi: BQK (2016)

Aktiviteti i mbikëqyrjes financiare në respekt trajtimi të ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare gjatë vitit 2015 përfshin:

Vazhdimin e implementimit të projektit që është në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e ekspertëve të Bankës Botërore për fushën e mbrojtjes së konsumatorëve të shërbimeve financiare e që për vitin 2015 përfshin:

a) Implementimi i Rregullores për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave - kjo rregullore është aprovuar në vitin 2014 dhe në prill të vitit 2015 ka hyrë në fuqi. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje divizioni ka monitoruar procesin e implementimit të rregullores në koordinim me institucionet financiare.

b) Publikimi i artikullit për mënyrën e parashtrimit të ankesës - në faqen zyrtare tëBQK-së, saktësisht tek pjesa e Edukimit Financiar është publikuar artikulli i cili shpjegon mënyrën e parashtrimit të ankesës për shfrytëzuesit e shërbimeve financiare.

c) Shqyrtimi i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare të pranuara në baza ditore. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar me kohë varësisht nga specifika e tyre. Shqyrtimi i ankesave ka ndikuar që të zhvillohen ekzaminime në kuadër të mbikëqyrjes financiare tek institucionet financiare, të cilat kanë rezultuar në marrjen e masave administrative ndaj institucioneve financiare, si dhe kanë ndikuar në rregullimin e praktikave të ofrimit të shërbimeve/produkteve financiare.

Figura 69. Numri i ankesave ndaj institucioneve financiare



Burimi: BQK (2016)

d) Pjesëmarrja e stafit në aktivitete që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit, si rezultat i marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, pjesëmarrja në tryezën e organizuar nga Kosovo Advocacy and Development Center (KADC), me temën

"Rruga drejt realizimit të të drejtave të konsumatorit" si dhe pjesëmarrja e stafit në diskutimin publik të organizuar nga MTI, "Programi për mbrojtjen e konsumatorit i periudhës 2016 – 2020".

Janë shqyrtuar rreth 442 ankesa të shfrytëzuesëve të shërbimeve financiare (persona fizik e juridik):

a) Totali i ankesave për banka, IMF e IFJB të adresuara në BQK për vitin 2015 ka qenë 221, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë: kategorizimi në regjistrin e kredive (27%) dhe çështje të ndryshme të ndërlidhura me kredi (32%).

b) Totali i ankesave ndaj kompanive të sigurimeve të adresuara në BQK për vitin 2015 ka qenë 221. Ankesat më të shpeshta kanë qenë: moskompensimi me kohë i dëmeve materiale dhe jomateriale nga TPL (46% e gjithsej ankesave), moskompensimi i shpenzimeve mjekësore nga sigurimi shëndetësor (21% e gjithsej ankesave) dhe aplikimi i malusit (17% e gjithsej ankesave).

Tabela 13. Numri i ankesave sipas institucioneve

Institucionet	Numri i ankesave	Pjesëmarrja
Bankat komerciale	191	43%
Kompanitë e sigurimeve	221	50%
Institucionet mikrofinanciare	27	6%
Ndërmjetësuesit e sigurimeve	0	0%
Institucionet financiare jo bankare	3	1%
Agjensionet per transfer parash	0	0%
Këmbimoret	0	0%
Fondet pensionale	0	0%
Totali i ankesave	442	100%

Burimi: BQK (2016)

Nga të dhënat e mësipërme vërejmë se ankesat ndaj kompanive të sigurimeve (50% e total ankesave) janë relativisht në numër pak më të madh krahasuar me bankat komerciale apo institucionet e tjera mikrofinanciare e institucionet financiare jobankare. Vazhdon të ketë ndikim në numrin e ankesave ndaj kompanive të sigurimeve implementimi i Rregullores mbi Implementimin e Sistemit Bonus – Malus sidomos implementimi te personat privatë, të cilët kanë bërë shitblerjen e veturës, por nuk kanë përfunduar procedurat administrative të përcaktuara sipas Ligjit për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë.

Sa i përket ankesave për bankat komerciale, IMF e IFJB vërejmë se në numër më të madh janë ankesat rreth kategorizimit në regjistrin e kredive, pasi që palët vazhdojnë të ankohen direkt në BQK duke mos qenë në dijeni se raportimi në regjistrin kreditor bëhet nga institucionet financiare.

Në tabelën e mëposhtme është i paraqitur edhe numri i ankesave të shqyrtuara nga divizioni i ankesave të shfrytëzuesëve të shërbimeve financiare nëpër vite, nga ku vërejmë rritje të numrit të ankesave ndër vite. Krahasuar me vitin 2014 gjatë vitit 2015 kemi rritje prej 20% të numrit të ankesave të trajtuara.

Në të njëjtën kohë, vazhdon rritja e numrit të ankesave si rezultat i vetëdijesimit të shfrytëzuesve financiarë mbi të drejtën e tyre për ushtrimin e ankesës.

4.8. Mbikëqyrja bankare

Gjatë vitit 2015 është vazhduar me ekzaminimin e bankave, sipas planit vjetor të ekzaminimeve për vitin 2015, duke aplikuar çasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, si dhe duke përcaktuar edhe llojin e ekzaminimit si: ekzaminimet e plota dhe të fokusuara.

Ekzaminimet në vend, si pjesë mjaft e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes së bankave, kanë pasur qëllim vlerësimin nga afër të profilit të rrezikut të bankave, si dhe përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve dhe vendimeve të dala nga ekzaminimet e kaluara.

Gjatë vitit 2015 janë kryer gjithsej 9 ekzaminime të bankave, prej të cilave 5 ekzaminime të plota dhe 4 ekzaminime të fokusuara. Ekzaminimet janë kryer duke adresuar një varg gjetjesh, ku disa prej tyre janë shoqëruar edhe me vendime për masa administrative. E gjithë kjo, në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi në fushën e bankave. Raportet e ekzaminimit janë përgatitur bazuar në llojet e rreziqeve bankare si: rreziku kreditor, rreziku i likuiditeti, rreziku i tregut dhe rreziku operacional. Deri më tani, përjashtuar disa banka që janë të vogla dhe të cilat janë hapur së fundmi, pothuajse të gjitha bankat janë ekzaminuar (ekzaminime të plota) konform Manualit të Mbikëqyrjes së bazuar në Rrezik për Banka.

Gjithashtu, ekzaminimet kanë përfshirë edhe vlerësimin e kontrolleve të brendshme, pajtueshmërinë me kornizën ligjore në fuqi të BQK-së, respektivisht pajtueshmërinë me rregulloret bankare, praktikat më të mira bankare, vlerësimin e kapitalit, vlerësimin e politikave dhe procedurave, menaxhmentin, fitimet si dhe ekzaminimin e fushës së teknologjisë informative. Rreziku kryesor në kuadër të sektorit bankar edhe gjatë vitit 2015, vazhdon të mbetet rreziku kreditor. Gjatë ekzaminimeve është vlerësuar edhe rreziku operacional i bankave, mënyra e menaxhimit, si dhe janë dhenë rekomandimet përkatëse për implementim. Është vërtetuar, se bankat kanë marrë masa për adresim të rekomandimeve të ekzaminimit, me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat rregullative të BQK-së dhe në drejtim të zvogëlimit të rrezikut operacional.

Gjithashtu, gjatë ekzaminimeve në banka është ekzaminuar edhe fusha e teknologjisë informative, duke u fokusuar në vlerësimin e rrezikut të bankës në këtë fushë, sigurinë e përgjithshme të sistemeve të teknologjisë informative, si dhe krijimit dhe plotësimit të masave të sigurisë së sistemeve të teknologjisë informative. Bazuar në vlerësimet e dala nga ekzaminimi, janë dhënë edhe rekomandime përkatëse për implementim, ku është vërtetuar se bankat kanë përmbushur ato.

Nga ekzaminimet, mund të konstatojmë se bankat janë të shëndosha dhe stabile, si dhe përgjithësisht kanë qenë në pajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së.

Përfundimi i ekzaminimeve brenda afateve të caktuara ka qenë kriter strukturor në kuadër të Programit Stand-By me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Bëhet fjalë për ekzaminimet pas hyrjes së Qeverisë së Kosovës në Programin Stand-By me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Deri më tani të gjitha ekzaminimet pjesë e kritereve strukturore janë përfunduar, para afateve të përcaktuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

4.9. Mbikëqyrja e sigurimeve

Në përputhje me objektivat e BQK-së, respektivisht sigurimit të qëndrueshmërisë së tregut të sigurimeve dhe mbrojtjes e policëmbajtësve, BQK-ja edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar aktivitetin e saj duke realizuar në vazhdimësi ekzaminime në vend të siguruesve si ekzaminime të plota dhe të fokusuara, si dhe ekzaminime ad-hoc për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve.

Klasifikimi i siguruesve për të qenë subjekt i ekzaminimeve, është bazuar në disa faktorë duke filluar nga analizat e treguesve financiare nga raportimet e rregullta në BQK, opinionit të pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, ankesave të policëmbajtësve në BQK, si dhe periudhave paraprake të ekzaminimeve të realizuara. Kjo ka ndikuar në aplikimin e qasjes selektive në prioritizimin e institucioneve më me risk për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK-ja dhe si rrjedhojë në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes efektive.

Si rrjedhojë, për vitin 2015 janë realizuar gjithsej 11 ekzaminime ku gjashtë prej tyre kanë qenë ekzaminime të plota, ndërsa katër ekzaminime të fokusuara, përderisa një institucion si rezultat i ekzaminimit në fund të vitit 2014, iu është nënshtruar procesit të këshillimit për një periudhë pesë mujore gjatë vitit 2015.

Qëllimi i ekzaminimeve të plota ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të kompanisë, duke përfshirë vlerësimin e efektshmërisë së funksionimit të kontrolleve të brendshme, zbatimin e rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluara, pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, vlerësimin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së kompanive nga organet drejtuese, praktikat e siguruesve, vlerësimin e politikave dhe procedurave për menaxhimin e rreziqeve, të gjitha këto në funksion të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të siguruesve.

Ekzaminimet në vend të siguruesve në disa raste kanë evidentuar mos pajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së si dhe praktika jo të shëndosha si: mungesë e rolit aktiv qeverisës së bordit drejtues të kompanive, mungesë e sistemit efektiv të kontrolleve të brendshme, nivel i dobët i auditimit të brendshëm, vonesa në trajtimin dhe pagesën e dëmeve si dhe numër të lartë të dëmeve pezull, mos respektim i standardeve të IFRS-së për disa pozicione të pasqyrave financiare, praktika jo të mira dhe të shëndosha të menaxhimit të mjeteve të kompanisë, dobësi dhe praktika jo të mira të transaksioneve me palë të ndërlidhura, nënvlerësim i rezervave teknike, angazhimi në shitjen e produkteve të palicencuara si dhe shitja e produkteve përmes ndërmjetësuesve të pa licencuar. Po ashtu, bazuar në raportimet e rregullta të siguruesve në BQK, janë evidentuar raste të mosrespektimit të kërkesave ligjore në raport me nivelin minimal të kapitalit, solvencës dhe riskut sigurues.

Për të gjitha ekzaminimet janë përgatitur raportet, në të cilat janë ngritur dhe adresuar çështje të evidentuara gjatë ekzaminimit, së bashku me rekomandimet përkatëse. Kompanitë në fjalë kanë raportuar dhe vazhdojnë të raportojnë në baza mujore në BQK për marrjen e veprimeve të nevojshme për eliminimin/përmirësimin e tyre.

Po ashtu, si rezultat i të gjeturave nga ekzaminimet e realizuara dhe performancës jo të mirë financiare, janë lëshuar vendime nga BQK-ja në të cilat janë shqiptuar gjoba dhe masa tjera juridike të parapara me legjislacionin në fuqi si: shtimi i mjeteve për plotësim të kërkesave rregullative për kapitalin minimal të kërkuar, nivelin e solvencës dhe riskut sigurues, gjoba monetare dhe shkarkim të personave zyrtarë të siguruesve.

4.10. Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare

Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare, ka pasur në fokus ngritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të tilla karshi zbatimit të praktikave adekuate të operimit. Në këtë drejtm gjatë vitit 2015 është vazhduar performimi i një mbikëqyrje të bazuar në rrezik të institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare, duke kryer ekzaminime direkte në vend me fokus përshtatshmëria e kapaciteteve menaxhuese ndaj rreziqeve të këtij sektori e veçanërisht rrezikut kreditorë që ka qenë pikë referimi e aktivitetit mbikëqyrës, pajtueshmërinë e këtyre institucioneve me legjislacionin e BQK-së dhe politikat e brendshme institucionale, si dhe vazhdimin e monitorimeve nga jashtë kundrejt këtij sektori.

Bazuar në hapësirën e caktuar të dhënë ndaj ekzaminimit të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare gjatë periudhës së vitit 2015 janë ekzaminuar dhjetë (10) institucione, respektivisht shtatë (7) prej tyre institucione mikrofinanciare dhe tre (3) dhe institutione financiare jobankare. Në ekzaminime përkatëse të realizuar në institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare është evidentuar se me gjithë nevojën e zhvillimit të mëtutjeshëm këto institucione kanë vazhduar avancimin e infrastrukturës së nevojshme në funksion të menaxhimit të tyre si: politikat, procedurat dhe sistemet në identifikimin, njohjen dhe monitorimin e rreziqeve relevante në raport me kompleksitetin e tyre. Megjithatë, në raste të identifikimeve të moszbatimeve serioze të kërkesave ligjore janë ndërmarrë masa administrative dhe korrektuese konform legjislacionit në fuqi. Masat perkatëse kanë rezultuar përgjithësisht të jenë përmirësuese për institucionet në fjalë dhe sektorin mikrofinanciar dhe jobankar në përgjithësi.

Përveç ekzaminimeve të rregullta ky departament ka vazhduar me përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, si dhe vlerësime të metodologjive për provizionet e përgjithshme për humbjet nga kreditë për disa nga këto institucione.

Më tej, është mbajtur prezantim për zyrat e këmbimit valutor për të gjeturat e ekzaminimeve paraprake në mënyrë që të vetëdijesohen tutje dhe të realizojnë funksionim sa më adekuat dhe në pajtueshmeri me kuadrin rregullator në fuqi.

4.11. Mbikëqyrja e pensioneve dhe tregut të letrave me vlerë

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, gjatë vitit 2015 janë zhvilluar ekzaminimet e fondeve pensionale konform planit vjetor. Mbikëqyrja e pensioneve ka qenë konsistent me praktikat ndërkombëtare në fushën përkatëse, duke e mbështetur qasjen e bazuar në rrezik. Vëmendje e theksuar i është kushtuar qeverisjes së fondeve, strategjisë së investimeve, efektivitetit të kontrolleve të brendshme, ruajtjes së likuiditetit adekuat dhe rreziqeve tjera.

Mbikëqyrja e pensioneve edhe gjatë vitit 2015, ka kryer ekzaminime të plota dhe të fokusuara në fondet pensionale, me qëllim të aplikimit të mbikëqyrjes më të përafërt të fondeve. Për më tepër, gjatë vitit të kaluar janë realizuar gjithsej 5 ekzaminime të fondeve pensionale, prej të cilave dy ekzaminime të plota dhe tri ekzaminim i fokusuar.

Ekzaminimet e plota dhe të fokusuara janë realizuar në harmoni me planin vjetor të vitit 2015, duke pasur për qëllim vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të fondeve pensionale, përkatësisht vlerësimin e qeverisjes se fondeve, politikat dhe procedurat, menaxhmentin, përformanca e investimeve, efektshmërinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme si dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së.

Ndërsa, ekzaminimet e fokusuara në fondet pensionale kanë pasur qëllim përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluar të BQK-së.

4.12. Parandalimi i pastrimit të parasë

Divizioni i Parandalimit të Pastrimit të Parasë (PPP) për funksionimin dhe kryerjen e aktiviteteve në përmbushjen e mandatit të tij funksional, gjatë vitit 2015, pikë referuese të ushtrimit të aktivitetit kishte Planin strategjik të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, planin vjetor të mbikëqyrjes financiare, planin vjetor dhe strategjinë dhe planin e veprimit të Divizionit për parandalimin e pastrimit të parave.

Në vitin 2015 është funksionalizuar sistemi i monitorimit të transaksioneve. Qëllimi i realizimit të këtij aktiviteti është rritja e monitorimit të transaksioneve përmes sistemeve informative të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Realizimi i këtij objektivi ka implikuar rritje të

bashkëpunimit me divizione dhe departamente të tjera jashtë funksionit të mbikëqyrjes financiare, si dhe adaptim të sistemeve të teknologjisë informative. DPPP në vitin 2015 është pajisur me qasje në sistemin FIN Inform[16] (SWIFT), ku është bërë i mundshëm deri në një nivel monitorimi i transfereve ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, në periudha të ndryshme kohore.

Në mënyrë aktive, Divizioni ka marrë pjesë edhe në grupin punues ndërinstitucional në lidhje me hartimin e koncept dokumentit për ndryshimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ku projektligji me asistencën edhe të ekspertëve të zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë është në fazën e konsultimeve publike për t'u dërguar në Kuvendin e Kosovës.

4.12.1 Mbikëqyrja e institucioneve financiare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Mbikëqyrja në vend e institucioneve financiare është fokusuar në aspektin e mbrojtjes së sistemeve të tyre, nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Fokusi kryesor i Divizionit brenda kësaj periudhe raportuese ishte që të kryejë ekzaminimin e bankave dhe institucioneve financiare në fushën PPP/FT.

Plani i ekzaminimeve të divizionit për vitin 2015 përmbante gjithsej 15 ekzaminime, me fokus në banka komerciale dhe institucione mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare. Si rezultat i këtij plani, në fushën e parandalimit të pastrimit të parave janë kryer gjithsej 13 ekzaminime, prej tyre 7 në banka komerciale, 3 institucione mikrofinanciare 2 të tjera në institucione financiare jobankare dhe 1 ekzaminim i fokusuar në kompani të sigurimeve. Dokument referues praktik i këtyre ekzaminimeve, ishte manuali i ekzaminimit PP/FT, i hartuar nga divizioni dhe i miratuar nga bordi ekzekutiv në vitin 2014.

Përpos ekzaminimeve të planifikuara dhe të përcaktuara në planin vjetor, DPPP-ja ka kryer edhe ekzaminime të fokusuara, kryesisht si rrjedhojë e situatave të rastit dhe duke u bazuar në rrezik. Në këtë drejtim, divizioni ka kryer 1 (një) ekzaminim të përbashkët me departamentin e mbikëqyrjes bankare dhe 1 (një) me atë të mbikëqyrjes së sigurimeve. Ekzaminimet janë fokusuar në fushat kryesore, të cilat konsiderohen me rrezik më të lartë për përcaktimin e nivelit të pajtueshmërisë me legjislacionin dhe praktikat më të mira ndërkombëtare[17] për mbrojtjen e sistemit financiar nga mundësia e futjes dhe përdorimit të fondeve me origjinë të dyshimtë.

Pika kyçe të vlerësimit gjatë ekzaminimeve të caktuara në institucione financiare, ishin obligimet dhe përgjegjësitë ligjore dhe rregullative të institucioneve financiare, me qëllim të parandalimit të pastrimit të pareve dhe financimit të aktiviteteve terroriste sipas standardeve dhe praktikave më të mira të fushës. Bankat kanë hartuar politika dhe procedura që krijojnë mundësi për masa efektive në PPP/FT. Bankat në pronësi të huaj, këto politika dhe procedura i kanë krijuar edhe me ndihmën e bankave amë, të cilat janë miratuar nga bordi drejtues. Në përgjithësi politikat dhe procedurat janë të qarta, të përshtatshme dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe praktikat dhe udhëzuesit ndërkombëtar për PPP/FT.

Identifikimi i klientit është njëri ndër aspektet kryesore që kërkon trajtim me kujdes dhe i kushtohet rëndësi e veçantë edhe me standarde ndërkombëtare, të cilat kërkojnë zbatimin e masave për luftë efektive kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Divizioni për parandalimin e pastrimit të parave, në kuadër të Bankës Qendrore gjatë ekzaminimeve në vend,

[16] Sistemi elektronik i pagesave ndërkombëtare SWIFT, i cili menaxhohet dhe mirëmbahet nga departamenti i pagesave në kuadër të operacioneve në BQK, ku bankat përmes këtij kodi identifikojnë dhe gjurmojnë shumë më lehtë transaksionet ndërkombëtare.

[17] Standardet ndërkombëtare të Task Forcës për veprim financiar FATF dhe direktivat e Bashkimit Evropian 3 dhe 4 për "mbrojtjen e sistemeve financiare nga mundësia e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit"

ka trajtuar aspektin e identifikimit të klientit dhe përcaktimit të pronarit përfitues, sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira. Nga ekzaminimi në banka, rezulton në përgjithësi se identifikimi i klientëve është në nivel të mirë.

Institucionet financiare të ekzaminuara kanë vazhduar të ndërmarrin masa në drejtim të shtimit të kapaciteteve humane dhe teknike brenda institucionit, duke rekrutuar personel të posaçëm për pajtueshmëri me PPP/FT dhe duke e pavarësuar në masë të konsiderueshme nga funksioni i kontrollit të brendshëm. Masat e ndërmarra dhe aktivitetet, këtë vit divizioni i ka pranuar në mënyrë proaktive nga bankat, në baza të vashdueshme.

Po ashtu, institucionet financiare kanë ndërmarrë masa të konsiderueshme në drejtim të rritjes së efikasitetit të monitorimit, procedurës së identifikimit të klientëve dhe hapjes së llogarive të reja dhe përcaktimit të pronarit përfitues.

5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është kompetente për sigurimin e një furnizimi të duhur të ekonomisë vendore me kartëmonedha dhe monedha euro. Këtë funksion BQK-ja e kryen në mënyre indirekte përmes sektorit bankar i cili është drejtpërdrejt i lidhur me bizneset dhe qytetaret. Përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme gjatë vitit 2015 sikurse edhe në vitet paraprake kishin të bënin me euron si valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë.

Gjatë vitit 2015 BQK-ja siguroj një ofertë kualitative dhe kuantitative të kartëmonedhave dhe monedhave euro për sektorin bankar me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme të ekonomisë dhe qytetarëve. Si rrjedhojë, funksioni për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi është përmbushur në mënyre te suksesshme nga ana e BQK-së.

Figura 70. Furnizimi me para të gatshme (Mera), në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 71. Pranimi i parave të gatshme (Mera), në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2015, shënoi një rënie të lehtë prej 6.19 përqind krahasuar me vitin 2014. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk patën ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti i kaluar. Te kartëmonedhat euro vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet – 10, 20 dhe 50 euro, ndërsa kërkesat për vëllimet e denominimeve prej 5, 100, 200 dhe 500 euro mbeten dukshëm më të ulëta. Gjatë vitit 2015 kërkesat për vëllimet e denominimeve të ulëta ne vlerë prej 50 dhe 5 euro patën rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë kurse kërkesat për vëllimet e denominimeve në vlerë prej 20 dhe 10 euro kishte një rënie të lehtë.

Siç është paraqitur në figurat e mëposhtme, gjatë vitit 2015, BQK-ja e furnizoi sektorin bankar me mbi 9.5 milionë copë kartëmonedha euro (në shumë prej mbi 299.1 milionë euro) dhe mbi 4.5 milion copë monedha euro (në shumë rreth 0.72 milion euro).

Figura 72. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2016)

Figura 73. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2016)

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2015 shënuan një rritje prej mbi 74.6 përqind krahasuar me vitin 2014. Kërkesa për furnizim me monedha euro, në vitin 2015 kryesisht u dominua nga monedhat me vlerë të vogël nga 1 deri në 5 cent. Vëllimet e kërkesave për furnizim me denominime të ulëta në vlerë prej 5 cent, 2 cent dhe 1 cent gjatë vitit 2015 shënuan një rritje grupore prej rreth 35.2 përqind që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë. Vëllimet e kërkesave për furnizim me denominime prej 10 cent e deri tek 2 euro ne krahasim me vitin paraprak shënuan një rritje grupore prej rreth 577 përqind që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë.

Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuara si depozita shënoi një rënie të lehtë prej afër 2.4 përqind në vitin 2015 krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi mbi 14.6 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 58,000 copë kartëmonedha në ditë) dhe 1.5 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 6,000 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga sektori bankar. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 775 milionë kartëmonedha euro dhe 1.2 milionë monedha euro përkatësisht. Struktura e kartëmonedhave euro të pranuara gjatë vitit 2015 siç shihet në grafikun e mëposhtëm nuk pati ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak përderisa struktura e monedhave të pranuara gjatë vitit 2015 gjegjësisht prerjet e monedhave prej 1 euro, 20 cent dhe 10 cent patën një vëllim të shtuar të depozitimit krahasuar me monedhat e tjera të cilat shënuan një rënie të lehtë.

Figura 74. Kartëmonedha euro të pranuara sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2016)

Figura 75. Monedha euro të pranuara sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2016)

Gjatë vitit 2015, paratë e gatshme neto[18] të depozituara ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 477 milionë euro, ndryshimi i tillë

[18] Depozitat minus Tërheqjet.

ishte në një masë më i lartë se sa në vitin e mëhershëm që ishte rreth 476 milionë euro. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i rënies se kërkesës për kartëmonedha euro nga sektorit bankar.

Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, tepricat janë dërguar në eurozonë, ku më pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2015 arritën shumën prej 490.2 milionë euro duke qenë më e lartë se sa një vit më herët kur ishin 473.9 milionë euro. Kjo rritje neto e dërgesave në vitin 2015 erdhi si rrjedhojë e rënies se kërkesës për kartëmonedha euro nga sektori bankar. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim.

Figura 76. Eksporti i parave të gatshme (Mera), në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 77. Importi i parave të gatshme (Mera), në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat standarde të BQK-së. Gjatë vitit 2015 BQK-ja është pajisur me makineri te reja te procesimit te fjalës se fundit te teknologjisë, makineri këto te testuara nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) sa i përket aspektit te konformitetit me rregullat e BQE-së. Të gjitha paratë e gatshme të pranuara nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera u procesuan (afër 14.6 milionë copë kartëmonedha euro dhe 1.5 milionë copë monedha euro) dhe u klasifikuan sipas shkallës së përshtatshmërisë.

Rreth 3.8 milionë copë kartëmonedha euro (25.8 përqind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2015 u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim (tejet të vjetërsuara/dëmtuara) dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të papërshtatshme të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si tejet të vjetërsuara/dëmtuara dhe u hoqën nga qarkullimi ishin ato të denominimeve 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 77 përqind te kartëmonedhave të papërshtatshme të pranuara si rrjedhojë e qarkullimit më të madh të tyre në ekonomi.

Figura 78. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2016)

Figura 79. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuara



Burimi: BQK (2016)

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2015, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 3.6 milionë copë kartëmonedha të reja euro (37.7 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara). Rreth 82 përqind e kartëmonedhave të reja të furnizuara gjatë vitit 2015 ishin kartëmonedha të denominimeve të ulëta (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej, edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të një cilësie standarde të lartë (cilësia adekuate për bankomatë – ATM standard).

Figura 80. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)



Burimi: BQK (2016)

Figura 81. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara



Burimi: BQK (2016)

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, Departamenti i Parave dhe Marrëdhënieve Bankare ka përcjellë rastet e parave të falsifikuara gjatë vitit 2015. Në veçanti, vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false. Departamenti i Parave dhe Marrëdhënieve Bankare së bashku me Laboratorin e Forenzikës publikuan ne ueb[19] faqen e BQK-së statistikat mbi paratë e falsifikuara në nivel të

Figura 82. Parate euro te falsifikuara te konfiskuara ne nivel te Kosoves (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2016)

[19] http://bqk-kos.org/?id=31

Republikës së Kosovës. Më tutje, materiale edukative u publikuan me qellim të informimit të publikut të gjerë mbi tiparet e sigurisë së kartëmonedhave të serisë Europa.

5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Ministrinë e Financave, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe institucione te tjera siç janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së. Në vitin 2015, sikurse edhe viteve të mëparshme, këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe kryerja e pagesave, duke përjashtuar çfarëdo forme të kreditimit.

BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave dhe të Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre. Vlen të veçohet elektronizimi i plotë i kryerjes së urdhërtransferëve ndërkombëtarë të Ministrisë së Financave. Gjatë vitit 2015 të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT duke shkurtuar kështu kohen dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.

Tabela 14. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2011	2012	2013	2014	2015
Transaksionet me para te gatshme	**+535,190**	**+468,755**	**+470,786**	**+475,752**	**+476,310**
Depozita ne para te gatshme	760,082	762,596	737,524	794,989	776,195
Terheqje te parave te gatshme	224,892	293,841	266,738	319,237	299,885
Transferet vendor	**+462,867**	**+335,267**	**+581,797**	**+839,345**	**+942,520**
Transferet vendor ardhes	1,615,232	1,568,574	1,554,535	1,615,753	1,677,024
Transferet vendor dales	1,152,365	1,233,308	972,738	776,408	734,504
Transferet nderkombetar	**-558,778**	**-366,873**	**-321,676**	**-714,099**	**-441,312**
Transferet nderkombetar ardhes	266,706	372,967	653,710	404,473	538,375
Transferet nderkombetar dales	825,483	739,840	975,386	1,118,572	979,687

Burimi: BQK (2016)

Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së u kryen në emër të dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të dhe për llogari të Thesarit – Ministria e Financave.

BQK-ja ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 430 mijë urdhërpagesa shkuarëse vendore (një rritje prej 26% krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 129 mijë urdhërpagesa ardhëse (një rritje prej 10% krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse vendore kapnin shumën prej mbi 734.5 milionë euro (një zvogëlim prej 5.4% krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse vendore kapnin shumën mbi 1.68 miliardë euro (një rritje prej 3.8 përqind krahasuar me vitin paraprak).

Figura 83. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2016)

Figura 84. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Numri dhe shuma më e madhe e transaksioneve vendore u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për Thesarin.

Figura 85. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse, numri



Burimi: BQK (2016)

Figura 86. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse institucionet e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.

Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferët e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore për pesë vitet e fundit mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.

Figura 87. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, numri



Burimi: BQK (2016)

Figura 88. Vlera e transaksioenve ndërkombëtare ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 89. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2016)

Figura 90. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Më 31 dhjetor 2015, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës arritën shumën prej 248.8 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 486.8 milionë euro.

Tabela 15. Niveli i depozitave klientëve kryesor (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2011	2012	2013	2014	2015
Gjithsej gjendja	**1,103,395**	**1,344,440**	**1,480,775**	**1,238,404**	**1,321,025**
Institucionet Qeveritare	194,326	271,692	206,838	155,481	248,780
Agjencia Kosovare e Privatizimit	585,763	549,403	550,328	557,801	486,819
Bankat Komerciale	209,700	302,147	327,843	315,932	316,406
Të tjera	113,607	221,198	395,765	209,190	269,019

Burimi: BQK (2016)

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet ligjore. Ato përbënin 24.3 për qind të depozitave të gjithsejt që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2015. Më 31 dhjetor 2015, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumën prej 320.9 milionë euro.

Figura 91. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Tabela 16. Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive (në mijëra euro)

Llojet e llogarive	2011	2012	2013	2014	2015
I. Llogaritë rrjedhëse	**677,943**	**1,146,445**	**1,266,824**	**1,173,404**	**1,321,025**
Agjencia Kosovare e Privatizimit	265,310	549,403	530,328	557,801	486,819
Institucionet Qeveritare	89,326	73,697	12,888	90,481	248,780
Bankat Komerciale	209,700	302,147	327,843	315,932	316,406
Institucionet Ndërkombëtare (FMN, BB)	73,393	169,341	156,479	155,885	185,466
TKPK + Institucionet Publike (PTK, KEK, etj)	20,953	27,339	209,655	20,845	51,212
FSDK + Të tjera	10,770	19,060	24,349	26,385	27,669
Kompanitë e Sigurimeve	7,693	4,983	4,955	5,738	4,528
Institucionet Ndërkombëtare (EULEX etj)	729	406	260	268	144
Fondet Pensionale Suplementare	68	68	68	68	0
II. Depozitat e afatizuar	**425,453**	**152,000**	**133,000**	**65,000**	**0**
Agjencia Kosovare e Privatizimit	320,453	0	20,000	0	0
Institucionet Qeveritare	105,000	152,000	113,000	65,000	0
Bankat Komerciale	0	0	0	0	0
Institucionet Ndërkombëtare (FMN, BB)	0	0	0	0	0
TKPK + Institucionet Publike (PTK, KEK, etj)	0	0	0	0	0
FSDK + Të tjera	0	0	0	0	0
Kompanitë e Sigurimeve	0	0	0	0	0
Institucionet Ndërkombëtare (EULEX etj)	0	0	0	0	0
Fondet Pensionale Suplementare	0	0	0	0	0
III. Letrat me vlere te qeverise	**0.00**	**45,995.19**	**80,950.60**	**0.00**	**0.00**
Institucionet Qeveritare	0	45,995	80,951	0	0
Gjithsej gjendja	**1,103,395**	**1,344,440**	**1,480,775**	**1,238,404**	**1,321,025**

Burimi: BQK (2016)

5.3. Sistemi i Pagesave

Një prej funksioneve primare të BQK-së është funksionimi i një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave në vend, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare dhe ekonomisë së një vendi.

Gjatë vitit 2015, Sistemi Ndërbankar i Pagesave është karakterizuar me qëndrueshmëri, siguri dhe efikasitet të lartë ndër-operues, duke realizuar kliringun dhe shlyerjet me kohë dhe në

pajtim me standardet dhe procedurat përkatëse. Po ashtu, Regjistri i Llogarive Bankare, ka funksionuar mirë dhe është shënuar rritje në qasjen e përdoruesve, si rrjedhojë e rishikimit dhe harmonizimit te rregullativës së RLLB-së. Ky regjistër është duke i'u nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve me qëllim të automatizimit të proceseve dhe mundësimit të komunikimit elektronik.

Ndër aktivitetet me rëndësi në fushën e sistemeve të pagesave gjatë vitit 2015 ishin: fillimi i implementimit të sistemit të ri të pagesave (ATS/RTGS+ACH).

5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar

Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar si dhe shlyerjen e letrave me vlerë.

Figura 92. Numri i transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2016)

Figura 93. Vlera e transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2016)

Gjatë vitit 2015, në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar janë shtuar edhe dy institucione pjesëmarrëse "Ziraat Bank" dhe "Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës", duke bërë që numri i pjesëmarrësve në sistem të arrijë në numrin 13-të.

Treguesit statistikorë të aktivitetit të SEKN-së kanë reflektuar me një rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve të paraqitur si në vijim:

Janë procesuar rreth 9.8 milionë transaksione me vlerë totale prej afërsisht 7.5 miliardë euro.

Figura 94. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2016)

Figura 95. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN



Burimi: BQK (2016)

Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve është rritur për 8.66 % dhe vlera e transaksioneve është rritur për 9.39 %.

Rritja e vazhdueshme në vëllim dhe vlerë të transaksioneve ndërbankare të SEKN-së pasqyron rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar.

Në kuadër të SEKN-së realizohen disa kategori të pagesave si: pagesat e rregullta (individuale dhe masive), pagesa prioritare (individuale dhe masive), Kos-Giro, Debitimi Direkt si dhe shlyerjet e letrave me vlerë. Niveli i rritjes si për nga vëllimi ashtu edhe vlera e këtyre kategorive të pagesave për vitet 2014 dhe 2015 është paraqitur në figurat si në vijim:

Figura 96. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2016)

Figura 97. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2016)

Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 50.6 % të vëllimit dhe rreth 57.2 % të vlerës së transaksioneve të SEKN-së.

Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Gjatë vitit 2015 numri i pagesave Kos-Giro është rritur për 33.1 %, ndërsa vlera e tyre shënoi rritje prej rreth 10.4 %.

Transaksionet prioritare (urgjente) procesohen dhe shlyhen gjatë orarit të punës në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive, te cilat ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të përgjithshme të SEKN-së. Në vitin 2015 sa i përket vëllimit, ato përfaqësuan më pak se 1%të transaksioneve, ndërsa sa i përket vlerës, ato përfaqësuan mbi 9.5 % të transaksioneve.

Debitimi Direkt si instrument dhe skemë e re e pagesave në Kosovë ende nuk është duke u përdorur në atë masë sa instrumentet tjera të pagesave. Kështu që gjatë vitit 2015, ky lloj i transaksioneve përfaqësonte në total më pak se 1% të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SEKN-së.

Figura 98. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SEKN



Burimi: BQK (2016)

Figura 99. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SEKN



Burimi: BQK (2016)

Pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes sistemit SEKN gjatë vitit 2015 sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë të kliringut, krahasuar me dy sesionet tjera. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave.

Numri dhe vlera e transaksioneve sipas sesioneve:

Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në SEKN ka qenë 7,475,585,326 €, ku tri institucionet e para me vlerë më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 61.16 % të vlerës së përgjithshme, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 38.84 %. Sa i përket numrit të transfereve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre prej 9,837,977, tri institucionet e para me numër më të madh të transfereve të iniciuara zënë 66.19 % të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera zënë 33.81%.

Sa i përket transfereve të pranuara, tri institucionet me vlera më të mëdha të transfereve të pranuara zënë 65.84 % të shumës së përgjithshme, ndërsa gjithë institucionet tjera zënë 34.16 %. Ndërsa nga numri i përgjithshëm i transfereve të pranuara, tri institucionet e para zënë 60.03 % të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjitha institucionet tjera 39.97 %.

Një pasqyrë e detajuar e treguesve të përqendrimit të pjesëmarrjes së institucioneve më aktive në SEKN gjatë vitit 2015, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem, është paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabela 17. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SEKN

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
3 banka	66.19%	61.16%
7 bankat tjera	33.81%	38.84%
Gjithsejt	**9,837,977**	**7,475,585,326**

Burimi: BQK (2016)

5.3.2 Mbikëqyrja, analizat dhe zhvillimet e sistemeve të pagesave

Ligji për Sistemin e Pagesave autorizon BQK-në për mbikëqyrje të sistemit të pagesave, për të siguruar efikasitetin, besueshmërinë si dhe pajtueshmërinë e tij me dispozitat ligjore, ruajtjen e besimit të publikut në sistemin dhe instrumentet e pagesave si dhe promovimin e konkurrencës së lirë në tregun e shërbimeve të pagesave.

Në kuadër të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, është ndërmarrë aktivitet dhe është rritur dhe zhvilluar funksioni përkatës në linjë me parimet dhe standardet ndërkombëtare.

Po ashtu, gjatë këtij viti janë kryer inspektime të rregullta në banka me qëllim monitorimin e procesimit të pagesave sipas procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore.

Kemi bërë publikimin e rregullt të treguesve analitikë për instrumente të pagesave në Kosovë. Ka vazhduar publikimi i analizave të rregullta rreth zhvillimeve të sistemeve të pagesave, si dhe materialeve tjera informative me karakter të edukimit financiar për publikun. Gjatë këtij viti janë publikuar këto analiza:

- Analiza mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë (në baza tremujore);
- Analizimin e zhvillimeve të skemës së pagesave Kos Giro dhe e Debitimit Direkt;
- Analiza për reduktimin e transaksioneve në para të gatshme;

Deri në fund të vitit 2015 kanë përfunduar disa faza të projektit të ATS-së siç janë: studimi fillestar; instalimi i harduerëve; zhvillimi i softuerit dhe dokumentacionit.

Gjithashtu, me qëllim të avancimit të njohurive dhe përgatitjes së pjesëmarrësve për implementim të sistemit të ri të pagesave, në BQK u organizua seminar në bashkëpunim me

SWIFT-in. Tema e këtij seminari ishte "ISO 20022 Standardet për Sistemet e Shlyerjeve Bruto në Kohë Reale (RTGS)".

Duke synuar përafrimin me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e BQE-së në fushën e sistemeve të pagesave, janë rishikuar, përmirësuar dhe përshtatur këto rregullore dhe udhëzime:

a) Rregullore për Sistemin e Numrave Standardë të Llogarive Bankare,

b) Rregullore për Kliringun dhe Funksionimin e Llogarive për Shlyerje dhe

c) Udhëzim për Identifikimin e Urdhërpagesave Ndërkombëtare Dalëse.

5.3.3 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave

Sa i përket instrumenteve të pagesave dhe infrastrukturës bankare të shërbimeve të pagesave, vlen të theksohet se paraqitet një zhvillim i qëndrueshëm, i prirë me rritje dhe zgjerim si në aplikim të teknologjive inovative ashtu edhe në përdorim të instrumenteve elektronike.

Figura 100. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2016)

Figura 101. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit



Burimi: BQK (2016)

Bazuar në metodologjinë për raportimin e instrumenteve të pagesave, bankat komerciale kanë vazhduar raportimin e rregullt të statistikave për instrumente të pagesave në Departamentin e Sistemit të Pagesave në BQK.

Figura 102. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2016)

Figura 103. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2016)

Nga të dhënat e mbledhura, përpunuara dhe të analizuara gjatë vitit 2015 është krijuar një pasqyrë e gjerë mbi nivelin e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave.

Në vazhdimësi, numri i kartelave me funksion pagese është rritur. Rrjeti i terminaleve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje. Në dhjetor të vitit 2015, janë raportuar 837,747 kartela me funksion debiti, 203,845 kartela me funksion krediti. Këto kartela kanë mundur të

përdoren në 540 terminale ATM (bankomat) dhe 9,705 terminale POS (pika të shitjes) të vendosura nëpër Kosovë.

Në krahasim me vitin paraprak, numri i terminaleve ATM është rritur për 8.4% dhe numri i terminaleve POS me 3.8%.

Figura 104. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2016)

Figura 105. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2016)

Viti 2015 u karakterizua me një tendencë në rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Numri i pagesave e-banking u rrit për 46.3%, ndërsa vlera e tyre u rrit për 36.2%.

Numri i pagesave në POS terminale është rritur për 16.5%, ndërsa vlera e tyre është rritur për 27.3%. Po ashtu edhe tërheqjet në ATM terminale u karakterizuan me rritje. Numri i tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2015 është rritur për rreth 5 %, ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 22.7%.

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2015, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve ishte rreth 1.89 milion, që paraqet një rënie prej 1.6 % krahasuar me fundin e vitit 2014. Rreth 98.52 % e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.48 % janë të jorezidentëve.

Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2015, rreth 187.3 mijë llogari kishin qasje "online" nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, duke shënuar një rritje prej 18.7% në krahasim me vitin 2014.

Tabela 18. Numri i llogarive

Përshkrimi I llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2013	2014	2015	2013	2014	2015
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,855,383	1,917,513	1,886,644	131,365	157,761	187,297
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.62%	98.37%	98.52%	97.10%	97.22%	97.64%
a-Individuale (%)	93.25%	93.18%	93.21%	80.11%	79.66%	79.43%
b-Kompani (%)	6.75%	6.82%	6.79%	19.89%	20.34%	20.57%
2-Llogari të jo-rezidentëve (c+d) (%)	1.38%	1.63%	1.48%	2.90%	2.78%	2.36%
c-Individuale (%)	96.35%	96.60%	96.84%	92.50%	91.99%	91,27%
d-Kompani (%)	3.95%	3.40%	3.16%	7.50%	8.01%	8.73%

Burimi: BQK (2016), Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave"

Bazuar në të dhënat statistikore zhvillimi i infrastrukturës ka një ritëm më të shpejt krahasuar me vendet e regjionit. Inkurajues mbetet trendi i shpejt i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Sa i përket krahasimit të Kosovës me vendet në rajon, shihet se trendi i shpejtë i zhvillimit gjatë viteve të fundit ka ndikuar, që sot Kosova të ketë përmirësuar pozitën e saj krahasuar me vendet fqinje.

Tabela 19. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave[20]

Përshkrimi	Banorë	ATM për milion banorë	POS për milion banorë	Kredit Kartelat për milion banorë	Debit Kartelat për milion banorë	E-Banking për milion banorë
Kosova	1.82	274	5,137	66,842	372,577	86,681
Shqipëria	2.89	281	2,276	29,351	268,926	50,246
Republika Çeke	10.51	423	9,618	150,795	894,314	-
Turqia	76.67	594	31,163	743,523	1,376,202	-
Sllovenia	2.06	821	15,962	56,465	1,158,719	-
Bullgaria	7.24	776	10,532	129,549	868,282	-
Hungaria	9.88	494	10,617	140,928	756,474	
Bosnja	3.83	372	6,004	-	-	55,760
Mali i Zi	0.62	560	20,619	78,813	573,292	101,598
Kroacia	4.25	993	23,415	50,100	1,588,397	-
Maqedonia	2.06	466	18,945	154,344	597,812	273,203

Burimi: BQK (2016) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

5.3.4. Reduktimi i pagesave me para te gatshme

Pavarësisht se në Kosovë forma kryesore për kryerjen e pagesave ende mbetet paraja e gatshme, viteve të fundit vërehet një rritje e shpejt e përdorimit të instrumenteve elektronike për pagesa.

Nga të dhënat statistikore për vitin 2015, vërehet rritje në numër dhe vlerë të kredit transfereve, të cilat paraqesin një alternativë për pagesa pa para të gatshme. Me rritje të dukshme të përdorimit janë karakterizuar edhe pagesat përmes instrumenteve elektronike siç janë: transaksionet përmes debit kartelave, kredit kartelave dhe e-banking duke ndikuar në zvogëlim të pagesave në para të gatshme.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në kryerjen e transaksioneve me kartela, BQK-ja ka paraparë implementimin e një sistemi ndërbankar të pagesave me kartelë për të ofruar funksionalitet ndër operimi mes lëshuesve të kartelave.

Gjatë këtij viti është nënshkruar marrëveshja për asistencë nga programi Qeveria-për-Qeverinë (programi G2G) si partneritet nga USAID për zhvillimin e kapaciteteve lokale në studimin e fizibilitetit për krijimin e sistemit ndërbankar për transaksione me POS dhe ATM.

5.4. Menaxhimi i Mjeteve

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është përgjegjëse për plasmanin e mjeteve financiare nën menaxhim si dhe për operimin e sistemit depozitar dhe platformës elektronike për tregtimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në veçanti, detyra e menaxhimit të rezervave ndërkombëtare është e specifikuar në kuadër të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

5.4.1. Menaxhimi i Investimeve

Sipas Politikës së Investimeve të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së, objektivat kryesore të përcaktuara gjatë menaxhimit të mjeteve janë: siguria, likuiditeti dhe kthimi në investime.
Përgjatë vitit 2015, të gjitha mjetet janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta, likuide dhe me vlerësim kreditor superior.

Kategoritë e instrumenteve financiare në të cilat janë investuar mjetet janë:

- depozitat e afatizuara bankare me afat maturimi deri në një vit, përkatësisht euro-depozita bankare të afatizuara me banka komerciale dhe qendrore të shteteve më kredibile të Eurozonës;

[20] Të dhënat në tabelë janë nga viti 2014 pasi që shumica e vendeve në rajon të dhënat për vitin 2015 nuk i kanë publikuar ende

- bono të thesarit të shteteve të Eurozonës me afat maturimi deri në një vit;
- obligacione shtetërore të shteteve të Eurozonës me afat maturimi deri në tre vite dhe;
- obligacionet shtetërore të Republikës së Kosovës të tregtuara në tregun sekondar të letrave me vlerë me afat maturimi deri në tri vite.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka mbajtur një shpërndarje adekuate të portfolios në raport me gjendjen në tregun e Eurozonës duke e ndihmuar gjithashtu aktivitetin e tregtimit me instrumente financiare në tregun e brendshëm të vendit. Situata e rënduar në tregjet financiare e sidomos në tregun Evropian ka bërë që strategjia e investimit të fokusohet në investimin e mjeteve me afat më të gjatë si dhe në stimulimin e tregut të brendshëm dukë blerë instrumente të borxhit në tregun sekondar të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, përkundër normave jo të favorshme në tregjet financiare, kemi realizuar kthime pozitive të interesit duke i respektuar objektivat primare të Politikës për Investime.

Figura 106. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së



Burimi: BQK (2016)

Figura 107. Saldoja përfundimtare e mjeteve të investuara nga ana e BQK-së sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse.



Burimi: BQK(2016)

Figura 108. Shpërndajrja e portfolios investuese në çdo fundë vit



Burimi: BQK(2016)

Shpërndarja e portfolios së BQK-së në kategoritë kryesore të instrumenteve financiare e paraqitur në figurën 106 tregon një përqendrim më të lartë të investimeve në depozita bankare si instrumente me kthim më të lartë të investimit. Gjatë tërë vitit depozitat bankare në mesatare mbesin me koncentrim mbi 60 përqind në totalin e portfolios. Për shkak të plasmanëve në afate më të gjata, horizonti kohor i vendosjes së mjeteve është balancuar me mbajtje të një niveli më të lartë të likuiditetit në llogari rrjedhëse. Rrjedhimisht mbajtja e parave të gatshme gjatë tërë vitit në mesatare kalon 20 përqind të totalit të portfolios.

Letrat me Vlerë të emetuara nga Shtetet e Eurozonës përbëjnë instrumentin me pjesëmarrje më të vogël në totalin e portfolios për shkak të kushteve të pafavorshme të kthimit nga investimet për instrumentet e borxhit sovran. Investimi në Letra me Vlerë të emetuara na Qeveria e Republikës së Kosovës ka

ndihmuar në mbajtjen e një niveli adekuat të investimeve me pjesëmarrje prej 11 përqind të totalit të portfolios.

Niveli i mjeteve totale në portfolio i pasqyruar në figurën 107 tregon një ngritje relativisht të vogël të mjeteve përgjatë pesë viteve të fundit. Në krahasim me vitin paraprak kemi një ngritje të shumës totale si rezultat i tërheqjes së mjeteve nga jashtë në tregun e brendshëm të kontribuesve të portfolios së BQK-së si bankat komerciale dhe fondet pensionale.

Figura 109. Norma e kthimit në depozita të investuara nga BQK dhe norma EURIBOR 1-mujor



Burimi: QK(2016)

Pjesëmarrja më e lartë në depozita bankare shihet në figurën 108 ku pasqyrohet portfolio investuese sipas kategorive të instrumenteve financiare për vitin 2015 krahasuar me vitet paraprake.

5.4.1.2. Performanca e portfolios për vitin 2015

Viti 2015 njihet si vit turbulent i tregjeve financiare dhe karakterizohet me vazhdimësi të krizës së borxheve në Eurozonë. Sikurse në vitin 2014 ashtu edhe në vitin 2015 Banka Qendrore Evropiane vazhdoi me zvogëlimin e normave të interesit, me ç'rast në dhjetor 2015 uli normën e depozitave në nivel rekord historik prej (-0.30%). Shumica e bankave komerciale në Eurozonë ndjekën praktikën e BQE-së duke aplikuar norma negative për mjetet likuide. Kështu gjatë vitit 2015 u krijuan vështirësi në mbajtjen e likuiditetit me bankat komerciale.

Figura 110. Norma e kthimit të investimeve në portolio dhe rreziku për dy periudhat gjashtëmujore të vitit 2015



Burimi: BQK(2016)

Figura 111. Horizonti kohor mesatar i shprehur në ditë deri në maturim për dy kategoritë e plasmaneve



Burimi: BQK(2016)

Figura 109 paraqet lëvizjen e kthimeve nga investimet në portfolion e BQK-së në raport me tregun ndër-bankar të Eurozonës, respektivisht norma EURIBOR 1-mujor (Norma Mesatare e Huadhënies ndër-bankare për valutën Euro) e cila konsiderohet normë referuese për depozitat e afatizuara të BQK-së në bankat qendrore dhe bankat komerciale të shteteve të Eurozonës. Pika referuese përcaktohet kundrejt të dhënave nga horizonti kohor mesatar i portfolios investuese. Nga figura 109 shohim që përkundër normave historikisht të ulëta të tregut ndërbankar, BQK ka përformuar më mirë se norma mesatare e EURIBOR duke realizuar kthime pozitive nga mjetet e investuara.

Figura 110 paraqet kthimin më të favorshëm të realizuar në investimet në depozita bankare në raport me letrat me vlerë. Kriza e borxheve në Eurozonë ka bërë që letrat me vlerë qeveritare të jenë më pak të favorshme për investim në raport me depozitat bankare.

Struktura e horizontit kohor po ashtu ndryshon për depozitat bankare në krahasim me letrat me vlerë ashtu siç paraqitet në figurën 111.

5.4.2.Menaxhimi i Rrezikut

Investimi i mjeteve bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet më kredibile të Eurozonës dhe në institucionet bankare me vlerësim kreditor superior sipas vlerësimeve nga Agjencitë Kreditore Ndërkombëtare: Standard&Poor's dhe Moody's.

Rreziqet financiare me të cilat ballafaqohemi (menaxhohen) gjatë investimit të mjeteve financiare nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku likuiditetit dhe rreziku operacional.

Rreziku kreditor - Portfolio e investimeve është shpërndarë në mënyrë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P), dhe në rastet e jashtëzakonshme në treg si në rastin e normave negative të interesit me P-3/A-3.

Rreziku i normës së interesit - është matur duke krahasuar normën e kthimit nga investimet në portfolion e BQK-së me normën EURIBOR 1 mujor (Norma mesatare e huadhënies ndër-bankare për valutën Euro) si normë krahasuese.

Rreziku i likuiditetit - investimet janë bërë në përputhje me horizontin kohor të përcaktuar me Politiken e Investimeve. Instrumentet në të cilat është investuar janë kryesisht instrumente me afat të shkurtër si depozita bankare, bono thesari dhe obligacione shtetërore.

Rreziku operacional - ky rrezik ekziston në të gjitha aktivitetet dhe për të minimizuar rrezikun operacional, investimet janë realizuar me saktësi duke ju nënshtruar kontrollit efikas për çdo transaksion.

Figura 112. Struktura e Letrave me Vlerë sipas afateve të maturimit



Burimi: BQK (2016)

Figura 113. Struktura e pjesmarrësve në ankande



Burimi: BQK (2016)

5.4.3 Letrat me Vlerë të Qeverisë

Në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike BQK vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave (MeF).
Sipas Kalendarit të Emetimeve të Letrave me Vlerë të Qeverisë, në vitin 2015 janë mbajtur 21 ankande përmes platformës elektronike: 4 ankande për bono thesari me afat maturimi 91 ditë, 4 ankande për bono thesari me afat maturimi 182 ditë, 6 ankande për bono thesari me afat

maturimi 364 ditë, 4 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi dy vjet, 2 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi tre vjet (njëri prej tyre i rihapur) dhe 1 ankand për obligacion qeveritar me afat maturimi 5 vjet. Në figurën 112 paraqitet struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë e shprehur në përqindje sipas afatit të maturimit.

Figura 114. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2014 dhe 2015, në përqindje



Burimi: BQK(2016)

Figura 113 paraqet strukturën e institucioneve pjesëmarrëse në ankandet e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.[21]

Për herë të parë në vitin 2015 u emetuan obligacionet qeveritare me afat maturimi prej tre dhe pesë vjet.

Figura 115. Ankandet e bonove të thesarit dhe obligacioneve qeveritare në vitin 2015



Burimi: BQK (2016)

Krahasuar me vitin paraprak, norma mesatare vjetore e kthimit për bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë ka shënuar rritje prej 12.50 %, për bonot e thesarit me afat maturimi 182 ditë është shënuar rritje prej 22.39 %, për bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë është shënuar rënie prej 8.72 %, siç prezantohet në figurën 114. Norma mesatare vjetore e kthimit për të gjitha bonot e thesarit në vitin 2015 ka qenë më e lartë për 2.32% krahasuar me vitin 2014. Norma mesatare e kthimit për obligacionet qeveritare me afat maturimi 2 vjet në vitin 2015 ka shënuar rritje prej 1.09 %. Norma mesatare e kthimit për obligacionet qeveritare 3 vjeçare për vitin 2015 ishte 3.09%, ndërsa për obligacionet qeveritare 5 vjeçare ishte 4.94%.

Në figurën 115 janë paraqitur të gjitha ankandet ku shihet se kërkesa më e lartë ishte për bono thesari njëvjeçare dhe për obligacione qeveritare dy dhe tre vjeçare.

Aktivitetet në tregun sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë vazhduar me intensitet më të shtuar. Është shënuar një progres i dukshëm dhe rritje e interesimit për blerjen e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.

[21] Pjesëmarrës në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë kanë qenë të gjithë Akterët Primar,Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës si pjesëmarrës primar, kompanitë e sigurimeve dhe pjesëmarrësit tjerë përmes Akterëve Primar.

5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës

Anëtarë në sistemin e Regjistrit të Kredive të Kosovës (RKK) janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga Banka Qendrore për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikro-financiare të licencuara si dhe ato institucione financiare jo-bankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.

Gjatë vitit 2015, RKK ka regjistruar 183 përdorues duke u bazuar në kërkesat e paraqitura nga institucionet kredidhënëse.

Figura 116. Numri i përdoruesve të regjistruar



Burimi: BQK (2016)

Aktualisht në RKK janë të regjistruar 1309 përdorues aktiv të institucioneve kredidhënëse. Në vazhdim përmes figurës numër 116 është paraqitur numri i përdoruesve të regjistruar në sistemin e RKK-së për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Institucionet kredi dhënëse qasen në sistemin e RKK-së me qëllim të hulumtimit mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor, ku sipas statistikave që dalin nga sistemi i RKK-së, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2015 kap shifrën prej 602,642 hulumtime.

Figura 117. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2016)

Një pasqyrë mbi këtë aktivitet në baza vjetore është paraqitur në vijim në figurën 117.

Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në Regjistrin e Kredive të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre, në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga Banka Qendrore, këto informata duhet të jenë të sakta, të plota dhe me kohë.

Figura 118. Numri i kredive të reja



Burimi: BQK (2016)

Institucionet kredidhënëse duhet të përfshijnë një klauzolë pëlqimi në formularët e tyre të aplikimit për kredi dhe në kontratat e tyre të kredive, si dhe të marrin nënshkrimin me shkrim ose elektronik të klientëve, i cili autorizon dorëzimin e informacionit të kredive të tyre tek Regjistri i Kredive.

Gjatë vitit 2015, nga ana e institucioneve kredidhënëse, në sistemin e regjistrit të kredive janë raportuar 173,796 kredi të reja.

Kreditë e raportuara nga institucionet anëtare në sistemin e RKK-së, klasifikohen në bazë të Rregullores për Menaxhimin e Riskut Kreditor.

Gjithashtu institucionet kredidhënëse bazuar në Udhëzimin për Regjistrin e Kredive duhet të përditësojnë statusin e çdo kredie aktive në baza mujore sipas gjendjes së ditës së fundit kalendarikë të çdo muaji.

Në figurën 118 dhe 119 janë paraqitur ekspozimet kreditore në bazë të klasifikimeve të raportuara në sistemin e RKK-së për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Subjekt i të dhënave në sistemin e RKK-së paraqitet çdo person fizik apo juridik që ndërmerr një obligim kredie. Me obligim kredie nënkuptohet çdo hua, kredit kartelë, garancion, lizing ose produkt tjetër me natyrë kreditore.

Subjektet e të dhënave përpos rolit si kredimarrës mund të paraqiten edhe në role tjera sikur bashkëkredimarrës, garantues, apo edhe si aksionar dhe drejtor të entitetit juridik të cilit i lëshohet obligimi kreditor.

Figura 119. Numri i i kërkesave për raporte kreditore



Burimi: BQK (2016)

Subjektet e të dhënave bazuar në Rregulloren e Regjistrit të Kredive si dhe në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me qëllim të kontrollimit të informacioneve vetanake kanë të drejtën të paisjen me raportin e tyre individual kreditor. Kjo mundësohet nga secila bankë apo edhe drejtpërdrejtë në Bankën Qendrore të Kosovës.

Figura në vazhdim paraqet numrin e kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarresve (fizik/juridik).

Si në vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2015, Regjistri i Kredive ka kontribuar drejtpërdrejt në të dhënat e mbledhura nga Banka Botërore për qëllim të raportit Doing Bussines 2016.

Sipas raportit të publikuar nga Banka Botërore, fusha që i përket Regjistrit të Kredive "getting credit" për vitin 2015 krahasuar me vendet e rajonit është vlerësuar në pozitën e 28-të.

Me këtë vlerësim indikatori "getting credit" përsëri vlerësohet si më pozitiv nga të gjithë indikatorët tjerë të raportit Doing Bussines 2016 për Republikën e Kosovës.

5.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Në funksion të realizimit të objektivave të saj, BQK-ja ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë analizave rreth zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në vend si dhe analizave që kanë të bëjnë me vlerësimin e stabilitetit financiar dhe me aktivitetin e sistemit financiar të vendit. Pjesa më e madhe e këtyre analizave publikohet në baza periodike në kuadër të publikimeve të BQK-së, duke shërbyer kështu si një burim i rëndësishëm informimi për autoritetet politikëbërëse, sektorin e biznesit (përfshirë edhe vetë industrinë financiare), si dhe publikun e gjerë.

Një ndër publikimet më të rëndësishme periodike është Raporti i Stabilitetit Financiar, i cili që nga viti 2014 ka filluar të publikohet dy herë brenda vitit. Raporti i Stabilitetit Financiar pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar duke analizuar zhvillimet e përgjithshme

ekonomike së bashku me zhvillimet në aktivitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e të gjithë komponentëve të sistemit financiar të vendit.

Krahas Raportit të Stabilitetit Financiar, në baza periodike publikohet edhe Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike, raport ky që paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse rreth zhvillimeve makroekonomike në vend. Raporti i zhvillimeve makroekonomike, si pjesë qendrore ka edhe projeksionet makroekonomike, duke pasuruar kështu analizën për zhvillimet makroekonomike në vend dhe duke ofruar një pasqyrë mbi zhvillimet e pritura në ekonominë e vendit. Për t'i siguruar publikut çasje sa më të shpejtë në informacionet rreth zhvillimeve në ekonominë e vendit, BQK-ja ka vazhduar të publikojë në baza të rregullta Vlerësimin Tremujor të Ekonomisë. Për më tepër, BQK-ja vazhdon të publikojë edhe Raportin e Informatave Mujore të Sistemit Financiar, i cili paraqet një përmbledhje të indikatorëve kyç për të gjithë komponentët e sistemit financiar të Kosovës dhe publikohet çdo muaj.

BQK-ja ka vazhduar të realizojë Anketën e Kreditimit Bankar me bankat komerciale, duke mbledhur kështu informacion të rëndësishëm për faktorët me ndikim në aktivitetin kredidhënës të bankave në Kosovë si dhe për pritjet për aktivitetin kredidhënës në periudhën e ardhëshme. Informacionet nga kjo anketë, e cila realizohet dy herë në vit, përveç që kanë ndihmuar për të kuptuar më mirë zhvillimet në sektorin bankar, shërbejnë edhe si input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe të agregatëve tjerë makroekonomik. Për më tepër, gjatë vitit 2015, është bërë harmonizimi i Anketës së Kreditimit Bankar me Anketën e ngjashme të Bankës Investuese Evropiane (BIE), që mundëson krahasimin e rezultateve të kësaj ankete për Kosovën me rezultatet e anketave të ngjashme për vendet e tjera.

Në vitin 2015, është arritur për herë të parë të publikohet Raporti i Mbingarkueshmërisë me Borxh, i cili bazohet në të dhënat e regjistrit të kredive si dhe në të dhëna shtesë të kërkuara nga bankat. Ky raport pasqyron në hollësi faktorët me ndikim në cilësinë e kredive si dhe vlerëson nivelin e ngarkueshmërisë me borxh të klientëve kreditor. Ky raport mund të shërbejë si burim i rëndësishëm informacioni për BQK-në në procesin e vlerësimit të stabilitetit financiar dhe po ashtu mund t'i shërbejë edhe bankave në procesin e hartimit të politikave të tyre.

Gjatë vitit 2015, në shërbim të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik të institucioneve bankare, janë përpiluar analiza të posaçme që pasqyrojnë zhvillimet makroekonomike dhe ato të lidhura me stabilitetin financiar, si dhe rreziqet e mundshme makroekonomike me të cilat mund të ballafaqohet stabiliteti financiar në vend. Gjatë këtij viti, po ashtu është rritur frekuenca e përpilimit të analizave të brendshme mbi sistemin financiar, posaqërisht analizave të sektorit bankar, si analiza mbi rreziqet bankare, ecurinë e kredive joperformuese. Në të njëjtën periudhë, është bërë avancimi i metodologjisë për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike, si dhe është punuar në avancimin e metodologjisë për përpilimin e modelit stres-test. Progres i rëndësishëm është shënuar edhe drejtë formulimit të politikës makroprudenciale dhe në finalizimin e rregullores për Mbështetje Emergjente me Likuiditet.

5.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë 2015

Gjatë vitit 2015, është bërë progres i madh në funksionin statistikor të BQK-së duke avancuar harmonizim e mëtejmë të statistikave sipas *acquis* dhe filluar për herë të parë raportimin në Eurostat; zgjeruar gamën me statistika të reja; rritur mbulueshmërinë; diseminuar statistikat në Eurostat, Bankë Botërore dhe FMN. Sistemi statistikor është avancuar edhe me zhvillimin e një softueri të ri për grumbulimin dhe procesimin e të dhënave. Gjatë 2015, BQK ka dërguar për herë të parë të dhënat për publikim në Eurostat për bilancin e pagesave dhe statistikat e shërbimeve ndërkombëtare.

Konvergjenca dhe harmonizimi i plotë i statistikave të sektorit të jashtëm sipas metodologjisë që përdorin vendet e BE-së (*acquis*) është avancuar dhe përafruar shumë. Gjatë 2015 BQK ka filluar për herë të parë raportimin në Eurostat të statistikave të bilancit të pagesave. Këto statistika kanë një përputhshmëri të gjerë me ato që raportojnë vendevet e BE-së. Në Eurostat janë dërguar të *dhënat vjetore* për bilancin e pagesave të Kosovës për dhjetë vitet e fundit. Gjithashtu në Eurostat është filluar raportimi i *statistikave të tregëtisë së jashtme në shërbime*, me të dhënat për vitin 2014. Paraprakisht, BQK ka definuar dhe stukturuar të dhënat në formatet e nevojshme, si dhe ka instaluar pakon softwerike të quajtur Statistical Data Metadata eXchange (SDMX), e cila është e nevojshme për të bërë konvertimin e të dhënave në SDMX format përmes platformës eDAMIS. Gjatë vitit 2016 do të dërgohen më shumë statistika dhe do fillohet me raportim të rregullt vjetore, tremujore e mujore në Eurostat për statistikat e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare, statistikat e tregtisë ndërkombëtare në shërbime dhe statistikat e investimeve direkte

Për më shumë, në kuadër të bashkëpunimit me Eurostatin, BQK ka hartuar draft-metodologjinë për përpilimin e SSJ dhe draft-metodologjinë për statistikat e tregëtisë ndërkombëtare në shërbime. Drafti për SSJ është në proces të finalizimit dhe deri ka fundi i muajit qershor pritet të publikohet në faqen e interentit. Ndërsa drafti i metodologjisë për statistikat në shërbime me jashtë është hartuar në format të njejtë me atë të vendeve të BE-së dhe është dërguar në Eurostat për komente. Të dy këto materiale do të publikohet në faqen e BQK-së.

Në përpjekje për të përmirësuar kualitetin e statistikave, BQK ka zgjeruar listën e mbulueshmërisë duke futur në raportim korporatat jofinanciare të reja dhe ka përmirësuar statistikat e shërbimeve me jashtë. Kompani të reja janë futur në raportim, kryesisht korporata me pronësi të huaj, ku të dhënat e tyre janë të nevojshme për përpilimin e statistikave të investimeve të huaja direkte në Kosovë dhe borxhit të jashtëm. Departamenti i statistikës gjatë vitit 2015 ka fituar një grant në kuadër të "Programit shumë-përfitues për bashkëpunim statistikor, IPA 2012" nga Komisioni Evropianë në vlerë prej 10.000 euro për ngritjen e kualitetit të statistikave në shërbime me jashtë dhe harmonizimin e statistikave të sektorit të jashtëm me kërkesat e Eurostatit. Objektivi për përmirësimin e kualitetit për tregëtinë në shërbime është arritur. Kjo është vlerësuar edhe nga eksperti i GOPA-s që implementon projektet IPA 2012.

Gjithashtu, është bërë përmirësim i theksuar i periodicitetit dhe shkurtim i kohës së publikimit. Gjatë 2015 është filluar për herë të parë të publikohen në bazë mujore të dhënat për bilancin e pagesave. Njëherit është bërë përmirësim i kohës së publikimit nga 90 ditë në 60 ditë pas përfundimit të periudhës referuese.

Me rritjen e kërkesës për informata të reja, BQK ka zgjeruar gamën e produkteve statistikore duke prodhuar më shumë informata për normat e interesit, investimet e huaja direkte, bilancin tregtar dhe për statistikat e borxhit të jashtëm. Janë përgatitur dhe publikuar tabela të reja për normat e interesit në kredi dhe depozita të bankave komerciale, si dhe për vlerat e kredive të lejuara e depozitave të pranuara në baza mujore. Tabelat e reja të publikuara ofrojnë informata të detajizuara, për normat e interesit për kredi dhe depozita të klasifikuara sipas sektorëve institucionalë (ndërmarrje dhe ekonomi familjare), sektorëve ekonomikë (bujqësi, prodhim, shërbime dhe sektorë të tjerë), qëllimit të huazimit (kredi investive ose për konsum), afatit, etj. Këto statistika janë në përputhshmëri të plotë me standardet statistikore ndërkombëtare.

BQK ka zhvilluar një softuer të ri statistikor për pranimin e informatave statistikore nga institucionet financiare dhe procesimin e të dhënave. Qëllimi i implementimit të këtij softuteri është unifikimi i raporteve të pranuara nga institucionet financiare, avancimi i mënyrës së grumbullimit të raporteve, si dhe përpunimi më efikas i të dhënave të pranuara. Meqenëse softueri do të përdoret nga më shumë departamente brenda BQK-së, kjo do rritë efikasitetin për të kontrolluar të dhënat për konsistencë për sektorin financiar.

Të dhëna në baza periodike janë dërguar në FMN për qëllime publikimi. Në kuadër të bashkëpunimit me Eurostatin dhe Bankën Qendrore Europiane (BQE), BQK ka marrë pjesë në takimet e rregullta në *Komitetin për Statistikat Monetare, Financiare dhe Statistikat e Bilancit të Pagesave* të organizuara nga Eurostati dhe BQE. Për më tepër, BQK ka bashkëpunuar edhe me bankat qendrore të vendeve të rajonit, organizatat tjera ndërkombëtare dhe institucione të tjera relevante në fushën e statistikave. BQK është anëtare e Këshillit Statistikor të Kosovësdhe është koordinatore e vendit për Sistemin e Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (angl. General Data Dissemination System - GDDS) të FMN-së. Të dhënat për indikatorët kryesor të Kosovës janë publikuar sipas afateve të parapara (mujore, tremujore, dhe vjetore) në kuadër të faqes së BQK-së.

5.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare

Nga Janari i vitit 2015 deri në dhjetor të këtij viti, janë paraqitur gjithsejtë dhjetë (10) kërkesa për rishqyrtim nga ana e institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK.

Konform kompetencave ligjore, është rishqyrtuar secila kërkesë dhe pas analizës së tyre ka përgatitur rekomandimet përkatëse për Bordin Ekzekutiv të BQK-së për secilin rast.

6. Zhvillimet e Brendshme

6.1. Auditimi i Brendshëm

Funksioni i Auditimit të Brendshëm në Bankën Qendrore të Republikës se Kosovës është i rregulluar dhe funksionon në përputhje me Ligjin e BQK-së nr.03/L-209 (nenet 60 dhe 61) dhe Statutin e Auditimit të Brendshëm, i aprovuar nga Bordi i BQK-së.

Fushëveprimi kryesor i Auditimit të Brendshëm gjatë këtij viti ka qenë i fokusuar në fushat e natyrës: Financiare, atyre të Pajtueshmërisë, ato Operacionale dhe Teknologjisë Informative.

Përgjatë vitit 2015, Zyra e Shefit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së ka kryer auditime të rregullta sipas Planit Vjetor 2015, të aprovuar nga Bordi i BQK-së, si dhe ka vazhduar me aktivitete të tjera të ndërlidhura me funksionin e auditimit. Fokusi i AB-së është orientuar sa më shumë që ishte e mundur në çështjet kyçe që nevojiten të adresohen dhe që do të jenë në funksion të ndihmës për Mënaxhmentin.

Auditimi i Brendshëm gjatë kësaj periudhe, përveç angazhimeve të auditimit sipas Planit, gjithashtu ka zhvilluar aktivitete të cilat kishin për objektivë rritjen e cilësisë se punës audituese dhe ndikojnë ne efikasitetin dhe efektivitetin e AB-së.

Gjatë vitit 2015, funksioni i auditimit të brendshëm i është nënshtruar edhe dy vlerësimeve të jashtme, një nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe tjetri nga USAID-i. Opinionet dhe Rekomandimet e tyre, përfshirë edhe ato të Bankës Botërore dhe Bankës Qendrore Evropiane të kryera në vitin 2014 janë duke i shërbyer AB-së si udhërrëfyes i vlefshëm në përmirësimin dhe avancimin e të gjitha proceseve të këtij funksioni. Brenda një kohe të shkurtër, janë zbatuar një numër rekomandimesh të rëndësishme të vlerësimeve të jashtme, ndër të cilat dy më kyçe: rishikimi dhe përditësimi i Manualit të punës se AB-së dhe adoptimi i Metodologjisë për vlerësimin e rrezikut.

Manuali ekzistues i AB-së, është përditësuar sipas praktikave më të mira, Kornizës së Standardeve Ndërkombëtare Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe modelit të Bankës Qendrore Evropiane. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut është bazuar përgjithësisht në metodologjinë e përdorur nga Banka Qendrore Evropiane dhe nga Banka të tjera Qendrore. Përmes kësaj metodologjie janë vlerësuar për çdo funksion/proces apo aktivitet të BQK-së, rreziqet e mundshme, si dhe mjaftueshmëria dhe adekuatshmëria e kontrolleve të brendshme.

Bazuar në këtë Metodologji është përgatitur Plani vjetor i Auditimit të Brendshëm i cili është miratuar nga Bordi i BQK-së. Planit Vjetor të Auditimit i ka paraprirë përgatitja e Universit të Auditimit për periudhën trevjeçare 2016-2018. Universi paraqet përfshirjen e të gjitha aktiviteteve të auditimit, Departamentet/Divizionet dhe fushat që auditohen brenda periudhës trevjeçare. Në Plan janë përfshirë proceset të cilat mund të ekspozojnë rrezikshmëri dhe prioritet më të lartë, në veçanti që ndërlidhen me ruajtjen e pasurisë dhe reputacionit të BQK-së.

Në përputhje me Ligjin e BQK-së dhe Statutin e Auditimit të Brendshëm, Shefi i AB-së, gjatë këtij viti ka raportuar në periudha të rregullta tremujore dhe vjetore në Komitet të Auditimit dhe Bord të BQK-së lidhur me të gjeturat e auditorit, rekomandimet si dhe veprimet e ndërmarra për adresimin e tyre. Raportet janë diskutuar paraprakisht në Komitetin e Auditimit dhe Bordin e BQK-së dhe më pas çështjet për trajtim të mëtutjeshëm janë adresuar te Menaxhmenti ekzekutiv. Përmes tyre AB, njëkohësisht ka raportuar në lidhje më përcjellën dhe nivelin e zbatimit te rekomandimeve të dhëna në periudhat paraprake.

Në kuadër të Planit vjetor për vitin 2015 përveç auditimeve tjera, në bazë të kërkesës nga marrëveshja midis Qeverisë se Kosovës, BQK-së dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, në baza tremujore janë kryer katër auditime të pavarura të rekonsilimit të llogarive të Qeverisë. Raportet e kryera janë dërguar më kohë në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Në shtator të vitit 2015, është filluar projekti për asistencë teknike për funksionin e AB-së nga ana e Bankës Sllovene. Marrëveshja është nënshkruar nga ana e Guvernatorëve të te dyja Bankave, BQK-së dhe Bankës Sllovene. Aktualisht, janë realizuar një numër aktivitetesh të rëndësishme të përcaktuara me Planin e veprimit.

AB, ka qenë e fokusuar në përmbushjen e objektivave strategjike të BQK-së. Është përditësuar raporti i zbatimit të Planit Strategjik 2015-2019 për funksionin e AB-së.

Për të avancuar njohuritë për Qeverisje dhe Menaxhim te rrezikut dhe për të projektuar angazhimet në nivel më të lartë, AB ka zhvilluar konsultimet me Menaxhment në një stad më të hershëm të proceseve të vlerësimit të rrezikut dhe të planifikimit.

Është vazhduar avancimi i sistemit të dokumentimit të punës se auditimit, i përcjellë me Pako të letrave të punës që janë kërkesë kryesore e standardeve dhe praktikave profesionale të auditimit. Një auditor i ri i çertifikuar në fushën e auditimit është rekrutuar gjatë kësaj periudhe. Një plan trevjeçar i çertifikimit për një pjesë të stafit është aprovuar nga Guvernatori, ndërsa Stafi i AB-së edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar përmbushjen e standardit për zhvillim të vazhdueshëm profesional, përmes pjesëmarrjes në disa ngjarje të rëndësishme të kësaj fushe.

6.2. Burimet njerëzore

Në fund të vitit 2015, numri i të punësuarve në BQK ka qenë 215 të punësuar. Nga gjithsej numri i të punësuarave, 49.3 % janë femra dhe 50.7% janë meshkuj.

Figura 120. Struktura sipas edukimit



Burimi: BQK (2016)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vlerëson personelin si një nder resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'u sigurojë njohuri të duhura, aftësi dhe ekspertizë adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive sipas standardeve më të larta për arritjen e potencialit të plotë të tyre përmes kurseve, seminareve, edukimeve etj.

Gjatë vitit 2015, 42% e të punësuarve, kanë marrë pjesë në trajnime profesionale kryesisht të organizuara nga FMN në Joint Vienna Institute, CEF, Bundesbank, Bankën e Holandës, Bankën Qendrore të Polonisë etj.

Gjithashtu BQK-ja u ka ofruar mundësi studentëve nga universitetet/institucionet e arsimit të lartë si nga vendi ashtu edhe nga jashtë vendit mbajtjen e praktikës në mënyrë që t'u sigurojë atyre mundësi unike për të fituar përvojë praktike në fusha të ndryshme të funksioneve dhe operacioneve të BQK-së. Në vitin 2015 gjithsej 45 studentë ndoqën programin e praktikës në BQK.

6.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së

Në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me ligj, BQK-ja gjatë vitit 2015 ka zhvilluar aktivitetin ligjor në drejtim të implementimit dhe avancimit të infrastrukturës ligjore, me qëllim të avancimit dhe harmonizimit të rregullativës nga lëmi i sektorit financiar në përputhje me parimet themelore të direktivave të Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare.

Duke u fokusuar në avancimin e infrastrukturës ligjore në hap me zhvillimet më të reja të tregut financiar, me qëllim të përmbushjes së objektivave dhe detyrave të përcaktuara me ligj, organet vendimmarrëse të BQK-së kanë miratuar një numër të akteve nënligjore të cilat paraprakisht janë shqyrtuar dhe konfirmuar nga aspekti ligjor para miratimit të tyre.

Arritje e dukshme gjatë këtij viti është shënuar edhe në drejtim të avancimit të kornizës ligjore të sigurimeve. Ligji Nr. 05/L-045 për Sigurimet është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në fund të vitit 2015. Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat themelore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve, risiguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe subjekteve tjera të parapara me këtë ligj, në mënyrë që industria e sigurimeve në Republikën e Kosovës të operojë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe transparente, në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të policëmbajtësve.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në vazhdimësi do të fokusohet në mbarëvajtjen e një kornize rregullative në harmoni me legjislacionin në fuqi, legjislacionin e BE-së, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, me qëllim të vazhdimit të funksionimit të sigurt dhe efektiv të sektorit financiar në Kosovë.

6.4. Teknologjia Informative

Gjatë vitit 2015, për të gjithë shfrytëzuesit e sistemeve të informacionit, BQK ka implementuar projektin e autentikimit të dyfishtë që paraqet një ngritje në aspektin e sigurisë në përdorim të sistemeve. BQK ka filluar edhe me krijimin e një ekipi të zhvilluesve të sistemeve, të cilët do të ndihmojnë në krijimin e aplikacioneve të reja brenda BQK-së, pasi që kërkesat e shfrytëzuesve dhe sektorit financiar janë në rritje.

Poashtu, eshte implementuar softueri për raportim financiar për departamentet e mbikëqyrjes financiare dhe të statistikës. Qëllimi i këtij softueri është që të bëjë integrimin e informatave të institucioneve financiare në një platformë të vetme, të mundëson raportim më të saktë, më të sigurtë, dhe më efikas.

6.5. Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut

Kompletimi i kuadrit rregullues dhe zhvillimi i modeleve të njohjes, matjes dhe monitorimit të rreziqeve, ishin ndër aktivitetet më domethënëse të Funksionit të Menaxhimit të Rrezikut.

Në pajtim me fushëveprimin dhe parimet e përcaktuara me Politikën për Menaxhimin e Rreziqeve, gjatë periudhës raportuese është përpiluar Rregulla për Menaxhimimin e Rrezikut Operacional.

Fushëveprimi i kësaj Rregulle është menaxhimi i Rrezikut Operacional nga sistemet dhe proceset e brendshme, personeli dhe nga ngjarjet e jashtme. Menaxhimi i Rrezikut Operacional realizohet brenda standardeve të përcaktuar të procesit të njohjes së humbjeve potenciale, për të zbehur efektet nga ngjarjet e pafavorshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave strategjike të BQK-së.

Kuadri aktual rregullues mishëron standardet dhe praktikat më të mira në fushën e menaxhimit të rrezikut në institucione financiare. Korniza rregulluese është dizajnuar të integrohet në të gjitha proceset dhe sistemet e brendshme.

7. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

7.1. Marrëdhëniet ndërkombëtare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) konform përgjegjësive të saj ka vazhduar me kultivimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin funksional me institucionet kryesore financiare ndërkombëtare: Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankën Botërore (BB). Po ashtu ka pasur komunikime dhe bashkëveprime të veçanta me Bankën Qendrore Evropiane, institucionet homologe të rajonit dhe me institucione të tjera me të cilat ekzistojnë marrëveshje bilaterale.

Në vitin 2015, BQK-ja vazhdoi të ketë bashkëpunim me FMN-në me programe bilaterale për asistencë teknike. Edhe me Banken Botërore (BB), BQK-ja pati komunikim dhe bashkëpunim të duhur gjatë tërë vitit. BQK-ja dhe institucionet e Kosovës ishin nikoqirë të vizites në Kosovë të z. Min Zhu, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i FMN-së, më të cilin u takuan Guvernatori dhe zyrtarët e tjerë të lartë të BQK-së. Gjatë vitit 2015, Guvernatori ka përfaqësuar Kosovën në takimet vjetore të Sesionit Pranveror të FMN-së dhe BB-së në Uashington si dhe të Sesionit Vjeshtor në Lima të Perusë.

Sa i përket aktiviteteve dhe ngjarjeve më të rëndësishme të zhvilluara gjatë vitit 2015 , mund të përmendim këtu përfundimin e Programit të bashkëpunimit teknik të BQE-së me bankat qendrore të Ballkanit Perëndimor i cili kishte filluar një vit më parë. Ky program pati për qëllim ofrimin e bashkëpunimit teknik të ndërsjellë dhe përgatitjen e bankave qendrore të vendeve të regjionit për inkuadrim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Konkretisht, me anë të këtij programi u bë identifikimi i nevojave zhvillimore të bankave qendrore të regjionit në veprimtari të veçanta në funksion të përcaktimit të ndryshimeve në kuadër të përgatitjeve për t'iu bashkuar SEBQ-së atëherë kur vendet e regjionit të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian. Në ceremoninë përmbyllëse të programit, ku BQK-ja ishte nikoqir dhe bashkëorganizator me BQE-në, morën pjesë përfaqësues të lartë të BQE-së, BE-së, bankave qendrore të regjionit dhe të bankave qendrore të vendeve të BE-së të përfshira si partnere në program.

Gjatë këtij viti, BQK-ja e ka zhvilluar më tej bashkëpunimin me banka qendrore dhe autoritete mbikëqyrëse me të cilat ka marrëdhënie bilaterale. Ka pasur këmbime informacioni dhe përvojash brenda kornizave përkatëse. Po ashtu janë realizuar vizita pune në këto banka qendrore dhe autoritete mbikëqyrëse. Guvernatori ka marrë pjesë në Konferencën me temën: "A i ndryshojnë krizat themelet ekonomike në vendet e Evropës Juglindore?", e organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve të Evropës Juglindore të Universitetit të Oksfordit të mbajtur në Tiranë. Po ashtu Guvernatori Hamza mori pjesë në samitin "E ardhmja financiare e rajonit", që u mbajt në Beçiq të Malit të Zi. Temat boshte të këtij samiti ishin sfidat aktuale, e ardhmja financiare e rajonit dhe mundësitë për rritje ekonomike. Guvernatori mori pjesë edhe në Konferencën e 6-të të Bankës Qendrore Evropiane mbi vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, e cila ka zhvilluar punimet në Frankfurt të Gjermanisë. Temat kyçe të kësaj konference ndërlidhen me politikat monetare të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, eksperiencat e fituara dhe sfidat aktuale, politikat strukturore në mbështetje të përmbushjes së kritereve të konvergjencës dhe politikat mbikëqyrëse pas funksionalizimit të unionit bankar.

Gjatë vitit 2015 është vazhduar me mbajtjen e takimeve të rregullta të Iniciativës së Vjenës 2.0. Forumi i plotë është mbajtur në Varshavë ku u diskutuan çështje në fushën e mikro dhe makro stabilitetit.

Draft-marrëveshjet në mes të bankave qendrore/autoriteteve mbikëqyrëse të Ballkanit Perëndimor në njërën anë me Autoritetin Bankar Evropian (EBA) janë nënshkruar gjatë tetorit 2015. BQK-ja është në proces të vlerësimit nga EBA lidhur me ekuivalencën e kritereve të

konfidencialitetit si një parakusht nëpër të cilin kanë kaluar edhe vendet e tjera, që tashmë kanë të nënshkruar këtë marrëveshje. Parashihet që marrëveshja në mes të BQK-së dhe EBA-së të nënshkruhet gjatë vitit 2016.

7.2. Aktivitetet e Edukimit Financiar

Gjatë vitit 2015 janë zhvilluar aktivitete për qëllim të ngritjes së njohurive financiare tek fëmijët dhe të rinjtë. Vlenë të përmendet zhvillimi i këndit të edukimit financiar në kuadër të faqes së internetit të BQK-së. Në Këndin e Edukimit Financiar janë përfshirë artikuj, broshura, dhe publikime të ndryshme mbi BQK-në, veprimtaritë e saj si dhe sistemin financiar të vendit.

Gjatë muajit mars ashtu si në gjithë botën edhe në Kosovë u shënua ngjarja e emërtuar si Java Ndërkombëtare e Parasë. Aktivitete edukative u zhvilluan në disa institucione arsimore anembanë Kosovës. Në këto aktivitete, morën pjesë Guvernatori dhe zyrtarët e tjerë të lartë të BQK-së.

Guvernatori, zëvendësguvernatorët dhe personeli menaxherial i BQK-së gjatë vitit kanë marrë pjesë aktive në aktivitete të sferës së edukimit në kuadër të organizimeve dhe institucioneve të ndryshme. Përveç ligjërimeve dhe bashkëbisedimeve me studentët në auditoriumet e institucioneve të arsimit të lartë, përfaqësuesit e BQK-së kanë marrë pjesë edhe në punëtori me gazetarët e ekonomisë, zyrtarët e bankave komerciale dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

BQK-ja ka mundësuar vizita të shumta të studentëve dhe nxënësve si dhe ka vazhduar të jetë e hapur për t'u ofruar ndihmë lidhur me punimet e tyre studimore në fushat e ekonomisë dhe financave. Edhe në vitin 2015 BQK-ja ka ndarë Çmimin për ekonomistët e rinj. Ky Çmim ka për qëllim nxitjen e hulumtimeve dhe punimeve nga studentët apo të diplomuarit e rinj lidhur me zhvillimin ekonomik dhe sistemin financiar.

7.3. Asistenca teknike

BQK-ja ka vazhduar te përfitoj nga asistenca teknike gjatë vitit 2015, e ofruar nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatoret e ndryshëm si me projektet ekzistuese, po ashtu edhe me iniciativa te reja. Kryesisht mbështetja është ofruar nga Thesari Amerikan, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, USAID, Fondi Zhvillimor Gjerman dhe Banka Qendrore Evropiane.

Këto institucione kanë përkrahur ngritjen e kapaciteteve të BQK-së në këto aspekte; në mbikëqyrjen e institucioneve financiare, avancimin e kornizës ligjore për mbikëqyrje te bazuar ne rrezik, institucionalizim te praktikave ndërkombëtare dhe ngritjen e kapaciteteve njerezore për implementim të duhur të kornizës ligjore.

Gjatë vitit 2015 ka vazhduar implementimi i projektit *Fuqizimi i sektorit financiare dhe infrastrukturës se tregut,* financuar nga kredia e Agjencisë Ndërkombëtarë për Zhvillim (IDA). Ky projekt fokus te veçantë ka: (i) financimin e kostos qe ndërlidhet me Implementimin e strategjisë së BQK-së, Zhvillimin e Sistemit të Pagesave në kohë reale, (ii) Ndërtimi i Qendrës se Vazhdimësinë e Biznesit për BQK-ne si dhe (iii) Sigurimin e financimit të kapitalit fillestar për Fondin për Sigurim të Depozitave të Kosovës (DIFK) me qëllim te grumbullimit te rezervës ne formë të kapitalit fillestar. Thesari Amerikan ka vazhduar te përkrah Bankën Qendrore me ekspertizë këshillimore në avancimin e Kornizës për Qeverisje Korporative, përgatitjen e Kornizës Operacionale për institucionalizimin e funksionit të Makroprudencës, dhe fusha tjera te politikave zhvillimore. BQK-ja gjatë vitit 2015 ka bere progres te konsideruar ne implementimin e Mbikëqyrjes Bankare të bazuar në rrezik, dhe operacionalizimin kornizës Operacionale të Mbështetjes për Likuiditet Emergjent, me asistencën e ofruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Fondi Zhvillimor Gjerman (GIZ) ka përkrahur BQK-ne në avancimin e dhe

implementim të kornizës ligjore ne pajtueshmëri me kërkesat e Bazelit dhe me praktikat ndërkombëtare.

Gjithashtu, gjate vitit 2015 vlen te përmendet edhe programi njëvjeçar i bashkëpunimit teknik të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) i dizajnuar per BQK-në, Bankën e Shqipërisë dhe Bankën Populllore të Republikës së Maqedonisë, në partneritet me bankat qendrore kombëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Ky projekt ka rezultuar me rekomandime konkrete për funksionee të veçanta të bankave qendrore të regjionit dhe përputhjen me parimet dhe praktikat bashkëkohore, duke u fokusuar në avancimin e kompatibilitetit me funksionet e tilla të bankave qendrore të vendeve anëtare të BE-së.

Gjithashtu, BQK-ja ka vazhduar avancimin e praktikave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe edukimin financiar si element thelbësor për ndërtimin dhe ruajtjen e një sektori financiar efiçient, konkurrues dhe të drejtë. Prandaj, me qellim te avancimit te këtij funksioni BQK-ja me përkrahjen e Fondit Evropian për Evropën Juglindore (angl. Europan Fund for Southestern Europe – EFSE) ka avancuar edhe me tutje edukimin financiare. Projektet e lartcekura do të kontribuojnë në thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit efektiv dhe efikas ndërinstitucional.

BQK-ja mbetët e përkushtuar dhe mirënjohëse për tere përkrahjen e cila i ofrohet nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatoret e ndryshëm, dhe avancimet e bëra gjate kësaj periudhe janë reflektues i vërtetë te shfrytëzimit adekuatë te kësaj përkrahje.

8. Pasqyrat financiare të BQK-së

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Përmbajtja Faqe

Raporti i Auditorit të Pavarur	3
Pasqyra e gjendjes financiare	4
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	5
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	6
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	7
Shënime për pasqyrat financiare	8 - 41

Deloitte Kosova sh.p.k.
St. Ali Hadri, n.n.
10000 Prishtinë
Kosova

Tel: +381 38 760 300
Fax: +381 38 760 350
www.deloitte.com

RAPORTI I PAVARUR I AUDITORIT

Për Menaxhmentin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës ("BQK"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2015, pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar në atë datë, dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shpalosje të tjera informuese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrolle të brendshme të tilla që menaxhmenti i konsideron si të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, të cilat nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë nga gabimet apo mashtrimet.

Përgjegjësia e Auditorit
Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim për këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Auditimi përshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi audituese lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e selektuara varen nga gjykimi profesional i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për gabime materiale në pasqyra financiare, qoftë nga mashtrimet apo gabimet. Në vlerësimin e këtyre rreziqeve, auditori konsideron kontrollet e brendshme relevante në përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të dizajnoj procedurat e auditimit të cilat janë të përshtatshme, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi për efektivitetin e kontrolleve të brendshme. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin dhe adekuatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit të cilat i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura, prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2015, performancën financiare dhe rrjedhjen e parasë për vitin e përfunduar në atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Kosova sh.p.k.

Prishtinë, Kosovë
19 maj 2016

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e gjendjes financiare
Më 31 dhjetor të vitit 2015

Në mijë Euro	**Shënim**	**2015**	**2014**
Aktivet			
Paraja e gatshme	7	15,282	29,178
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	241,187	323,401
Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione Qeveritare)	9	127,319	120,789
Depozita me bankat e huaja	10	805,309	660,123
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	268,277	234,786
Prona dhe pajisjet	12	2,372	1,956
Aktive të paprekshme	13	1,552	1,251
Aktive tjera	14	897	886
Gjithsej aktivet		**1,462,195**	**1,372,370**
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vend	15	316,406	315,932
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	273,894	238,713
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	735,744	713,567
Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	82,649	50,608
Detyrime nga huamarrja/et	19	680	34
Detyrime të tjera vendore	20	1,799	3,181
Gjithsej detyrimet		**1,411,172**	**1,322,035**
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	21	30,000	30,000
Fondi i rezervave	21a	20,171	19,561
Rezerva nga rivlerësimi		164	389
Neto rezultati (fitimet e mbajtura)		688	385
Gjithsej kapitali dhe rezervat		**51,023**	**50,335**
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		**1,462,195**	**1,372,370**

Këto pasqyra financiare të shpalosura në faqet 4 deri në 41 janë miratuar nga menaxhmenti i BQK-së më 19 Maj 2016 dhe është nënshkruar në emër të tij nga:

Bedri Hamza
Guvernator

Faton Ahmetaj
Drejtor për Planifikim dhe Raportim Financiar

Shënimet nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Në mijë Euro	**Shënim**	**2015**	**2014**
Të ardhurat nga interesi			
Të ardhurat nga interesi		642	1,504
Shpenzimet nga interesi		(48)	(246)
Të ardhurat neto nga interesi	22	594	1,258
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat			
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat		1,442	1,640
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(376)	(318)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe ndalesat	23	1,066	1,322
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ dhe të hyrat tjera operative			
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ	24	3,410	3,310
Të ardhurat nga grantet	25	77	77
Të ardhurat tjera operative	26	1,139	18
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit	29	(298)	(225)
Të hyrat operative		**5,988**	**5,760**
Shpenzimet administrative (operative)			
Shpenzimet personelit	27	(3,625)	(3,571)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(561)	(485)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	28	(1,114)	(1,319)
Shpenzimet administrative (operative)		**(5,300)**	**(5,375)**
Fitimi vjetor		**688**	**385**
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-	
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		**688**	**385**

Shënimet nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Në mijë Euro	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura (Neto Rezulatati/et)	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2015	**30,000**	**19,561**	**389**	**385**	**50,335**
Transferimi në fondin rezervë	-	610	(225)	(385)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	**-**	**610**	**(225)**	**(385)**	**-**
Fitimi për vitin	-	-	-	688	688
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**-**	**688**	**688**
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**30,000**	**20,171**	**164**	**688**	**51,023**
Gjendja më 1 janar 2014	**30,000**	**19,462**	**301**	**187**	**49,950**
Transferimi në fondin rezervë	-	99	88	(187)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	**-**	**99**	**88**	**(187)**	**-**
Fitimi per vitin	-	-	-	385	**385**
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**-**	**385**	**385**
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**30,000**	**19,561**	**389**	**385**	**50,335**

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Në mijë Euro	**Shënim**	**2015**	**2014**
Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi vjetor		688	385
Rregullime për:			
Zhvlerësimin	12	359	279
Amortizimin	13	202	206
Të ardhurat nga grantet	25	(77)	(77)
Fitimi nga shitja e pajisjeve		-	(18)
Të ardhurat nga interesi	22	(642)	(1,504)
Shpenzimet nga interesi	22	48	246
		578	**(483)**
Ndryshime në bono thesari		(3,493)	250,048
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		(554,965)	(74,139)
Ndryshime në mjetet e ndërlidhura me FMN		(33,449)	(3,348)
Ndryshime në aktive të tjera		(11)	91
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave komerciale në vend		474	(17,242)
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të të ndërlidhura me FMN-në		35,138	4,720
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		22,193	(43,876)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale		32,041	(185,989)
Ndryshime në huamarrja/et		647	34
Ndryshime në detyrimet e tjera vendore		(1,547)	3
Interesa të marra		197	1,597
Interesa të paguara		(21)	(263)
Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operacionale		**(502,218)**	**(68,847)**
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Të hyrat nga shitja e pajisjeve		-	18
Blerja e pajisjeve	12	(775)	(351)
Blerja e aktiveve të paprekshme	13	(503)	(123)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		**(1,278)**	**(456)**
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Të hyrat nga grantet		243	10
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		**243**	10
Rritja/(zbritja) neto në para dhe ekuivalentet e saj		**(503,253)**	**(69,293)**
Efekti i normë së këmbimit		**-**	**-**
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		**762,586**	**831,879**
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	30	**259,333**	**762,586**

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për "Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të cilit tash e tutje i referohemi si ("Ligji për BQK-në"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë dhe të mbajë një sistem të qëndrueshëm financiar, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndetshëm dhe efikas të pagesave.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK vepron nga zyrat e saj që gjenden në Prishtinë. Adresa e regjistruar e zyrës së BQK-së është si më poshtë:

Rr. Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 79, paragrafit 2 të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga Guvernatori, Drejtori Gjeneral i Thesarit[1] dhe tre anëtar jo-ekzekutiv dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2015, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Bedri Peci – Kryetar i Bordit
- Bedri Hamza – Guvernator
- Behxhet Brajshori – Anëtar
- Nuhi Ahmeti – Anëtar

Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe tre Zëvendësguvernatorët dhe është përgjegjës për implementimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj.

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuara nga SNRF-ja për secilin lloj të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë shpalosur më në detaje në politikat kontabël në shënimin 3 më poshtë.

[1] Pasi qe është përmbush kushti i pikes 2, të nenit 79, Drejtori Gjeneral i Thesarit nga muaji gusht 2015 nuk është më anëtar i Bordit te BQK-së.

2. Baza e përgatitjes (në vazhdim)

c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro ("EUR"), e cila është valuta funksionale e BQK-së. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Euro është rrumbullakësuar në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informatat në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe vendimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të konsiderueshëm në shumat e pranuara në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë në shënimin 5.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

3. Politikat e rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj vlerësohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga valutat e huaja për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhë funksionale në kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar ajo vlerë e drejtë. Diferencat nga valutat e huaja që rrjedhin nga rivlerësimi njihen si fitim ose humbje.

b) Interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen si fitim apo humbje bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbret pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet në njohjen fillestare të aktivit ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe vlerat e paguara apo kostot e transaksioneve të pranuara dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen, emetimin apo largimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje apo fitim përfshijnë interesat nga aktivet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

c) Tarifa dhe komisione

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një mjet apo detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të hyrat tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, tarifat e transferimit të fondeve dhe të licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

d) Përfitimet e punonjësve

BQK kryen kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet pensionale të punonjësve kur ata dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve të kontributit të përcaktuara, bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së ngarkohen si shpenzim në të ardhura në momentin kur ato ndodhin.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si BQK-ja alokon fitimin e saj.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare

Banka klasifikon investimet e saja në këto kategori: Aktivet financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe detyrimet, aktivet financiare të mbajtura deri në maturim dhe pasuri financiare të gatshme për tregtim. Ky klasifikim varet nga qëllimi për të cilin investimet janë siguruar. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të tij sipas njohjes fillestare dhe e rivlerëson këtë gjatë çdo date të raportimit.

Aktivet financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes

Kjo kategori ka dy nënkategori: aktivet financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të përcaktuara sipas vlerës fillestare reale të fitimit apo humbjes. Një pasuri financiare klasifikohet në "aktivet financiare më vlerë reale sipas kategorisë së fitimit apo humbjes së pësuar nëse parimisht sigurohet më qëllim të shitjes afatshkurtër, nëse formon një pjesë të portofolit të aktiveve financiare në të cilat ka dëshmi të përfitimit afatshkurtër, apo nëse përcaktohet kështu nga menaxhmenti.

Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë mjete financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe që nuk kuotizohen në një treg aktiv përveç atyre që Banka ka për qëllim t'i shesë në afat të shkurtër apo që i ka përcaktuar në vlerën reale sipas fitimit apo humbjes apo vënë në dispozicion për shitje. Fillimisht kreditë dhe të arkëtueshmet njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi. Dispozitat për dëmin e kredive dhe të arkëtueshmeve përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrueshme sipas kushteve fillestare. Banka nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

Mjetet financiare të mbajtura deri në maturim

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe me maturitet fiks përveç atyre që plotësojnë përkufizimin e kreditorëve dhe detyrimeve që menaxhmenti i Bankës ka qëllim dhe mundësi pozitive që të mbaj deri në maturitetit. Fillimisht aktivet njihen në vlerë reale dhe më pas maten në vlerën e amortizuar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi. Provizioni për dëmin e shumave të mbajtura në maturim përcaktohet kur ka prova objektive se Banka nuk do të jetë në gjendje që të arkëtojë të gjitha shumat e detyrimeve sipas kushteve fillestare.

Mjetet financiare të gatshme për tregtim

Mjetet financiare të gatshme për tregtim janë pasuri financiare jo-derivative të cilat ose përcaktohen në këtë kategori ose klasifikohen në ndonjërën nga kategoritë tjera. Banka nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

i. Njohja

BQK-ja fillimisht njeh depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha mjetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivi financiar apo detyrimi financiare fillimisht matet me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për zë jo me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Mjetet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

ii. Çregjistrimi

BQK-ja çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë që vijnë nga aseti financiar mbarojnë, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e kontraktuara të parasë mbi aktivin financiar në një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet nga pronësia e asetit financiar. Çdo interes në aktivin financiar të transferuar i cili është krijuar apo mbajtur nga BQK-ja njihet si një pasuri apo detyrim i ndarë. Në çregjistrimin e një mjeti (aseti) financiar, ndryshimi në mes të vlerës bartëse të tij (ose vlerës kontabël të ndarë në pjesën e tij të transferuar), dhe shumën e (i) vlerës së marrë (duke përfshirë çdo aset të ri që ka marrë minus çdo detyrimi të ri të supozuar) dhe (ii) çdo fitim apo humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera të përmbledhura, njihet si fitim ose humbje.

BQK-ja çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë anuluar, ndërprerë apo shuar.

iii. Netimi

Mjetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një mjeti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën mjeti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

v. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejt (reale) është çmimi që do të merret për të shitur një aktive apo që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë e një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuara në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuara janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht dhe rregullisht në treg në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të midis palëve të mirë informuara dhe ne formë te vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e zbritjes së rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i merrnin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranuara ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare. Të dhënat për teknikat vlerësuese paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të riskut që ekzistojnë në instrumentin financiar. BQK-ja kalibron teknikat vlerësuese dhe i teston ato për vlefshmërinë duke shfrytëzuar çmimet nga transaksionet aktuale të dallueshme të tregut në të njëjtin instrument apo në bazë të të dhënave tjera të dallueshme dhe të disponueshme në treg.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Mjetet dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

vi. Identifikimi dhe matja e dëmtimit

Në çdo datë raportimi, BQK vlerëson nëse ka evidencë objektive që mjetet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e tregut përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Mjetet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që mjetet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja përndryshe nuk do t'i kishte konsideruar, që janë indikator se një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për letrat me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesave të një huamarrësi ose emetuesi në BQK, ose kushte ekonomike që lidhen me mospagesën në kohë në BQK.

Humbja ne vlerë (zhvlerësimi) i aktiveve financiare të kryer me koston e amortizuar llogaritet si diferenca mes vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të vlerësuara të parave që skontohen me normën origjinale të interesit efektiv të aktivit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara, nëse janë të zbatueshme, vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje vijuese shkakton zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet të ardhurave ose humbjeve.

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat gatshme, depozita me bankat dhe aktive financiare me rrjedhje të madhe me maturitet origjinal për më pak se tre muaj, të cilat janë objekt i një Risku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiar me kosto të amortizuar.

h) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë, që janë Bonot e Thesarit, maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera të drejtpërdrejta të transaksionit, dhe në vijim trajtohen si investime që mbahen deri në maturim.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë mjete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks, të cilat BQK-ja ka synimin e pozitiv dhe aftësinë që t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çfarëdo shitje apo ri-klasifikim i një shume të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturitet të cilat nuk janë afër maturitetit të tyre, që do të rezultonte në ri-klasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura në maturitet të gatshme për shitje, dhe do të parandalonte BQK-në që të klasifikojë letrat me vlerë të investimit si të mbajtura në maturitet për vitin aktual dhe dy vitet vijuese financiare.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

i) Prona dh pajisjet

i. Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara.nga ndryshimi në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e mjetit. Kosto e mjeteve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejtë, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e mjetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur.

Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesor) të pronës dhe pajisjes.

ii. Kosto pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të pronës ose pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij mjeti të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të pronës dhe pajisjes (aktiveve afatgjata materiale) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

	2015	**2014**
Investimet në objekte me qira	20 vite	20 vite
Pajisje	5 vite	5 vite
Kompjuterë	3 vite	3 vite
Automjete	5 vite	5 vite

Jetëgjatësia e pajisjeve tjera vlerësohet rast pas rasti. Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

j) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga ndryshimi në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet në vlerësimin për shfrytëzimin e atij programi pa qenë nevoja për ndonjë përmirësim të madh, aktualisht nga 3 deri në 10 vite.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

k) Rënia në vlerë e mjeteve jo-financiare

Vlera kontabël e mjeteve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për ndryshim në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e mjetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aseti ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aseteve që gjeneron rrjedhë të parasë që janë të pavarura nga mjetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësive gjeneruese të parasë shpërndahen në mënyrë proporcionale midis aseteve të tjera të njësisë (grupi të njësive) në baza proporcionale. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

l) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

m) Të ardhurat nga grantet

Grandet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grandin. Grandet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grandet që BQK-ja përfiton për koston e një aseti njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të asetit.

n) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar dhe financuar për një afat të shkurtër nga organizatat ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtar. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në këto pasqyrat financiare.

o) Provizionet

Provizioni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e zbritur rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, riskun specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis kostos së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhdimit të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

(i) Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet dhe interpretimet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** – skemat e definuara të përfitimeve: Kontributet e punonjësve (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014),

- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2010-2012)"** që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 3 SNRF, 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe përmirësimin e tekstit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrikut 2014),

- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2011-2013)"** që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe përmirësimin e tekstit (ndryshimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka dërguar/ndikuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Bankës.

3. Politika të rëndësishme kontabël (në vazhdim)

p) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël (në vazhdim)

ii) **Standardet dhe interpretimet në përfundim që ende nuk janë efektive**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet ishin në përfundim, por ende jo efektive:

- **SNRF 9"Instrumentet financiare"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018),
- **SNRF 14 "Llogaritë e shtyra të Rregullatorit"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016),
- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017),
- **IFRS 16 "Lizingu"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në bashkëpronësi dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo kontributi i pasurive mes një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjeve të përbashkëta (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri në përfundimin e projektit kërkimor mbi metodën e kapitalit),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Shpalosja e interesave në entitetet tjera" dhe SNK 28 "Investimet nëpjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta**" – Njësitë investuese: Aplikimi i Përjashtimit të Konsolidimit (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016),
- **Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"** - Kontabiliteti për Blerjet e Interesave në Aktivitetet e Përbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** – Inicimi i Shpalosjes (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016),
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Rrjedhës së Parasë"** – Incimi i Shpalojses (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017),
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të ardhurat"** - Njohja e të shtyrave tatimore pasuri për humbjet e parealizuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017),
- **Ndryshimet në SNK 16 "Prona, impiantet dhe paisjet"** dhe SNK 38 "Pasuritë e paprekshme" - Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016),
- **Ndryshimet në SNK 16 "Prona, impiantet dhe paisjet " dhe SNK 41 "Aktivitet bujqësore"-** Bujqësi: pronari i kultivimeve (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016),
- **Ndryshimet në SNK 27"Pasqyrat Financiare Individuale"-** metoda e kapitalit neto në Pasqyrat Financiare Individuale (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016),
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (të ciklit 2012-2014)"** që rezultojnë nga projekti per përmirësim vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

Institucioni (Banka) ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave të tyre të hyrjes në fuqi. Banka parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

a) Hyrje dhe vështrim

BQK është ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rrezikuu i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, objektivave, politikave dhe procedurave të BQK-së për matjen dhe menaxhimin e riskut si dhe administrimi i kapitalit nga BQK-ja. Shënime të tjera sasiore dhe cilësore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e menaxhimit të rrezikut

Krijimi dhe mbikëqyrja e administrimit të rrezikut të BQK-së është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht nëpërmjet Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordii Bankës mbi praktikat e administrimit të rrezikut. Bordi Ekzekutiv dhe Komitetit i Investimeve e kane për detyre të bëjnë hartimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika zbatohen më pas nga njësitë përkatëse organizative.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet BQK-ja, si dhe të vendos kufizime dhe kontroll të duhur për rreziqe, dhe të monitoroj rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e ofruara të tregut. BQK-ja, me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvilloj një mjedis kontrolli efektiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet qe përballet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe ad-hoc, rezultatet e të cilave raportohen përmes Shefit të Auditimit të brendshëm tek Komiteti i Auditimit.

b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera.

Menaxhimi i rrezikut kreditor

i. Investimet dhe ekspozimi ndaj bankave tjera

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave i janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur parasysh vlerësimet e larta kreditore, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar / *Menaxhimi i rrezikut kreditor (vazhdim)*

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi më i lartë ndaj rrezikut kreditor bëhet më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, paraqitet nga vlera e bartur e llogarive rrjedhëse me bankat jo-rezidente, e bonove të thesarit dhe depozitave me bankat jo-rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referohuni shënimeve 8, 9 dhe 10.

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është me vonesë ose me rënie në vlerë. Nuk ka ndryshime në politikat e administrimit të rrezikut nga vitet e kaluara. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditor.

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja të ketë vështirësi në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jete e mundur, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i Bankës. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jo-rezidente dhe duke mbajtur shuma të mjaftueshme të mjeteve monetare në kasafortat e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të keqësuara BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testime të rregullta të likuiditetit kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit iu nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet mujore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i paraqiten rregullisht anëtarëve të Komitetit të Investimeve nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për detyrimet financiare, më përjashtim të pagesave të ardhshme të interesit

	Shënim	Vlera e bartur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vjet deri në 7 vite
31 dhjetor 2015						
Detyrimet jo-derivative						
Ndaj bankave komerciale në vend	15	316,406	316,406	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	273,894	178,949	4,357	29,331	61,257
Ndaj institucioneve qeveritare	17	735,744	735,744	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	82,649	82,649	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	680	680	-	-	-
Detyrime tjera vendore	20	756	756	-	-	-
		1,410,129	**1,315,184**	**4,357**	**29,331**	**61,257**
31 dhjetor 2014						
Detyrimet jo-derivative						
Ndaj bankave komerciale në vend	15	315,932	315,932	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	238,713	136,982	2,798	5,596	93,337
Ndaj institucioneve qeveritare	17	713,567	683,561	30,006	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	50,608	50,608	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	34	34	-	-	-
Detyrime tjera vendore	20	2,428	2428	-	-	-
		1,321,282	**1,189,545**	**32,804**	**5,596**	**93,337**

4. Menaxhim i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela e mëparshme tregon rrjedhjet e parasë të pa-zbritura të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të hershme të maturitetit të tyre kontraktual. Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK-ja mban mjete likuide që përfshijnë para dhe kuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet që përhapen në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe kreditë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtur nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin e investimeve.

Menaxhimi i rreziqeve të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në atë masë që aktivet dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Mjetet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçmimit të indekseve të shumëllojshëm me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistent me strategjitë e veprimit të BQK-së. Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e rivlerësimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve. Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portfolios jo të tregtueshme paraqitet si më poshtë:

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

31 dhjetor 2015	shënim	Vlera e bartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-7 vite
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	241,187	241,187	-	-	-
Letra me vlerë (Bonde dhe Bono Thesari)	9	127,319	3,109	53,773	8,187	62,249
Depozita me bankat e huaja	10	805,309	-	-	805,309	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	211,318	125,619	4,889	19,554	61,257
Gjithsej		**1,385,133**	**369,915**	**58,662**	**833,050**	**123,506**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(316,406)	(316,406)	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(216,666)	(130,966)	(4,889)	(19,554)	(61,257)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(735,744)	(735,744)	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(82,649)	(82,649)	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(680)	(680)	-	-	-
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-
Gjithsej		**(1,352,901)**	**(1,267,202)**	**(4,889)**	**(19,554)**	**(61,257)**
Ndryshimi		**32,232**	**(897,288)**	**53,773**	**813,496**	**62,249**

31 dhjetor 2014	Shënim	Vlera e bartur	Më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-7 vite
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	323,401	323,401	-	-	-
Letra me vlerë (Bono Thesari)	9	120,789	-	-	69,997	50,792
Depozita me bankat e huaja	10	660,123	410,020	240,101	10,002	-
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	11	164,193	62,462	-	-	101,731
Gjithsej		**1,268,506**	**795,883**	**240,101**	**79,999**	**152,523**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(315,932)	(315,932)	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(167,803)	(66,072)	-	-	(101,731)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(713,567)	(648,550)	(65,017)	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(50,608)	(50,608)	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(34)	(34)	-	-	-
Detyrime të tjera vendase	20	(2,428)	(2,428)	-	-	-
Gjithsej		**(1,250,372)**	**(1,083,624)**	**(65,017)**	**-**	**(101,731)**
Ndryshimi		**18,134**	**(287,741)**	**175,084**	**79,999**	**50,792**

Aktivet dhe detyrimet financiare që nuk bartin interes nuk janë përfshirë në tabelën më lartë.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standard të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh bazë ("pb"). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2015

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	322	(322)

2014

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	181	(181)

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutore të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj DVT lidhur me aktivet dhe detyrimet e saj në FMN, të cilat i monitoron në vazhdueshmëri. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

2015

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	53	(53)

2014

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	36	(36)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

31 dhjetor 2014	EUR	DVT (Ekuivalenti i EUR)	Gjithsej
Aktivet			
Paraja e gatshme	15,281	-	15,281
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	241,187	-	241,187
Bono thesari	127,319	-	127,319
Depozita me bankat e huaja	805,309	-	805,309
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	127,747	140,454	268,201
Mjetet e tjera	897	-	897
Gjithsej	**1,317,740**	**140,454**	**1,458,194**
Detyrime			-
Detyrime ndaj bankave vendase	316,406	-	316,406
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	184,821	89,304	274,125
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	735,744	-	735,744
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	82,649	-	82,649
Nga huamarrja /et	680	-	680
Detyrime të tjera vendore	1,799	-	1,799
Gjithsej	**1,322,099**	**89,304**	**1,411,403**
Pozicioni neto për valuta të huaja	**(4,359)**	**51,150**	**46,791**

31 dhjetor 2014	EUR	DVT (Ekuivalenti i EUR)	Gjithsej
Aktive			
Paraja e gatshme	29,178	-	29,178
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	323,401	-	323,401
Bono thesari	120,789	-	120,789
Depozita me bankat e huaja	660,123	-	660,123
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	101,731	133,055	234,786
Mjetet e tjera	886	-	886
Gjithsej	**1,236,108**	**133,055**	**1,369,163**
Detyrime			-
Detyrime ndaj bankave vendase	315,932	-	315,932
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	155,240	83,660	238,900
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	713,567	-	713,567
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	50,608	-	50,608
Nga huamarrja /et	34	-	34
Detyrime të tjera vendore	3,181	-	3,181
Gjithsej	**1,238,562**	**83,660**	**1,322,222**
Pozicioni neto për valuta të huaja	**(2,454)**	**49,395**	**46,941**

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja me të cilat merret BQK-ja janë kryesisht "Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes" ("DVT"). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 ishin si vijon:

	2015 EUR	2014 EUR
1 DVT	1.27283	1.1933

DVT-të janë aktive rezervë shtesë si mbështetje në këmbimin/transaksionet e jashtme që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT-ve përcaktohet si mesatare e shportës së katër valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britanike dhe jeni japonez.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullativ si dhe standardet e pranuara gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objektivi i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional si dhe të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me administrimin e kostove efektive.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket stafit menaxhues të çdo njësie organizative. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për vlerësime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve emergjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimit të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin, kur kjo është efektive.

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i brendshëm. Gjetjet e kontrolleve të Auditimit të brendshëm diskutohen me menaxherët e njësisë organizative me të cilat ato janë të lidhura dhe konkluzionet i dërgohen Komitetit të Auditimit dhe menaxhmentit të BQK-së.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Menaxhimi i kapitalit

Në përputhje me Ligjin, BQK-ja krijon dhe mban një rezervë të përgjithshme. Rezerva e përgjithshme nuk mund të përdoret, përveç për qëllime të mbulimit të humbjeve që pëson BQK-ja. Përveç kësaj, BQK-ja do të krijojë llogari të rezervës së rivlerësimit të parealizuara që të japin llogari për fitimet dhe humbjet e parealizuara për shkak të pozicioneve të saj me DVT.

Sipas Ligjit nr. 03/L-209, të ardhurat neto ose humbja neto e BQK-së llogariten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Fitimet në dispozicion për shpërndarje do të përcaktohen:

- duke zbritur nga fitimi neto, shumën totale të ardhurave të parealizuara të rivlerësimit, dhe duke ndarë një shumë ekuivalente në llogarinë përkatëse të parealizuara të rezervës së rivlerësimit, dhe
- duke zbritur nga llogaria e duhur e parealizuar e rezervës së rivlerësimit dhe duke shtuar në fitimet e shpërndara shumën e çfarëdo fitimi të parealizuar që është zbritur nga fitimi neto për një ose më shumë vitet e mëparshme dhe u realizuara gjatë vitit aktual financiar.

Humbjet e parealizuara nga rivlerësimi do të transferohen në llogaritë përkatëse rezervë të parealizuara të rivlerësimit deri në kohën kur këto llogari rezervë rivlerësimi kanë një bilanc zero, pasi që këto humbje do të mbulohen nga fitimi i vitit aktual, atëherë nga ana e rezervave të përgjithshme dhe më pas duke i autorizuar llogarisë kapitale.

Të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

(g) Menaxhimi i aktiveve

Në pajtim me Ligjin 03/L-209 dhe Ligjin 03/L-048, BQK-së i është caktuar përgjegjësia për bërjen dhe menaxhimin e investimeve të autorizuara në emër të Ministrisë së Financave.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me Bordin e Bankës Qendrore zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmërinë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shih shënimin 4).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Lejimet për humbjet kreditore

Mjetet e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për të identifikuar rënien në vlerë të aktivit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi). Përbërësi specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të mjeteve financiare të vlerësuara individualisht dhe bazohet në vlerësimin më të mirë të menaxhimit të vlerës aktuale të rrjedhjeve të pritshme të parasë që pritet të pranohen. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave, menaxhmenti gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali të vendosur. Çdo aktiv me rënie në vlerë, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i mjeteve dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që aktivet dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e aktiveve financiare si të mbajtura deri në maturim, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për ti mbajtur mjetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h).

6. Mjetet dhe detyrimet financiare (klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre.

Në mijë Euro **31 dhjetor 2015**	**Shënim**	**Kreditë dhe llogari të arkëtueshme**	**Të mbajtura në maturitet**	**Të tjera me kosto të amortizuar**	**Vlera totale e bartur**	**Vlera e drejtë**
Paraja e gatshme	7	15,282	-	-	15,282	15,282
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	241,187	-	-	241,187	241,187
Bono thesari	9	-	127,319	-	127,319	127,378
Depozita me bankat e huaja	10	-	805,309	-	805,309	805,309
Aktive me FMN	11	268,277	-	-	268,277	268,277
		524,746	**932,628**	**-**	**1,457,374**	**1,457,924**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	316,406	316,406	316,406
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	273,894	273,894	273,894
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	735,744	735,744	735,744
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	82,649	82,649	82,649
Nga huamarrja /et	19					
Detyrime të tjera vendase	20	-	-	756	756	756
		-	-	**1,409,449**	**1,409,449**	**1,409,449**
31 dhjetor 2014						
Paraja e gatshme	7	29,178	-	-	29,178	29,178
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	323,401	-	-	323,401	323,401
Bono thesari	9	-	120,789	-	120,789	560,819
Depozita me bankat e huaja	10	-	660,123	-	660,123	660,123
Aktivet me FMN	11	234,785	-	-	234,785	234,785
		587,364	**780,912**	**-**	**1,368,276**	**1,808,306**
Detyrime ndaj bankave vendase	15	-	-	315,932	315,932	315,932
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	-	-	238,713	238,713	238,713
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	-	-	713,567	713,567	713,567
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	-	-	50,608	50,608	50,608
Nga huamarrja /et	19	-	-	34	34	34
Detyrime të tjera vendase	20	-	-	2,428	2,428	2,428
		-	-	**1,321,282**	**1,321,282**	**1,321,282**

7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme shprehet e gjitha në Euro.

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja

Këto llogari mbahen në bankat e mëposhtme:

	2015	2014
Deutsche Bundesbank	-	-
Raiffeisen Zentralbank	152,006	145,497
Svenska Handelsbanken	-	10,004
Deutsche Bank	79,162	104,900
Pohjola Bank Plc	9,997	63,000
Commerzbank AG	23	-
Gjithsej	**241,187**	**323,401**

Të gjitha llogaritë rrjedhëse të bankave të mësipërme kanë një vlerësim kreditor prej A-2/P-2, sipas vlerësimit të vitit 2015 nga Standard &Poors/Moody's. Zvoglimi krahas vitit 2014 eshte rrjedhe normale e aktiviteteve ditore, njeherit ky zvogëlim ne llogari rrjedhëse pjeserish manifestohet te rritja, të shënim 9 dhe 10 (të letrat me vlerë dhe plasmanët).

9. Letrat me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione Qeveritare)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupimit janë letra të borxhit qeveritare të lëshuara nga vendet e Bashkimit Evropian. Bonot e thesarit e shpalosura me poshtë kanë maturitet deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve qeveritare deri në dy vite e gjysmë. Të gjitha janë në Euro dhe kanë pasur dhe kanë norma te interesit efektiv qe variron nga 0.016% deri në 2.696% vjetore ne vitin 2015 (ndërsa në 2014: 0.009% deri në 0.370% vjetore).

Bonot e thesarit lëshohen nga qeveritë e vendeve të Bashkimit Evropian si më poshtë:

Sipas shteteve:

	2015	2014
Franca	50,490	-
Holanda	49,996	50,792
Belgjika	-	69,997
Kosova	26,833	-
Gjithsej	**127,319**	**120,789**

Sipas llojit:

	2015	2014
Bono Thesari	64,514	69,997
Obligacione qeveritare	62,805	50,792
Gjithsej	**127,319**	**120,789**

Vlerësimi kreditor për këto instrumente finaciare që BQK-ja ka investuar për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2014 ka qenë per A-3 dhe P-2, sipas vlerësimit të Standard &Poor's /Moody's.
Rritja krahas me 2014 rrjedh pjesërisht nga ajo se gjithsej portfolio është rritur (ndikuar nga rritja e saldove te zërave te detyrimeve, shiko shënim 16, 17 dhe 18) si dhe nga bartja ne mes kategrorive p.sh shënim 8 eshte zvoglëluar dhe janë rritur shumat ne shënim 9 dhe 10.

10. Depozita/Plasmanët me bankat e huaja

Depozitat me bankat e huaja janë të përbëra si më poshtë:

	2015	2014
Depozitat e afatizuara		
Raiffeisen Zentralbank	200,000	20,000
Svenska Handelsbanken	-	80,062
ING Bank	185,000	50,000
Rabobank	90,023	-
Danske Bank	140,004	110,007
Swedbank	-	100,000
Banque Centrale du Luxembourg	-	50,000
Deutsche Bank	160,000	150,000
Pohjola Bank Plc	30,000	100,000
	805,027	**660,069**
Interesi i përllogaritur në depozitat e afatizuara		
Raiffeisen Zentralbank	131	1
Svenska Handelsbanken	-	8
ING Bank	31	1
Rabobank	21	-
Danske Bank	24	6
Swedbank	-	18
Banque Centrale du Luxembourg	-	12
Deutsche Bank	73	1
Pohjola Bank Plc	2	7
	282	**54**
Gjithsej	**805,309**	**660,123**

Depozitat e vendosura me bankat e huaja janë të përcaktuara në Euro dhe përfitojnë interes me normë efektive që levizë nga 0.010% në 0.260% vjetore (2014: 0.005% deri në 0.370% vjetore) si dhe kanë maturitet fillestar nga 3 në 367 ditë (2014: nga 1 në 273 ditë). Të gjitha depozitat kanë një vlerësim kreditor minimal prej A-2/P-2, sipas vlerësimit të bërë për vitin 2015 nga Standard &Poors/Moody's.

Nëse krahasojmë me fund te vitit 2014 vërejmë një rritje të pozicionit të fundvitit 2015 krahas 2014, i cili rrjedh kryesisht nga ajo që është thënë në shënim 8 dhe 9 lidhur me rritjen e portfolios dhe lëvizjet brenda zërave ne kuadër te shënim 8, 9 dhe 10.

11. Mjetet e ndërlidhura me FMN

	2015	2014
Kuota e FMN-së	75,097	70,406
Titujt DVT	65,127	62,462
Interesi i përllogaritur	230	187
FMN	**140,454**	**133,055**
Qeveria		
Kërkesa nga Qeveria për shfrytëzimin e fondeve të FMN-së (SBA)	127,823	101,731
Gjithsej	**268,277**	**234,786**

Mjetet e listuara më sipër lidhen me pranimin e Kosovës në FMN në qershor të vitit 2009. Në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në FMN, BQK-ja vepron si depozitues dhe agjent fiskal. Kjo është në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03-L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kuota në FMN përfaqëson kuotën e regjistrimit që është përcaktuar në kohën e pranimit dhe është e shprehur në DVT (e shpalosur më lartë në ekuivalent të Euros) dhe shuma përcaktohet në bazë të rregullave dhe rregulloreve të FMN-së.

Titujt DVT përfaqësojnë aktive të aprovuara nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së sipas alokimeve të DVT ndaj vendeve anëtare të FMN-së (vendime të marra më 28 gusht 2009 dhe 9 shtator 2009). Titujt DVT përfitojnë norma vjetore të interesit në vitin 2015 të cilat variojnë nga 0.044% në 0.050% vjetore (2014: 0.050% deri në 0.120% vjetore).

Kërkesa nga Qeveria për shfrytëzimin e fondeve të FMN-së përfaqësojnë si detyrime ndaj Qeverisë që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes Stand-by ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe FMN-së në qershor të vitit 2010, prill 2012 dhe korrik 2015, me anë të së cilave Qeveria e Kosovës ka përfituar nga FMN-ja një linjë të shfrytëzimit të mjeteve në përputhje me marrëveshjet në fjalë, ndërsa pozicioni me 31 dhjetor 2015 është 100.4 milion DVT (apo, 127.8 milion Euro). Norma e interesit të kësaj marrëveshje është e lidhur me normën e interesit sipas kushteve të tregut të normës bazë të interesit të vendosur nga FMN-ja, e cila vetë është e lidhur me normën e interesit të DVT-ve. Norma e interesit për vitin 2015 lëviz në baza tremujore në vit mesatarisht nga 1.044% deri në 1.050% vjetore (në 2014 ka lëvizur nga 1.05% deri në 1.12% vjetore).

BQK-ja vepron si institucion depozitues (bankë) për Qeverinë e Kosovës. Për të menaxhuar aktivitete e rrjedha nga marrveshet me FMN-në, BQK-ja dhe Qeveria e Kosovës kanë arritur ka nenshkarur marrveshje mirëkuptimi per secilën marrveshje Stand-by "mbi procedurat për kërkesë, pranim, shërbim dhe ri-blerje të fondeve nga FMN-ja sipas kushteve të marrëveshjes Stand-By. Bazuar në këtë marrëveshje BQK-ja tërheq DVT-të nga FMN-ja në emër të Qeverisë dhe i krediton këto fonde në llogarinë e Qeverisë.

12. Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet përbëhen si më poshtë:

	Investime në objektet me qira	Pajisje	Kompjuter	Automjete	Aktivet në ndërtim	Gjithsej
Kosto						
Më 1 janar 2014	2,045	1,484	881	242	55	4,707
Blerje	2	174	145	-	30	351
Transfer nga/në	10	22	-	-	(32)	-
Transfer nga/në (korrigjim)	-	-	-	-	(23)	(23)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(67)	-	(67)
Më 31 dhjetor 2014	**2,057**	**1,680**	**1,026**	**175**	**30**	**4,968**
Më 1 janar 2015	2,057	1,680	1,026	175	30	4,968
Blerje	7	124	372	145	127	775
Transfer nga/në	-	-	-	-	-	-
Transfer nga/në (korrigjim)	-	-		-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	**2,064**	**1,804**	**1,398**	**320**	**157**	**5,743**
Zhvlerësimi						
Më 1 janar 2015	471	1,296	812	221	-	2,800
Zhvlerësimi i vitit	103	78	77	21	-	279
Transfer nga/në (korrigjim)	-	10	(10)	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(67)	-	(67)
Më 31 dhjetor 2015	**574**	**1,384**	**879**	**175**	**-**	**3,012**
Më 1 janar 2015	574	1,384	879	175	-	3,012
Zhvlerësimi i vitit	103	86	142	28	-	359
Transfer nga/ në (korrigjim)	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	**677**	**1,470**	**1,021**	**203**	**-**	**3,371**
Vlerat bartëse						
Më 1 janar 2014	**1,574**	**188**	**69**	**21**	**55**	**1,907**
Më 31 dhjetor 2014	**1,483**	**296**	**147**	**-**	**30**	**1,956**
Më 31 dhjetor 2015	**1,387**	**334**	**377**	**117**	**157**	**2,372**

Nuk ka mjete të bllokuara si kolaterale deri më 31 dhjetor 2015 (31 dhjetor 2014: asnjë).

13. Aktive të paprekshme

Mjetet e paprekshme përbëhen si më poshtë:

	Programe kompjuterike në zhvillim	Programe kompjuterike	Gjithsej
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2014	113	2,012	2,125
Blerje	34	89	123
Transfere (nga)/për	(88)	88	-
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	23	23
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**59**	**2,212**	**2,271**
Gjendja më 1 janar 2015	59	2,212	2,271
Blerje	424	79	503
Transfere (nga)/në	-	-	-
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit humbura	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**483**	**2,291**	**2,774**
Amortizimi			
Gjendja më 1 janar 2014	-	814	814
Amortizimi për vitin	-	206	206
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**-**	**1,020**	**1,020**
Gjendja më 1 janar 2015	-	1,020	1,020
Amortizimi për vitin	-	202	202
Nxjerrje jashtë përdorimit/të humbura	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**-**	**1,222**	**1,222**
Shumat e bartura			
Gjendja më 1 janar 2014	**113**	**1,198**	**1,311**
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**59**	**1,192**	**1,251**
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**483**	**1,069**	**1,552**

14. Aktive tjera

Mjetet e tjera përbëhen si më poshtë:

	2015	2014
Të ardhura të përllogaritura nga tarifat	808	771
Llogari të arkëtueshme dhe parapagime	89	115
Gjithsej	**897**	**886**

Të ardhura të përllogaritura nga tarifat paraqesin vlerësimet për tarifat nga ripërtëritja e licencave dhe tarifa të tjera për institucionet financiare vendore për tremujorin e fundit.

15. Detyrime ndaj bankave komerciale në vend

Sipas Rregullës XVII të BQK-së për mbikëqyrjen bankare, bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë të detyruara të mbajnë rezerva të likuiditetit në shumën prej 10% të depozitave të kualifikuara të klientëve të tyre. Së paku gjysma e kësaj rezerve duhet të mbahet në llogari në BQK-së.

Detyrime ndaj bankave në vend

	2015	2014
ProCredit Bank Kosovë	31,592	29,511
Raiffeisen Bank Kosovë	32,682	30,023
NLB Prishtina	15,955	16,984
Banka Ekonomike	6,754	5,910
Banka për Biznes	4,522	3,989
Banka Kombëtare Tregtare (dega në Prishtinë)	8,774	8,740
Banka Ekonimike Turke (TEB)	15,230	14,401
Komercijalna Banka – Dega në Mitrovicë	2,501	2,407
Turkiye is Bankasi a.s.	1,305	1,449
T.C. Ziraat Bankasi A.S. - Dega në Kosovë	63	-
Banka Kreditore e Prishtinës	-	-
Gjithsej rezerva e kërkuar	**119,378**	**113,414**
Shuma shtesë mbi rezervën e kërkuar		
ProCredit Bank Kosovë	45,633	82,301
Raiffeisen Bank Kosovë	19,250	16,110
NLB Prishtina	23,254	25,840
Banka Ekonomike	10,818	5,005
Banka për Biznes	18,054	16,902
Banka Kombëtare Tregtare (dega në Prishtinë)	30,958	15,098
Banka Ekonimike Turke (TEB)	35,779	32,285
Komercijalna Banka – Dega në Mitrovicë	2,436	2,350
Turkiye is Bankasi a.s.	4,999	6,607
T.C. Ziraat Bankasi A.S. – Dega në Kosovë	5,788	-
Banka Kreditore e Prishtinës	59	20
Gjithsej shtesa në llogaritë rrjedhëse	**197,028**	**202,518**
Gjithsej shuma në llogaritë rrjedhëse	**316,406**	**315,932**

16. Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në

	2015	2014
FMN Llogaria nr. 1	188	176
FMN Llogaria nr. 2	6	6
FMN Llogaria e letrave me vlerë	184,627	155,058
FMN DVT Shpërndarja	70,475	66,072
Interesi i përllogaritur (akrual)	230	187
Gjithsej detyrimi ndaj FMN	**255,526**	**221,499**
Detyrimi ndaj Qeverisë		
FMN- Pjesa e kuotës e paguar nga Qeveria	18,368	17,214
Gjithsej detyrimi ndaj Qeverisë	**18,368**	**17,214**
Gjithsej	**273,894**	**238,713**

Vlerat e mësipërme lidhen me pranimin e Kosovës në FMN në qershor 2009.

Llogaritë nr. 1 dhe nr. 2 janë llogari të FMN-së në BQK që janë hapur sipas kërkesave të bazuara në rregullat dhe rregulloret e FMN-së.

Llogaria e letrave me vlerë të FMN-së paraqet një lloj dëftese të borxhit të cilën Qeveria e Kosovës duhet ta paguaj, sipas kërkesës së FMN-së. Kjo shumë paraqet detyrimin e BQK-së ndaj FMN-së dhe përputhet me kërkesën korresponduese të BQK-së tek Qeveria e Kosovës.

Pjesa e paguar në FMN e kuotës nga Qeveria e Kosovës, paraqet shumën që Qeveria e Kosovës ia ka paguar FMN-së në emër të kuotës së FMN-së.

Shpërndarja e DVT-ve paraqet shpërndarjet e DVT-ve në shtetet anëtare të FMN-së, që është aprovuar nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së më 28 gusht 2009 dhe 9 shtator 2009.

Shpërndarjet e DVT-ve dhe pjesa e paguar e kuotës janë interesa që përmbajnë norma vjetore interesi mesatar që variojnë nga 0.044% - 0.050% për vitin 2015 (2014: 0.05% - 0.12% vjetore).

17. Detyrime ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare përfshijnë llogaritë rrjedhëse si më poshtë:

Llogaritë rrjedhëse	**2015**	**2014**
Thesari- Ministria e Financave	248,780	90,481
Agjencia Kosovare e Privatizimit	486,819	557,801
Institucionet e përkohshme administrative	145	268
Gjithsej llogaritë rrjedhëse	**735,744**	**648,550**
Depozita me afat		
Thesari - Ministria e Financave	-	65,017
Agjencia Kosovare e Privatizimit	-	-
Gjithsej depozitat me afat	**-**	**65,017**
Gjithsej	**735,744**	**713,567**

Norma e interesit efektiv vjetor për llogaritë rrjedhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 është zero (për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014: zero). Për depozitat me afat normat e interesit efektiv për vitin 2015 nuk është e aplikueshme (2014: 0.010% - 0.37 % vjetore).

18. Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale

	2015	**2014**
Llogaritë rrjedhëse		
Kompanitë e sigurimeve	4,528	4,982
Institucionet tjera publike	78,119	45,556
Fondet e licencuara pensionale	-	68
Të tjera	2	2
Gjithsej	**82,649**	**50,608**

Norma e interesit efektiv për llogaritë rrjedhëse më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është zero. Ndryshimi në kuadër të grupit rrjedh nga tërgheqja e mjeteve të mbajtura në llogari rrjedhëse për njërën nga llogarit e një institucioni publik bazuar në qëllimet e tyre operative me llogarinë vetanake në BQK.

19. Detyrime nga humarrja/et

	2015	**2014**
Huamarrja /et	680	34
Gjithsej	**680**	**34**

Shumat më sipër paraqesin huamarrjen nga Banka Botërore. Banka ka shfrytëzuar mundësin e huamarrjes me kushte të favorshme (norma e ulët e interesit dhe periuhda e mospageses se kryegjësë prej rreth 10 vite). Kryesisht humarrja nderlidhet me projetin per zhvillimin e pagesave brenda vendit ne drejtimit të procesimit te tyre ne kohë reale.

20. Detyrime të tjera vendore

	2015	2014
Llogari në përkujdesje	756	2,428
Të ardhura të shtyra nga grandet	622	456
Të ardhurat tjera të shtyra	9	6
Fondi i rezervave	168	145
Kreditorë të ndryshëm	244	146
	1,799	**3,181**

Ndryshimi rrjedh vetëm nga rrjedha normale e aktiviteteve në kuadër të grupimit në raport me datat kur shpalosen gjendjet.

Bilanci i llogarive në përkujdesje përbëhet nga këto lloje të llogarive dhe shumave.

Shuma prej 1,134 Euro paraqet shumat e qerasë të mbledhura nga BQK-ja deri më 5 janar 2004 në emër të ish Bankës Kombëtare të Kosovës, të cilat i ishin lëshuar me qera subjekteve të ndryshme/individëve. Kjo shumë përfshinë edhe interesin e fituar nga këto pagesa të qerasë deri më 31dhjetor 2014. Kjo gjate vitit 2015 eshte bartur ne te hyra te jashtëzakonshme.

Të përfshira në llogaritë në përkujdesje janë edhe disa shuma parash, në valuta të ndryshme dhe aktive të tjera, që BQK-ja i ka trashëguar që nga krijimi, nga ish Banka Kombëtare e Kosovës dhe interesin e fituar me vite e që deri më 31 Dhjetor 2014 kap shumën prej 538 mijë euro. Këto mjete në vitin 2015 janë transferaur në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Më 31 dhjetor 2015 në kuadër të llogarive në përkujdesje janë të përfshira edhe 756 mijë Euro, që ndërlidhen llogaritë rrjedhëse të Kompanisë së Sigurimeve Kosova e cila është likuiduar në prill të vitit 2010. Vetëm kjo ka mbetur si llogari ne përkujdesje me 31 dhjetor 2015.

Lëvizjet në të hyrat nga grantet janë si vijon:

	Ministria e Financave (ICU Portofoli)	Banka Botërore	Gjithsej
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 janar 2014	**495**	**28**	**523**
Grante të pranuara gjatë vitit	10	-	10
Të ardhurat nga grantet për vitin	(70)	(7)	(77)
Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2014	**435**	**21**	**456**
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 janar 2015	435	21	456
Grande të pranuara gjatë vitit	10	233	243
Grandet e njohura si hyrje për vitin	(70)	(7)	(77)
	-	-	-
Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2015	**375**	**247**	**622**

21. Kapitali i autorizuar

Kapitali i Autorizuar i BQK-së më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është 30,000 Euro sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010.
BQK i raporton Kuvendit të Kosovës. Kapitali i BQK-së nuk i nënshtrohet ndonjë detyrimi.

21a. Fondi rezervë dhe rezerva e rivlerësimit

Fondi rezervë dhe rezerva e rivlerësimit rregullohet me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Fitimi i çdo viti financiar, shpërndahet si përshkruhet në shënimin 4 (f) në përputhje me këtë ligj.

22. Të ardhurat neto nga interesi

Të ardhurat neto nga interesi, përbëhen si vijon:

	2015	2014
Të ardhurat nga interesi		
Nga llogaritë e depozitave	528	812
Nga bonot e thesarit	81	636
Nga llogaritë rrjedhëse	33	56
	642	**1,504**
Shpenzimet e interesit		
Në llogaritë rrjedhëse të entiteteve jo-bankare	37	54
Në depozitat me afat	8	-
Në depozitat me afat	3	192
	48	**246**
Të ardhura neto nga interesi	**594**	**1,258**

23. Të ardhurat neto nga tarifat dhe ndalesat

Të ardhurat neto nga tarifat dhe ndalesat përbëhen si në vijim:

	2015	2014
Të ardhura nga tarifat		
Nga depozitime parash	438	459
Nga transfertat e jashtme hyrëse	51	40
Nga transfertat e jashtme dalëse	258	290
Nga sistemi kliringut ndër-bankar	520	477
Nga sistemi i regjistrit të kredive	116	121
Nga menaxhimi i fondeve të thesarit	25	224
Tarifat e tjera	34	29
	1,442	**1,640**
Shpenzimet nga tarifat		
Për transport parash	360	273
Për transaksione me bankat korrespondente	16	45
	376	**318**
Të ardhura neto nga tarifat dhe ndalesat	**1,066**	**1,322**

23. Të ardhurat nga neto tarifat dhe ndalesat (vazhdim)

Të ardhurat nga menaxhimi i fondit të thesarit rrjedhin (shënim 23) nga shërbimet e menaxhimit të mjeteve të Thesarit të Ministrisë së Financave nga BQK. Këto shërbime janë në përputhje me Ligjin për BQK-në.

24. Të ardhura nga aktiviteti rregullativ

Të ardhurat të tjera operative përfshijnë kryesisht tarifa të vendosura ndaj institucioneve financiare në Kosovë si pjesë e lëshimit apo ripërtëritjes së licencave, po ashtu edhe tarifa të tjera të detyrueshme që kanë të bëjnë me aktivitetet e tyre.

Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ:

	2015	2014
Tarifa ngarkuar për bankat komerciale	2,056	1,958
Tarifa ngarkuar për kompanitë e sigurimit	1,196	1,144
Tarifa nga institucionet financiare jo-bankare	146	196
Tarifa nga ripërtëritja e pensioneve	12	13
Gjithsej	**3,410**	**3,311**

25. Të ardhurat nga grantet

Të ardhurat nga grantet përbëhen si në vijim:

	2015	2014
Thesari - Ministria e Financave (ICU portofoli)	70	70
Banka Botërore	7	7
Gjithsej	**77**	**77**

26. Të ardhurat tjera operative

Të ardhurat tjera:

	2015	2014
Të ardhurat tjera (jo të rregullta)	1,139	18
Gjithsej	**1,139**	**18**

Në kuadër të të ardhurave tjera jo te rregullta janë te hyrat jo të rregullta nga shënim 20 dhe te hyra tjera qe nuk ndërlidhen me aktivitetin e rregullt e as ne ndonjë ze tjetër specifik të shpalosur si të veçantë.

27. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit përbëhen si në vijim:

	2015	2014
Pagat	2,812	2,779
Kontributet pensionale	449	439
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	175	178
Trajnimet e stafit	63	43
Shpenzimet e Bordit të Bankës Qendrore	101	107
Të tjera	25	25
Gjithsej	**3,625**	**3,571**

Numri i punonjësve në BQK më 31 dhjetor 2015 ishte 215 (31 dhjetor 2014: 201). Nga shpalosja me lartë vërehet se kemi rritje te shpenzimeve te personelit, ne vitin 2015 krahas me vitin 2014, dhe kjo është e ndikuar nga rritja e numrit të personelit.

28. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative përbëhen si në vijim:

	2015	2014
Shpenzimet e sigurimit	203	185
Mirëmbajtje dhe riparime	36	44
Mirëmbajtja e programeve kompjuterik	286	240
Shpenzimet e komunikimit (telefon, teleks, dhe internet)	36	51
Shërbime komunale	91	97
Shpenzimet e auditimit dhe këshillimit	17	18
Shpenzimet sigurisë dhe ruajtjes	62	44
Udhëtime dhe transport	134	107
Shpenzimet operative të veturave	29	33
Materiale zyre	6	21
Shpenzime për përfaqësimi*	37	36
Shpenzime për reprezentacion (tjera*)	12	11
Shpenzime e kafitërisë	28	28
Shpenzimet konsumuese për kompjuterë artikuj të tjerë te nderlidhur	12	10
Shpenzime konsumuese per pajisje	8	40
Shpenzimet e publikimit dhe literaturës	24	38
Asistnca tekniko profesionale dhe shërbime tjera te jashtme	30	121
Anëtarsime shoqata profesionale**	27	29
Shpenzimet e provizioneve***	23	145
Të tjera	13	21
Gjithsej	**1,114**	**1,319**

* Shpenzime për reprezentacion (tjera) janë kryesisht dreka/darka reprezantuese të institucionit, Shpenzimet e përfaqësimit përbehen: *konferenca gjate vitit 2015, programi i edukimit financiar, përfaqësimi ne garat sportive rajonale, pikniku, dhurata e fëmijëve për fund vit, ceremonitë dhe dhuratat për pensionim të personelit, dhurata për 8 mars* dhe te ngjashme.

** Anëtarësimet në shoqata profesionale kryesisht janë anëtarësimet në shoqata të nivelit ndërkombëtar të rregullatorëve të mbikëqyrjes së sigurimit, mbikëqyrjes së pensioneve, regjistrit të kreditëve, për auditim të brendshëm si dhe standarde të raportimit financiar.

*** Provizionet e ndara për konteste gjyqësore te hapura me 31 Dhjetor 2015.

29. Fitimi/ (humbjet) neto nga vlerësimi (këmbimi) valutor

Humbja neto nga kursi i vlerësimi (këmbimi) valutor është 298 mijë Euro për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, (ndërsa 2014: fitim prej 225 mijë) paraqet fitimet/humbjet e parealizuara në raport me diferencat e ardhura nga rivlerësimet (këmbimet) valutore nga përkthimi i mjeteve dhe detyrimeve të DVT-ve të shprehura në librat e BQK-së.

30. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga:

	Shënim	2015	2014
Paraja e gatshme	7	15,282	29,178
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	241,187	323,401
Bono thesari me maturitet deri në tre muaj	9	2,864	-
Depozita me bankat e huaja me maturitet deri në tre muaj	10	-	410,007
Gjithsej		**259,333**	**762,586**

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen për qëllim të përmbushjes se detyrimeve të likuiditetit kryesisht afatshkurtër. Një investim kualifikohet si ekuivalent i parasë kur ai ka maturim afatshkurtër, më pak se tre muaj nga data e blerjes.

31. Detyrime të kontraktuara dhe kontingjente

Ligjore

BQK-ja ka disa procese të hapura gjyqësore kundër saj në datën e raportimit të këtyre pasqyrave financiare. Është mendim i menaxhmentit se rezultati përfundimtar i këtyre padive nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të BQK-së më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, megjithatë duke dashur te jemi te kujdeshëm për disa prej tyre kemi vlerësuar ndarjen e një fondi rezervë i shpalosur si zë te detyrimet tjera.

Detyrimet të kontraktuara kreditore

Më 31 dhjetor 2015, BQK-ja kishte për detyrim që të vendoste depozita në shumën e përgjithshme prej 0 (zero) milion Euro (31 dhjetor 2014, BQK-ja kishte për detyrim që të vendoste depozita në shumën e përgjithshme prej 149 milion Euro).

31. Detyrime të kontraktuara dhe kontingjente (vazhdim)

Detyrimet të kontraktuara kreditore (vazhdim)

Detyrime të tjera

Detyrime e tjera përbëhen nga:

	2015	2014
Kontrata për shërbime	79	17
Kontrata per renovim dhe riparim ne objekt	2,041	-
Kontrata për pajisje	61	145
Gjithsej	**2,181**	**162**

Në vitin 2009, Kosova u bë anëtare e organizatave të grupit të Bankës Botërore – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH), Asociacioni Ndërkombëtare për Zhvillim (ANZH), dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (AGISH). Në lidhje me këtë anëtarësim, BQK-ja vepron si depozitare. Kjo është në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03-L-152 për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Në qershor 2009, Qeveria e Kosovës lëshoi letra premtimi për të bërë pagesa lidhur me anëtarësimet në agjencitë e Bankës Botërorë të lartpërmendura, sipas kërkesës dhe instruksioneve të pagesës së tyre. Shuma totale më 31 dhjetor 2015 ishte 645 mijë dhe më 2014 e këtyre letrave të premtimit ishte 645 mijë Euro.

32. Transanksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përfshijnë Menaxhmentin Kyç dhe Bordin e Bankës Qendrore. Kompensimet e tyre paraqiten si më poshtë:

	2015	2014
Kompensimet për anëtaret e Bordit të Bankës Qendrore	80	81
Kompensimet për Komitetin e Auditimit	7	7
Kompensimi për personelin kyç të menaxhmentit	184	216
Gjithsej	**271**	**304**

33. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas datës së bilancit për të cilat do të ketë nevojë të bëhen rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare.

9. Shtojca Statistikore

1.1. Pasqyra e korporatave financiare - asetet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto								Kërkesat e brendshme							
		Kërkesat ndaj jorezidentëve				prej të cilave:		Detyrime ndaj jorezidentëve		Kërkesat ndaj qeverisë qendrore			Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	prej të cilave:		
			Ari monetar dhe DST-të	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota në FMN	Asetet dhe ekuitete tjera				Kërkesat ndaj qeverisë qendrore	Detyrimet ndaj qeverisë qendrore		Kreditë	prej të cilave:	
															Korporat. tjera jofinan.	Ekon Familjare
2005	827.3	890.9	__	422.6	242.4	__	145.3	63.6	348.9	-225.7	__	225.7	574.6	565.6	439.6	126.0
2006	1,173.6	1,245.7	__	660.0	341.3	__	170.8	72.1	231.7	-475.0	__	475.0	706.6	694.3	548.2	146.1
2007	1,622.4	1,704.6	__	955.0	408.9	__	175.4	82.3	124.5	-853.3	__	853.3	977.8	965.9	765.1	200.6
2008	1,593.1	1,726.7	__	795.1	661.6	__	128.2	133.6	419.6	-871.8	__	871.8	1,291.5	1,276.8	995.7	281.0
2009	1,700.5	2,036.2	60.3	910.1	724.5	64.3	144.3	335.7	571.5	-846.3	__	846.3	1,417.8	1,396.1	1,052.3	343.5
2010	1,957.5	2,387.7	64.0	1,257.8	525.2	68.5	269.3	430.2	766.8	-824.8	__	824.8	1,591.6	1,568.3	1,127.7	434.2
2011	2,067.8	2,446.0	65.1	1,359.4	230.0	70.1	533.1	378.2	987.5	-798.4	__	798.4	1,785.8	1,785.8	1,242.1	514.6
2012	2,337.1	2,773.4	63.3	1,260.7	486.0	68.8	666.5	436.3	1,079.9	-764.7	73.8	838.5	1,847.2	1,819.4	1,271.3	546.3
2013	2,558.5	3,014.1	59.6	1,143.6	818.7	65.9	651.2	455.6	1,263.4	-620.8	153.2	774.0	1,884.2	1,859.9	1,291.1	567.7
2014	2,648.4	3,113.3	62.5	1,414.7	315.7	70.4	1,024.4	465.0	1,507.3	-488.5	247.4	735.9	1,995.8	1,971.5	1,345.5	625.3
2015	2,765.1	3,288.2	65.1	1,399.4	378.2	75.1	1,086.3	523.1	1,710.1	-432.8	326.8	759.6	2,142.9	2,114.6	1,428.3	685.6

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/01%20Financial%20Corporations%20Survey.xls

1.2. Pasqyra e korporatave financiare - Detyrimet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Depozitat					Depozita tjera				Kreditë	Rezervat teknike të sigurimit			Asetet dhe ekuitete tjera	Zëra tjerë (neto)
		Depozitat e transferueshme	prej të cilave:				prej të cilave:								
			Korp. publike jofinanc.	Korp. tjera financ.	Eko. familjare		Korpo. publike jofinanciare	Korpo. tjera jofinanciare	Ekono. familjare			Ekuiteti neto i ekonomive familjare ne fondet e pension.	Pagesa e premive dhe rezervave		
2005	830.6	315.0	67.6	76.8	155.5	515.6	181.3	33.7	298.9	3.0	174.5	152.4	22.1	165.8	2.2
2006	886.4	300.5	34.8	96.4	156.2	586.0	193.3	27.6	359.5	3.4	251.4	223.9	27.5	209.3	54.7
2007	1,110.9	386.1	49.6	133.5	187.5	724.8	188.4	43.8	489.3	…	316.1	286.2	29.9	273.8	46.0
2008	1,351.9	390.9	15.4	176.0	186.2	961.0	250.1	51.4	656.7	…	288.6	256.3	32.3	311.1	61.1
2009	1,444.3	483.2	50.1	184.0	237.7	961.0	73.9	82.9	801.9	…	422.3	380.8	41.5	326.1	79.3
2010	1,744.2	621.2	83.8	218.6	303.5	1,123.1	42.8	83.4	995.9	…	540.5	493.7	46.8	361.0	78.6
2011	1,933.6	658.4	68.1	208.1	360.9	1,275.1	60.8	79.7	1,129.6	…	647.8	593.3	54.5	389.7	75.0
2012	2,076.6	700.2	13.8	257.5	407.2	1,376.5	61.8	78.2	1,232.9	…	814.9	745.1	69.8	399.2	128.9
2013	2,275.3	848.0	16.4	299.6	506.6	1,427.3	55.7	98.2	1,268.4	…	990.3	919.0	71.3	403.9	152.4
2014	2,354.4	1,134.6	21.1	338.4	743.5	1,219.8	51.6	58.0	1,104.8	…	1,173.8	1,094.1	79.7	453.2	175.8
2015	2,513.3	1,378.6	11.2	413.8	919.1	1,134.7	20.6	68.2	1,045.4	...	1329.5	1,237.3	92.1	531.6	100.8

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/01%20Financial%20Corporations%20Survey.xls

2.1. Pasqyra e korporatave depozituese - Asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto							Kërkesat e brendshme							
		Kërkesat ndaj jorezidentëve					Minus: Detyrimet ndaj jorez.		Kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore			Kërkesat ndaj sektorëve tjerë			
			Paraja e gatshme	Depo-zita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota e FMN-së				Kërkesat ndaj qeverisë qendrore	Minus: detryimet ndaj qev.. qendrore		Kreditë	prej të cilave:	
														Korp. tjera jofinan.	Ekono-mitë familjare
2001	583.3	604.8	239.2	358.1	7.5	__	21.5	-44.2	-70.3	__	70.3	26.1	25.9	25.9	__
2002	649.5	674.1	53.1	621.0	,,,	__	24.6	-171.8	-258.6	__	258.6	86.8	86.5	80.8	5.7
2003	695.8	727.0	73.2	533.6	119.6	__	31.2	-112.6	-346.4	__	346.4	233.8	232.8	193.5	39.0
2004	648.7	687.9	55.3	384.0	236.7	__	39.2	156.9	-216.8	__	216.8	373.8	373.7	289.9	83.7
2005	695.1	744.5	74.6	422.6	242.4	__	49.3	289.0	-225.7	__	225.7	514.6	513.9	387.9	126.0
2006	975.4	1,035.6	63.4	660.0	303.1	__	60.2	162.2	-475.0	__	475.0	637.1	636.6	490.5	146.1
2007	1,377.5	1,426.1	145.3	955.0	308.2	__	48.6	39.1	-853.3	__	853.3	892.4	892.1	691.3	200.6
2008	1,436.1	1,512.0	121.1	794.9	581.8	__	75.9	311.9	-871.8	__	871.8	1,183.8	1,183.4	901.7	281.0
2009	1,531.6	1,782.2	111.4	910.0	626.4	64.3	250.6	442.9	-846.3	__	846.3	1,289.2	1,289.0	942.9	343.5
2010	1,616.2	1,957.1	164.3	1,257.8	372.7	68.5	340.9	632.8	-824.8	__	824.8	1,457.5	1,457.1	1,006.6	434.2
2011	1,603.8	1,900.3	124.9	1,359.3	227.0	70.1	296.6	867.7	-798.4	__	798.4	1,666.1	1,665.6	1,130.6	514.6
2012	1,729.7	2,102.8	141.4	1,260.7	482.7	68.8	373.1	962.9	-778.7	59.8	838.5	1,741.6	1,740.9	1,172.9	546.3
2013	1,965.4	2,358.3	157.9	1,143.5	815.3	65.9	392.9	1,113.3	-673.9	100.1	774.0	1,787.2	1,786.0	1,196.7	567.7
2014	1,680.8	2,083.9	160.4	1,414.6	311.6	70.4	403.1	1,339.8	-543.2	192.7	735.9	1,883.1	1,881.9	1,235.0	639.0
2015	1,736.7	2,197.1	190.8	1,399.3	374.3	75.1	460.4	1,486.9	-533.3	226.3	759.6	2,020.1	2,019.0	1,324.1	685.4

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/02%20Depository%20Corporations%20Survey.xls

2.2. Pasqyra e korporatave depozituese - Detyrimet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Depozitat e përfshira në paranë e gjerë											Depozita jashtë parasë së gjerë	Asetet dhe ekuitet e tjera	Zëra tjerë (neto)
		Depozitat e transferueshme					Depozita tjera							
			prej të cilave:					prej të cilave:						
			Korp. tjera financiare	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ekono. familjare		Korp. tjera financiare	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare			
2001	486.8	361.5	.	7.0	135.3	219.2	125.2	.	.	31.3	93.9	12.9	25.2	14.3
2002	413.6	285.3	.	3.5	160.1	121.7	128.3	.	.	23.9	104.4	25.1	43.8	-4.8
2003	499.3	278.7	.	5.3	139.0	134.4	220.6	.	.	87.1	133.5	29.2	61.1	-6.4
2004	719.5	303.5	29.8	34.6	81.3	145.5	416.0	19.1	149.3	24.4	222.5	__	87.1	-1.0
2005	865.4	345.6	30.5	67.6	76.8	155.5	519.9	24.3	181.3	33.1	279.6	19.9	94.4	4.3
2006	912.8	336.4	35.9	34.8	96.4	156.2	576.3	30.5	193.3	24.6	322.4	40.6	128.8	55.4
2007	1,126.6	413.7	27.7	49.6	133.5	187.5	712.8	40.3	188.4	41.8	439.0	53.7	186.5	49.8
2008	1,393.0	454.6	63.7	15.4	176.0	186.2	938.3	47.6	250.1	44.2	593.8	74.9	233.8	46.4
2009	1,548.5	621.4	138.2	50.1	184.0	237.7	927.0	60.7	73.9	71.7	718.5	98.1	249.0	79.0
2010	1,747.9	674.3	53.1	83.8	218.6	303.5	1,073.6	85.2	30.2	73.5	883.7	138.2	278.5	84.4
2011	1,902.2	705.3	37.8	77.2	208.1	360.9	1,196.9	91.0	49.2	71.7	979.9	175.8	302.9	90.6
2012	2,036.8	759.5	41.9	31.2	257.5	407.2	1,277.3	100.4	49.8	70.5	1,053.1	206.2	321.1	128.5
2013	2,388.5	1,096.3	226.5	39.1	299.6	506.6	1,292.1	62.2	43.7	92.3	1,088.9	209.7	329.0	151.5
2014	2,287.4	1,194.7	60.8	21.1	338.4	743.5	1,092.7	67.2	39.4	50.2	930.6	208.7	**373.8**	**150.6**
2015	2,433.0	1,474.7	96.9	0.4	413.8	919.1	957.5	37.6	12.8	54.3	852.3	232.7	445.4	112.4

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun:

http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/02%20Depository%20Corporations%20Survey.xls

Tabela 3.1. Pasqyra e BQK-së - Asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto							Minus: detyrimet ndaj jorezidentëve			Kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore	Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	Detyrimet ndaj KTD-ve
		Kërkesat ndaj jorezidentëve	prej të cilave:						prej të cilave:				
			DST-të	Paraja e gatshme	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kuota e FMN-së		Alokimi i DST-ve	Llogaria e FMN-së			
2001	293.7	296.2	__	150.8	145.4	__	__	2.6	__	__	-70.3	0.2	173.9
2002	345.4	345.8	__	17.5	328.3	__	__	0.4	__	__	-258.6	0.3	46.2
2003	454.3	454.6	__	26.6	427.4	__	__	0.3	__	__	-346.4	1.0	59.6
2004	344.7	349.9	__	12.1	213.2	124.4	__	5.2	__	__	-216.8	0.1	72.9
2005	394.4	397.5	__	24.5	213.4	159.5	__	3.1	__	__	-225.7	0.8	82.5
2006	641.1	641.2	__	11.1	424.9	203.6	__	0.1	__	__	-472.9	0.5	94.5
2007	1,057.6	1,057.6	__	63.8	759.0	229.3	__	…	__	__	-849.4	0.3	113.6
2008	1,110.7	1,110.7	__	39.7	529.0	541.3	__	…	…	__	-870.5	0.3	137.2
2009	1,088.3	1,198.5	60.3	21.8	522.3	529.7	64.3	110.2	60.3	49.1	-681.5	0.2	233.2
2010	1,108.0	1,246.9	64.0	60.2	854.4	199.2	68.5	138.9	64.2	73.0	-813.1	0.5	203.6
2011	1,094.5	1,234.6	65.1	13.5	1,059.3	25.0	70.1	135.8	65.7	69.4	-797.2	0.5	209.7
2012	1,238.8	1,469.1	63.3	16.8	1,034.1	286.0	68.8	230.3	64.6	165.3	-837.9	0.7	302.1
2013	1,392.1	1,610.0	59.6	27.4	896.2	560.8	65.9	218.0	61.9	155.8	-773.3	1.2	333.2
2014	1,146.5	1,368.1	62.5	29.2	1,085.2	120.5	70.4	221.6	66.1	155.2	-730.5	1.2	315.9
2015	1,201.0	1,457.1	65.1	15.3	1,174.0	127.1	75.1	256.1	70.5	184.8	-754.0	1.1	316.4

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/03%20CBK%20Survey.xls

Tabela 3.2. Pasqyra e BQK-së - Detyrimet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Depozitat e përfshira në paranë e gjerë								Depozitat e përjashtuara nga paraja e gjerë			Kapitali dhe të tjera			Zëra tjerë (neto)
		Depozitat e transferueshme					Depozita tjera			Korpor-ata tjera jofina-nciare	Qeveria lokale		Kapitali	Profiti humbja e vitit	
			Korp. tjera financiare	Qeveria lokale	Korp. publike jofinan.	Korp. tjera financiare		Korp. tjera financiare							
2006	49.9	41.9	31.0	0.4	10.5	…	8.0	8.0	—	—	—	25.5	10.0	6.4	-1.2
2007	57.2	46.7	22.4	3.2	21.1	…	10.6	10.6	—	—	—	33.8	20.0	9.2	3.9
2008	63.9	56.7	49.9	5.3	1.5	…	7.2	7.2	—	—	—	41.4	30.0	7.5	-2.0
2009	130.8	130.8	129.7	…	1.1	…	…	…	—	—	—	44.9	30.0	3.7	-2.0
2010	45.6	45.6	43.9	…	0.0	…	…	…	—	—	—	47.9	30.0	3.0	-1.8
2011	39.5	39.5	36.8	…	0.2	…	…	…	—	—	—	54.3	30.0	5.8	-1.3
2012	51.5	51.5	49.8	…	0.0	…	…	…	—	—	—	50.4	30.0	1.8	-2.4
2013	239.0	239.0	236.6	…	0.0	…	—	—	—	—	—	50.5	30.0	0.2	-2.7
2014	53.0	53.0	39.7	…	10.9	…	—	—	—	—	—	51.0	30.0	0.6	-2.8
2015	83.4	83.4	82.3	…	0.3	…	—	—	—	—	—	51.6	30.0	0.7	-3.3

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/03%20CBK%20Survey.xls

Tabela 4.1. Pasqyra e KTD-ve - Asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto								Kërk. ndaj BQK-së	Kërk. neto ndaj qeverisë qendrore	Kërkesat ndaj sektorëve tjerë				
		Kërkesat ndaj jorez.	prej të cilave:			Minus: det. ndaj jorezidentëve	prej të cilave:					Kreditë			
			Paraja e gatshme	Depozita	Letrat me vlerë përveç aksioneve		Depozita	Kreditë					prej të cilave:		
													Korp. publike jofinan.	Korp. tjera jofinan.	Ek. familjare
2006	334.4	394.5	52.3	235.1	99.4	60.1	21.4	38.7	88.8	(2.1)	636.6	636.6	__	490.5	146.1
2007	319.9	368.5	81.5	196.0	78.9	48.6	17.9	30.7	107.5	(3.9)	892.1	892.1	0.2	691.3	200.6
2008	325.4	401.3	81.4	265.9	40.5	75.9	42.0	33.7	136.8	(1.3)	1,183.4	1,183.4	0.1	901.7	281.0
2009	443.6	583.9	89.6	387.7	97.0	140.3	65.5	74.5	233.1	(164.9)	1,289.0	1,289.0	0.3	942.9	343.5
2010	507.6	709.8	103.5	403.5	173.4	202.2	85.5	116.7	203.4	(11.6)	1,457.1	1,457.1	6.3	1,006.6	434.3
2011	509.2	665.7	111.5	300.0	202.0	156.5	64.8	90.5	220.0	(1.2)	1,665.6	1,665.6	1.5	1,130.6	516.1
2012	490.9	633.7	124.6	226.6	196.7	142.8	87.6	50.3	301.1	59.2	1,740.9	1,740.9	1.4	1,172.9	546.7
2013	573.4	748.3	130.6	247.3	254.4	174.9	90.4	82.4	331.8	99.4	1,786.0	1,786.0	0.2	1,196.7	568.6
2014	534.3	715.8	131.2	329.4	191.1	181.5	90.6	87.8	315.9	187.3	1,881.9	1,881.9	0.6	1,248.7	625.3
2015	535.7	740.0	175.5	225.2	247.2	204.3	116.0	85.9	315.7	220.7	2,019.0	2,019.0	0.6	1,324.1	685.6

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/03%20CBK%20Survey.xls

Tabela 4.2. Pasqyra e KTD-ve- Detyrimet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Depozitat e përfshira në paranë e gjerë											Dep. jasht ë paras ë së gjerë	prej të cilave:		Kapit a-li aksio -nar dhe tjera	Zëra tjerë (neto)
		Depozitat e transferueshme			prej të cilave:		Depozita tjera			prej të cilave:			Korp. tjera jofina.	Ek. familja -re		
			Korp . tjera fin- an.	Korp. publik e jofina.	Korp. tjera jofina.	Ek. famil- jare		Korp. tjera finan.	Korp. pub- like jofina.	Korp. tjera jofina.	Ek. familja -re					
2001	478.4	353.1	.	.	133.9	219.2	125.2	.	.	31.3	93.9	.	.	.	20.4	-6.4
2002	409.7	281.4	.	.	159.7	121.7	128.3	.	.	23.9	104.4	.	.	.	33.2	-6.6
2003	494.0	273.4	.	.	139.0	134.4	220.6	.	.	87.1	133.5	1.8	1.8	.	45.0	-7.0
2004	681.9	270.9	9.0	24.7	81.3	145.5	410.9	14.0	149.3	24.4	222.5	0.0	0.0	0.0	69.1	-0.1
2005	798.8	283.0	7.2	30.0	76.8	155.5	515.8	20.2	181.3	33.1	279.6	19.9	0.7	19.3	74.0	3.4
2006	862.9	294.5	4.9	24.3	96.4	156.2	568.4	22.5	193.3	24.6	322.4	40.6	3.0	37.1	103.3	50.9
2007	1,069.3	367.1	5.3	28.5	133.5	187.5	702.3	29.8	188.4	41.8	439.0	53.7	2.0	50.3	152.7	39.8
2008	1,329.0	397.9	13.8	13.8	176.0	186.2	931.1	40.4	250.1	44.2	593.8	74.9	7.3	63.0	192.3	48.1
2009	1,417.8	490.6	8.5	48.9	184.0	237.7	927.2	60.8	73.9	71.7	718.5	97.9	11.2	83.5	204.2	81.0
2010	1,702.2	628.6	9.2	83.8	218.6	303.5	1,073.6	85.2	30.2	73.5	883.7	138.2	9.9	112.2	230.4	85.7
2011	1,862.8	665.9	10.1	67.9	208.1	360.9	1,196.9	91.0	49.2	71.7	979.9	175.8	8.0	149.7	252.8	102.2
2012	1,985.3	708.0	9.6	13.8	257.5	407.2	1,277.3	100.4	49.8	70.5	1,053.1	206.2	7.8	179.8	270.7	129.8
2013	2,149.4	857.3	11.8	16.4	299.6	506.6	1,292.1	62.2	43.7	92.3	1,088.9	209.7	5.9	179.4	278.5	152.8
2014	2,234.4	1,141.7	20.4	10.2	338.4	743.5	1,092.7	67.2	39.4	50.2	930.6	208.7	7.8	174.2	323.0	153.3
2015	2,349.6	1,392.0	14.5	10.9	413.8	919.1	957.5	37.6	12.8	54.3	852.3	232.7	13.9	193.1	393.8	115.0

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/04%20Other%20Depository%20Corporations%20Survey.xls

Tabela 5.1. Pasqyra e KTF-ve – Asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Asetet e jashtme neto						Kërkesat ndaj korporatave depozituese							Kërkesat neto ndaj qeverisë qëndrore	Kërkesat ndaj sektorëve tjerë	
		Kërkesat ndaj jorezidentëve	prej të cilave:		Minus: detyrimet ndaj jorezidentëve			BQK			Korporata tjera depozituese					
			Letrat me vlerë përveç aksioneve	Kapitali aksionar dhe tjera		Kreditë			Depozitë të transferueshëm	Depozita tjera		Depozitë të transferueshëm	Depozita tjera			Kreditë
2005	132.1	146.4	__	145.3	14.3	14.3	54.8	27.4	23.3	4.1	27.4	7.2	20.2	__	60.0	51.7
2006	198.1	210.0	38.3	170.8	11.9	11.9	66.9	39.0	31.0	8.0	28.0	4.9	23.0	__	69.5	57.7
2007	244.9	278.5	100.7	175.4	33.6	33.6	72.8	32.9	22.4	10.6	39.8	6.2	33.6	__	85.4	73.8
2008	157.0	214.7	79.8	128.2	57.7	57.7	113.0	57.1	49.9	7.2	55.9	7.9	48.0	__	108.3	94.0
2009	168.6	253.8	97.9	144.3	85.1	85.1	200.0	129.7	129.7	…	70.3	7.4	62.9	__	130.8	109.4
2010	341.3	430.5	152.5	269.3	89.2	89.2	142.8	43.9	43.9	…	98.8	8.2	90.6	__	139.7	116.9
2011	464.0	545.7	3.2	533.1	81.7	81.7	138.1	27.7	27.7	…	110.4	7.3	103.1	__	128.1	102.5
2012	607.6	670.8	3.3	666.5	63.2	63.2	154.0	32.4	32.4	…	121.6	9.7	111.9	13.9	125.5	98.3
2013	593.0	655.8	3.5	651.2	62.7	62.7	313.0	213.9	213.9	…	99.1	14.6	84.5	53.1	117.5	94.4
2014	967.6	1,029.4	4.0	1,024.4	61.8	61.8	119.5	**15.7**	**15.7**	…	103.7	13.6	90.1	54.7	119.9	96.8
2015	1,028.4	1,091.1	3.9	1,086.3	62.7	62.7	163.0	55.4	55.4	...	107.3	20.6	86.8	100.5	131.4	104.2

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/05a%20Other%20Financial%20Intermediaries%20Survey.xls

Tabela 5.2. Pasqyra e KTF-ve - detyrimet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Kreditë	Rezervat teknike të sigurimit				Kapitali aksionar dhe tjera					Zëra tjerë			
			Kapitali neto i ekonom. familjare në rez. e sig. të jetës	Kapitali neto i ek. familjare në fondet pensionale	Parapag. i premive dhe rez. kundrejt kërk. kum.		Fondet e kontribuara nga pronarët	Fitimet e pashpërndara	Rezervat e përgjithshme dhe ato të veçanta	Profiti/ humbja vjetore		Detyrime tjera	Minus: asete tjera	Plus: përshtatja e konsolidimit
2004	2.3	106.5	…	88.7	17.9	58.0	42.6	8.6	5.0	1.7	1.7	9.3	7.6	__
2005	3.0	174.5	__	152.4	22.1	71.4	47.7	12.9	6.7	4.0	-2.1	4.4	6.5	__
2006	3.4	251.4	__	223.9	27.5	80.5	55.2	15.8	7.9	1.6	-0.7	7.4	8.2	__
2007	…	316.1	__	286.2	29.9	87.4	62.1	20.1	1.7	3.5	-0.4	9.6	10.0	__
2008	1.0	288.6	__	256.3	32.3	77.4	54.0	12.7	7.4	3.4	11.3	24.2	12.9	__
2009	2.9	422.3	…	380.8	41.5	77.0	53.4	19.4	7.2	-3.1	-2.7	13.1	15.8	__
2010	2.9	540.5	…	493.7	46.8	82.5	59.7	13.6	7.2	2.0	-2.1	20.9	23.1	__
2011	3.3	647.8	…	593.3	54.5	85.4	60.4	13.3	10.8	0.9	-6.3	16.1	22.4	__
2012	7.2	814.9	…	745.1	69.8	78.1	63.5	9.8	10.7	-6.4	0.7	29.0	28.4	__
2013	6.8	990.3	…	919.0	71.3	75.6	64.2	1.3	11.1	-1.0	3.9	29.8	25.9	__
2014	3.2	1,173.8	…	1,094.1	79.7	78.5	64.3	-0.5	14.4	0.3	6.1	30.9	24.8	__
2015	1.0	1,329.5	…	1,237.3	92.1	86.2	76.9	0.6	14.0	-5.3	6.4	31.2	24.8	__

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/05a%20Other%20Financial%20Intermediaries%20Survey.xls

Tabela 6.1. Depozitat në euro në KTD-të – Sipas maturitetit fillestar, sektorët kryesorë

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Gjithsej depozita në euro	Qeveria	Korporatat financiare						Korporatat jofinanciare			Sektorë tjerë vendor			Jorezidentë
				Korporatat tjera depozituese	Ndërmjetësit tjerë financiarë	Kompanitë e sigurimit	Fondet pensionale	Ndihm. financiar		Korporatat publike jofinanciare	Korporatat tjera jofinananciare		Ekonomitë familjare	OJSHEF	
2001	492.3	__	__	__	__	__	.	__	165.2	__	165.2	313.1	313.1	__	13.9
2002	427.2	__	__	__	__	__	.	__	183.6	__	183.6	226.1	226.1	__	17.5
2003	515.8	__	1.8	1.8	__	__	.	__	226.1	__	226.1	267.9	267.9	__	20.0
2004	674.9	1.3	25.6	3.7	3.5	15.5	.	2.9	275.3	173.5	101.8	360.3	350.7	9.6	12.3
2005	815.3	2.9	35.4	8.1	5.8	18.8	.	2.8	319.0	211.3	107.7	440.7	428.7	12.0	17.3
2006	890.4	7.0	28.1	0.1	2.4	24.7	0.4	0.5	337.8	217.4	120.5	499.2	486.1	13.1	18.2
2007	1,092.0	4.1	39.1	3.1	5.6	28.3	0.4	1.7	386.2	215.5	170.7	647.0	631.9	15.2	15.6
2008	1,366.9	1.4	62.9	5.0	6.5	31.5	19.4	0.4	479.7	263.8	215.9	785.0	774.5	10.5	37.9
2009	1,640.1	165.0	78.2	6.1	5.9	43.1	22.6	0.4	371.5	121.6	249.9	962.2	948.8	13.4	63.2
2010	1,831.1	11.7	105.0	7.3	7.9	47.6	41.6	0.6	414.9	122.3	292.6	1,220.1	1,206.1	14.0	79.4
2011	1,982.4	2.7	117.5	9.9	6.8	57.2	43.1	0.5	406.6	128.5	278.1	1,395.6	1,373.4	22.2	60.0
2012	2,162.8	0.7	120.0	3.8	6.2	64.3	45.3	0.4	401.7	75.6	326.1	1,558.6	1,535.4	23.2	81.7
2013	2,314.1	1.8	88.2	2.5	7.4	72.3	5.7	0.3	455.6	72.1	383.5	1,685.1	1,658.7	26.4	83.4
2014	2,426.6	8.8	104.4	2.6	5.1	79.3	17.1	0.3	449.7	61.8	388.0	1,781.6	1,751.1	30.6	82.1
2015	2,580.0	5.9	73.3	3.3	5.1	59.0	4.9	1.1	499.9	31.5	468.5	1,895.5	1,862.3	33.2	105.3

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/08%20Deposits%20at%20ODC%20-%20deposits%20in%20euro.xls

Tabela 6.2. Depozitat në KTD-të - depozitat në joeuro

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Depozita në jo euro															Jorezidentë
		Korporatat financiare	prej të cilave:				Korporatat jofinanciar	prej të cilave:		Sektorë tjerë vendor						
			BQK	Korp. tjera depozitu ese	Ndërm. tjerë financi ar	Komp -anitë e sigu- rimit		Korp. publik e jofina n.	Korp. tjera jofina n.		Ekonomitë familjare	prej te cilave:			OJSHEF	
												Depozitat e transferue shme	Depo- zitat e kursi- mit	Dep- oziita tjera		
2005	29.4	…	__	…	…	…	2.8	__	2.8	26.0	25.7	10.8	__	14.9	0.3	0.5
2006	34.3	…	__	…	…	…	3.7	0.3	3.5	29.8	29.6	12.4	__	17.2	0.2	0.5
2007	53.3	0.5	__	…	0.1	0.4	8.1	1.5	6.6	44.3	44.2	16.2	__	28.0	0.1	0.4
2008	81.9	0.9	__	…	…	0.9	11.6	0.1	11.5	68.4	68.2	22.9	__	45.2	0.3	1.0
2009	112.1	2.1	__	1.2	…	0.9	18.3	1.3	17.0	91.1	90.9	29.7	__	61.1	0.2	0.7
2010	113.8	3.1	__	2.9	__	__	13.7	4.3	9.4	93.8	93.3	33.1	25.9	34.3	0.5	3.1
2011	131.5	0.3	__	0.3	__	__	9.8	0.1	9.7	117.5	117.0	46.5	31.7	38.9	0.4	3.8
2012	120.9	1.6	__	1.2	0.2	__	9.6	__	9.6	104.9	104.7	45.7	27.0	32.0	0.2	4.8
2013	136.9	0.7	__	__	0.4	__	14.3	__	14.3	116.7	116.2	59.6	29.6	27.0	0.5	5.2
2014	113	0.27	…	…	0.2	__	8.49	__	8.49	97.8	97.3	63.2	21.5	12.6	0.6	6.49
2015	124.5	0.2	__	0.2	…	__	13.5	__	13.5	102.8	102.2	76.6	19.3	6.2	0.6	7.8

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/09%20Deposits%20at%20ODC%20-%20deposits%20in%20non-euro.xls

Tabela 6.3. Kreditë e KTD-ve – sektorët kryesor institucional

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Gjithsej kreditë	Korporatat financiare	prej të cilave:		Korporatat jofinanciare	prej të cilave:				Korporatat tjera vendore	prej të cilave:				Jo rezidentë	Kreditë në valutën jo euro
			Ndërmj. tjerë financiar	Komp. e sigurimit		Korp. publike jofinan.	Korporatat tjera jofinanciare				Ek. familjare					
								Deri në 1 vit	Mbi 1 vit dhe deri në 2 vite	Mbi 2 vite		Deri në 1 vit	Mbi 1 vit dhe deri në 2 vite	Mbi 2 vite		
2001	25.9	__	__	__	25.9	__	25.9	24.6	1.3	__	__	__	__	__	__	__
2002	86.5	__	__	__	80.8	__	80.8	67.3	13.5	__	5.7	5.7	1.4	4.3	__	__
2003	232.8	__	__	__	193.7	0.2	193.5	124.7	68.7	0.2	39.0	39.0	11.4	16.0	11.6	__
2004	373.7	__	__	__	289.9	…	289.9	111.5	111.3	67.2	83.7	83.7	15.9	15.2	52.6	__
2005	513.9	__	__	__	387.9	…	387.9	117.9	125.2	144.7	126.0	126.0	19.5	21.0	85.4	__
2006	636.6	__	__	__	490.5	…	490.5	128.7	127.7	234.1	146.1	146.1	19.7	24.7	101.7	__
2007	892.1	__	__	__	691.5	0.2	691.3	174.0	122.6	394.6	200.6	200.6	24.0	29.6	147.1	__
2008	1,183.4	0.6	__	0.6	901.8	0.1	901.7	191.0	132.3	578.4	281.0	281.0	20.9	30.9	229.2	__
2009	1,289.0	2.3	1.2	1.1	943.2	0.3	942.9	215.7	113.0	614.2	343.5	343.5	27.0	32.1	284.5	__
2010	1,458.7	5.7	2.6	3.0	1,014.5	6.3	1,008.3	259.4	64.3	684.5	434.3	434.2	26.5	30.7	377.0	1.6
2011	1,698.1	17.3	15.6	1.7	1,128.6	1.5	1,127.0	298.8	83.4	744.8	512.4	510.9	44.0	38.1	428.8	32.5
2012	1,763.4	19.8	16.3	3.5	1,171.2	1.4	1,169.8	313.4	91.7	764.8	543.0	542.6	52.2	37.3	453.0	22.5
2013	1,805.8	20.4	17.3	3.1	1,194.7	0.2	1,194.5	378.0	97.4	719.1	564.7	563.9	65.4	41.1	457.3	19.9
2014	1,881.9	7.1	5.8	1.3	1,247.0	0.6	1,246.4	380.7	93.6	772.1	621.8	621.6	55.9	42.6	523.1	0.5
2015	2,019.0	8.7	7.4	1.1	1,322.2	0.6	1,321.6	306.9	150.5	864.2	682.2	682.0	58.2	623.8	584.6	0.4

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/12%20ODC%20loans%20-%20by%20economic%20sectors.xls

Tabela 6.4. Kreditë e KTD-ve-sektorët kryesor ekonomik

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Gjithsej	Bujqësia			Industria, energjia dhe ndërtimi			Shërbimet		
			Deri në 1 vit	Mbi 1 vit		Deri në 1 vit	Mbi 1 vit		Deri në 1 vit	Mbi 1 vit
2001	25.9	…	…	—	3.8	3.8	…	22.2	22.2	…
2002	86.5	1.5	1.5	—	13.6	13.6	…	71.4	71.4	…
2003	232.8	4.7	3.9	0.8	22.2	12.6	9.7	205.8	119.7	86.1
2004	289.9	7.9	3.9	4.1	47.8	22.5	25.3	234.2	89.5	144.8
2005	387.9	12.5	4.1	8.4	74.2	24.5	49.7	301.1	92.4	208.8
2006	490.5	16.4	3.4	13.0	97.7	28.0	69.7	376.4	120.6	255.8
2007	691.5	29.0	4.1	24.9	144.5	32.8	111.7	518.0	149.5	368.5
2008	902.4	37.4	4.1	33.3	160.2	28.9	131.2	704.8	126.4	578.4
2009	945.5	38.2	3.8	34.4	236.7	54.8	181.9	670.5	113.2	557.3
2010	1,022.8	38.2	1.7	36.5	269.3	77.1	192.2	715.3	188.5	526.8
2011	1,149.5	40.5	2.7	37.8	284.7	82.3	202.4	824.4	220.5	603.8
2012	1,194.2	43.6	3.0	40.6	290.4	74.1	216.2	860.2	232.3	627.9
2013	1,217.4	45.8	3.3	42.5	291.4	95.8	195.6	880.2	286.2	594.0
2014	1,256.4	49.8	4.1	45.7	300.0	19.7	154.4	167.2	906.6	288.8
2015	1,333.4	59.9	4.6	55.3	300.6	76.0	205.4	972.9	220.8	652.6

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/12%20ODC%20loans%20-%20by%20economic%20sectors.xls

Tabela 6.5. Norma efektive e interesit në depozita të KTD-ve

(Mesatarja vjetore e normës së interesit në depozita, në përqindje)

Përshkrimi	Norma mesatare vjetore e interesit në depozita të reja të afatizuara							Depozitat e transferueshme	Depozitat e kursimit
		Deri në 1 muaj	Mbi 1 muaj deri në 3 muaj	Mbi 3 muaj deri në 6 muaj	Mbi 6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit deri në 2 vite	Mbi 2 vite		
	KORPORATAT JO-FINANCIARE DHE EKONOMITË FAMILJARE								
2004	2.8	1.7	2.2	3.8	2.9	1.9	2.0	0.1	1.6
2005	2.9	1.8	2.2	3.6	3.0	2.1	2.1	0.1	1.7
2006	3.0	2.0	2.4	3.8	3.4	2.9	2.4	0.1	1.7
2007	3.3	2.4	2.8	4.2	3.5	2.3	2.7	0.2	1.9
2008	4.2	3.1	3.7	5.2	4.3	3.2	3.0	0.3	2.5
2009	4.3	3.3	3.7	5.6	4.7	2.4	3.2	0.5	2.8
2010	3.7	2.8	3.0	2.7	4.8	2.3	3.9	0.6	2.3
2011	3.5	2.4	2.8	3.0	4.5	3.6	3.2	0.7	2.1
2012	3.6	2.3	3.2	3.0	4.3	4.5	5.2	0.7	2.0
2013	3.4	2.0	2.7	2.7	3.7	4.4	4.8	0.6	1.7
2014	1.1	0.5	0.6	0.5	1.2	1.4	1.9	0.1	0.7
2015	0.9	0.4	0.8	0.4	0.7	1.0	1.9	0.0	0.3
2016	0.9	0.4	0.6	0.5	0.9	1.0	2.0	0.0	0.3
	Korporatat jo-financiare								
2004	.	1.8	2.3	3.8	2.9	...	...	0.1	1.6
2005	.	1.9	2.2	3.6	3.0	3.7	...	0.1	1.7
2006	.	2.1	2.5	3.8	3.7	4.6	5.8	0.4	1.6
2007	.	2.6	3.0	4.2	3.6	4.4	4.6	0.5	1.9
2008	.	3.3	3.9	5.2	4.4	5.0	5.2	0.5	2.7
2009	.	3.3	3.9	5.6	5.0	...	5.7	0.8	2.9
2010	.	2.9	3.1	3.8	5.1	...	5.2	1.1	2.4
2011	.	2.3	3.4	3.3	4.9	5.3	5.2	1.0	2.2
2012	3.5	2.1	3.8	3.7	5.0	4.9	5.3	0.9	2.1
2013	3.5	1.5	2.8	2.7	3.7	4.6	4.8	0.7	2.0
2014	1.3	0.6	0.8	0.5	1.4	1.2	1.9	0.2	0.8
2015	1.1	0.7	1.0	0.3	1.0	1.0	1.9	0.1	0.1
2016	1.3	0.5	0.5	...	1.4	1.0	1.3	0.1	0.1
	Ekonomitë familjare								
2004	.	1.6	2.1	...	2.8	3.8	4.0	…	1.7
2005	.	1.7	2.2	...	3.0	3.9	4.1	…	1.7
2006	.	1.9	2.3	...	3.2	4.2	4.4	…	1.7
2007	.	2.1	2.5	...	3.3	4.3	4.6	…	2.0
2008	.	2.9	3.4	...	4.2	4.7	5.1	0.1	2.4
2009	.	3.2	3.5	...	4.4	4.8	5.4	0.2	2.6
2010	.	2.8	2.9	3.4	4.4	4.6	5.3	0.3	2.3
2011	.	2.5	2.6	2.9	4.2	4.5	5.1	0.4	2.1
2012	3.6	2.4	2.5	2.8	4.2	4.5	5.2	0.5	2.0
2013	3.5	2.1	2.3	2.6	3.7	4.3	4.8	0.6	1.6
2014	1.1	0.5	0.6	0.4	1.0	1.3	1.9	0.1	0.7
2015	0.9	0.4	0.6	0.4	0.7	0.9	1.9	…	0.3
2016	0.9	0.4	0.6	0.5	0.7	1.0	2.1	…	0.3

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/13a%20ODC%20effective%20interest%20rates%20on%20deposits.xls

Tabela 6.6. Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve

(Mesatarja vjetore e normës së interesit për kredi, në përqindje)

	Norma mesatare vjetore e interesit në kredi të reja									Mbitërheqjet	Linjat kreditore
		Kreditë konsumuse	Kreditë hipotekare	Kreditë me kushte favorizuse	Kreditë e tjera (të ndara sipas sektorëve ekonomik)	Bujqësore	Industriale	Shërbyese	Sektorët tjerë		
	KORPORATAT JO-FINANCIARE DHE EKONOMITË FAMILJARE										
2004	15.0	12.8	.	.	.	.	.	.	.	.	.
2005	14.9	12.4	.	.	.	.	.	.	.	.	.
2006	14.7	12.5	13.1	.	.	.	.	.	.	.	.
2007	14.6	13.0	12.6	.	.	.	.	.	.	.	.
2008	14.7	14.1	11.7	.	.	.	.	.	.	.	.
2009	14.3	13.1	10.6	.	.	.	.	.	.	.	.
2010	14.4	13.9	11.8	6.6	.	.	.	.	.	.	.
2011	13.8	13.9	11.5	7.9	14.5	23.7	13.9	13.9	16.1	12.0	13.2
2012	12.7	12.4	10.6	7.4	13.2	20.6	12.5	13.2	16.0	10.7	11.6
2013	11.8	11.6	10.1	7.6	12.3	17.4	12.3	11.9	13.7	9.3	11.4
2014	10.6	10.9	9.1	4.6	10.6	13.2	10.4	10.7	10.9	9.5	11.3
2015	8.3	9.0	7.4	4.7	8.2	9.8	8.0	8.1	8.9	8.2	9.5
2016	7.8	8.6	7.0	4.8	7.4	9.8	7.1	7.5	7.2	7.4	8.7
	Korporatat jo-financiare										
2004	.	.	.	.	.	.	.	.	.	15.3	12.8
2005	.	.	.	.	.	.	.	.	.	15.3	12.4
2006	.	.	.	.	.	.	.	.	.	15.4	12.5
2007	.	.	.	.	.	.	.	.	.	14.8	13.0
2008	.	.	.	.	.	.	.	.	.	13.9	14.1
2009	.	.	.	.	.	.	.	.	.	14.6	14.6
2010	.	.	.	.	.	.	.	.	.	12.5	14.0
2011	14.4	.	.	7.6	14.4	24.2	13.9	13.9	16.1	11.8	13.2
2012	13.2	.	.	7.5	13.2	21.1	12.5	13.2	16.0	10.5	11.6
2013	12.3	.	.	7.0	12.3	17.6	12.3	11.9	13.7	9.1	11.4
2014	10.6	.	.	5.5	10.6	13.2	10.4	10.7	10.9	9.3	11.3
2015	8.1	.	.	2.9	8.1	9.3	8.0	8.1	8.9	7.9	9.5
2016	7.3	.	.	2.4	7.3	8.7	7.1	7.5	7.2	7.1	8.7
	Ekonomitë familjare										
2004	.	12.8	.	.	.	.	—	—	—	.	—
2005	.	12.4	.	.	.	.	—	—	—	.	—
2006	.	12.5	13.1	.	.	.	—	—	—	.	—
2007	.	13.0	12.6	.	.	.	—	—	—	.	—
2008	.	14.1	11.7	.	.	.	—	—	—	19.2	—
2009	.	13.1	10.6	.	.	.	—	—	—	17.7	—
2010	.	13.9	11.8	.	.	.	—	—	—	.	—
2011	13.4	13.9	11.5	8.2	22.4	22.4	—	—	—	17.5	—
2012	12.2	12.4	10.6	7.0	19.8	19.8	—	—	—	15.2	—
2013	11.3	11.6	10.1	6.8	16.4	16.4	—	—	—	14.6	—
2014	10.6	10.9	9.1	3.9	15.4	15.4	—	—	—	13.6	—
2015	8.7	9.0	7.4	5.1	13.3	13.3	—	—	—	13.1	—
2016	8.3	8.6	7.0	5.1	11.9	11.9	—	—	—	13.2	—

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/13%20ODC%20effective%20interest%20rates%20on%20loans.xls

Tabela 7.1 Bilanci i Pagesave të Kosovës - komponentët kryesor

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Bilanci nga llogaria rrjedhese dhe kapitale							Bilanci nga llogaria financiare					Gabimet dhe harresat
		Llogaria rrjedhëse					Llogaria kapitale		Investimet direkte	Investimet portofolio	Investimet tjera	Asetet reservë	
			Mallrat	Shërbimet	Të ardhurat parësore	Të ardhurat dytësore							
2005	-228.7	-247.6	-1,078.5	-8.5	139.1	700.3	18.9	53.8	107.6	-17.5	-68.7	32.4	174.8
2006	-205.2	-226.1	-1,173.1	29.0	158.8	759.2	20.8	-35.7	289.2	-65.4	-181.7	-77.9	240.9
2007	-197.5	-214.0	-1,354.4	112.0	186.3	842.0	16.5	5.8	-431.0	34.5	108.0	294.3	203.3
2008	-450.5	-460.9	-1,644.7	146.6	164.0	873.2	10.5	-288.4	-341.5	109.9	-75.1	18.2	162.1
2009	-273.9	-374.2	-1,646.3	227.8	60.9	983.4	100.3	-113.1	-280.9	124.8	137.8	-94.8	160.9
2010	-494.4	-515.7	-1,741.6	176.4	67.0	982.5	21.3	-275.8	-331.1	48.6	-46.7	53.4	218.5
2011	-616.4	-658.4	-2,047.1	256.3	111.3	1,021.1	42.0	-377.5	-378.9	57.8	4.8	-61.2	238.9
2012	-367.2	-380.2	-2,050.1	323.8	153.6	1,192.5	12.9	-141.0	-213.3	185.7	-374.9	261.4	226.2
2013	-304.7	-339.4	-1,995.6	312.2	121.5	1,222.4	34.7	-132.2	-250.2	139.3	14.4	-35.7	172.5
2014	-415.8	-437.0	-2,058.6	335.9	113.8	1,171.9	21.2	-145.0	-123.8	13.3	22.6	-57.0	270.8
2015	-501.8	-527.7	-2109.3	354.4	78.0	1149.3	25.8	-255.0	-287.3	48.8	-128.2	111.8	246.9

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/26%20Balance%20of%20payments%20-%20main%20components.xls

7.2. Llogaria rrjedhëse

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Bilanci					Kredi					Debi				
		Mallrat	Shërbimet	Të ardhurat parësore	Të ardhurat dytësore		Mallrat	Shërbimet	Të ardhurat parësore	Të ardhurat dytësore		Mallrat	Shërbimet	Të ardhurat parësore	Të ardhurat dytësore
2005	-247.6	-1,078.5	-8.5	139.1	700.3	1,356.5	67.8	265.0	164.7	859.0	-1,604.1	-1,146.3	-273.5	-25.6	-158.7
2006	-226.1	-1,173.1	29.0	158.8	759.2	1,514.3	122.5	319.0	187.7	885.1	-1,740.4	-1,295.6	-289.9	-28.9	-125.9
2007	-214.0	-1,354.4	112.0	186.3	842.0	1,720.9	164.1	382.5	239.2	935.2	1,935.0	1,518.5	270.4	52.9	93.1
2008	-460.9	-1,644.7	146.6	164.0	873.2	1,813.7	211.3	396.9	233.3	972.3	2,274.7	1,856.0	250.3	69.3	99.1
2009	-374.2	-1,646.3	227.8	60.9	983.4	1,982.4	172.5	521.5	181.7	1,106.8	2,356.6	1,818.8	293.7	120.7	123.4
2010	-515.7	-1,741.6	176.4	67.0	982.5	2,147.2	299.2	574.3	186.3	1,087.4	2,662.9	2,040.8	397.8	119.2	105.0
2011	-658.4	-2,047.1	256.3	111.3	1,021.1	2,314.4	316.5	625.2	239.1	1,133.6	2,972.8	2,363.7	368.9	127.8	112.5
2012	-380.2	-2,050.1	323.8	153.6	1,192.5	2,449.4	281.9	641.0	230.0	1,296.4	2,829.6	2,332.0	317.2	76.4	103.9
2013	-339.4	-1,995.6	312.2	121.5	1,222.4	2,455.5	291.5	632.5	227.5	1,304.0	2,794.9	2,287.0	320.3	106.0	81.6
2014	-437.0	-2,058.6	335.9	113.8	1,171.9	2,577.6	324.3	767.2	215.8	1,270.3	3,014.6	2,382.9	431.3	102.0	98.4
2015	-527.7	-2,109.3	354.4	78.0	205.7	-126.7	-1.0	1149.3	202.9	946.4	2560.0	322.5	796.4	221.7	210.3

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/26a%20Current%20account.xls

7.3.1 Të ardhurat parësore

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Bilanci				Kredi				Debi			
		Kompenzimi i punëtorve	Të ardhurat nga investimet	Të ardhurat tjera parësore		Kompenzimi i punëtorve	Të ardhurat nga investimet	Të ardhurat tjera parësore		Kompenzimi i punëtorve	Të ardhurat nga investimet	Të ardhurat tjera parësore
2005	139.1	145.2	-6.1	…	170.5	145.9	24.5	…	31.4	0.7	30.7	…
2006	158.8	146.5	12.2	…	187.8	147.3	40.5	…	29.0	0.7	28.3	…
2007	186.3	154.9	31.5	…	239.2	155.6	83.6	…	52.9	0.8	52.2	…
2008	164.0	175.4	-11.4	…	233.3	176.2	57.1	…	69.3	0.8	68.5	…
2009	60.9	168.7	-107.8	…	181.7	169.7	12.0	…	120.7	0.9	119.8	…
2010	67.0	171.6	-104.6	…	186.3	176.1	10.1	…	119.2	4.5	114.7	…
2011	111.3	208.2	-96.9	…	239.1	221.3	17.8	…	127.8	13.1	114.7	…
2012	153.6	214.3	-60.6	…	230.0	219.9	10.1	…	76.4	5.6	70.8	…
2013	121.5	218.9	-97.4	…	227.5	223.2	4.3	…	106.0	4.3	101.6	…
2014	113.8	200.4	-85.9	-0.7	215.8	206.5	8.0	1.3	102.0	6.1	93.9	2.0
2015	78.0	205.7	-126.7	-1.0	221.7	210.3	9.6	1.8	143.7	4.6	136.3	2.8

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/28%20Primary%20Income.xls

7.3.2 Të ardhurat dytësore

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Të ardhurat dytësore			Kredi			Debi		
		Qeveria	Korporatat financiare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të		Qeveria	Korporatat financiare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të		Qeveria	Korporatat financiare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare, dhe OJSHEF-të
2005	700.3	347.9	352.4	859.0	354.1	504.9	158.7	6.2	152.4
2006	759.3	319.9	439.4	885.1	327.4	557.7	125.9	7.5	118.4
2007	842.0	245.1	596.9	935.2	251.4	683.8	93.1	6.3	86.8
2008	873.2	223.5	649.7	972.3	223.5	748.8	99.1	…	99.1
2009	983.4	322.9	660.5	1,106.8	322.9	783.9	123.4	…	123.4
2010	982.5	319.5	662.9	1,087.4	319.5	767.9	105.0	…	105.0
2011	1,021.1	322.2	698.9	1,133.6	322.2	811.4	112.5	…	112.5
2012	1,192.5	401.6	791.0	1,296.4	401.6	894.9	103.9	…	103.9
2013	1,222.4	341.9	880.5	1,304.0	341.9	962.0	81.6	…	81.6
2014	1,171.9	291.9	880.0	1,270.3	291.9	978.4	98.4	…	98.4
2015	1,149.3	202.9	946.4	1,219.5	202.9	1,016.5	70.2	-	70.2

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/29%20Secondary%20Income.xls

7.4 Dërgesat e migrantëve - Sipas shteteve

(Në përqindje)

Përshkrimi	Gjermania	Zvicra	Italia	Austria	Belgjika	SHBA	Suedia	Franca	Norvegjia	Kanada	Anglia	Danima.	Finlanda	Holanda	Sllovenia	Të tjera
2008	37.7	15.9	13.1	6.2	2.8	2.8	3.7	3.9	1.9	2.2	1.5	1.9	1.1	1.2	1.4	2.6
2009 T1	34.9	21.4	10.5	5.3	3.7	3.5	3.3	3.4	2.6	1.7	1.6	1.0	1.1	1.1	1.0	4.2
T2	39.4	19.7	11.3	6.1	2.9	2.6	2.9	4.0	2.4	1.8	1.3	0.9	0.9	1.3	1.4	1.5
T3	37.4	21.2	9.8	6.0	2.8	2.6	3.5	3.8	2.8	2.1	1.3	0.9	1.1	1.0	1.5	2.2
T4	38.1	22.0	9.8	5.5	2.8	2.3	3.2	3.9	3.2	1.9	1.3	0.8	1.1	1.2	1.3	1.7
2010 T1	34.8	21.0	8.8	5.7	2.6	3.9	3.1	3.5	2.8	1.3	1.5	0.9	1.1	1.2	3.4	4.4
T2	34.7	20.7	7.9	3.9	2.9	4.7	3.1	3.6	3.1	2.0	1.7	0.7	0.7	1.0	3.7	5.9
T3	33.2	21.4	7.0	6.5	2.5	4.8	3.4	4.0	2.5	2.3	1.6	0.6	0.9	1.0	5.6	2.7
T4	34.1	21.6	7.2	5.5	2.9	3.1	3.7	4.1	2.6	1.9	1.3	0.6	0.7	1.0	4.5	5.3
2011 T1	32.7	23.7	7.5	5.6	2.8	4.6	3.9	3.8	2.8	1.5	1.5	0.7	0.8	1.2	3.9	3.0
T2	32.8	23.0	7.0	5.5	2.0	4.0	3.1	3.7	2.8	2.1	1.3	0.9	1.0	1.0	3.9	6.1
T3	33.8	23.4	6.2	5.5	2.9	2.3	3.6	4.2	2.6	2.0	1.2	0.6	0.8	1.0	3.3	6.7
T4	33.7	22.1	7.4	5.5	2.7	3.9	3.4	3.8	2.8	1.9	1.4	0.7	0.9	1.1	4.0	4.9
2012 T1	30.9	23.7	4.8	6.0	1.1	6.3	3.6	2.8	4.9	0.7	3.2	0.8	0.7	0.5	5.0	5.0
T2	37.4	26.3	8.4	6.4	6.6	3.9	0.8	0.4	1.3	0.1	1.9	0.1	0.1	0.1	5.4	0.8
T3	34.6	22.6	7.9	5.9	3.2	3.9	3.1	3.2	2.8	1.5	1.8	0.7	0.8	0.8	3.6	3.7
T4	34.5	21.0	8.5	6.2	2.6	3.8	3.3	3.3	2.3	1.9	1.8	0.5	0.8	…	3.7	5.9
2013 T1	33.6	22.5	7.5	5.8	2.7	4.2	3.4	3.5	3.0	1.6	1.8	0.7	0.9	1.0	3.7	4.3
T2	33.3	25.5	5.9	5.7	2.5	4.6	2.5	1.4	2.3	1.3	4.0	0.8	0.9	1.0	5.3	3.1
T3	33.6	24.4	6.6	7.8	2.5	4.3	3.5	4.5	2.3	0.4	1.9	0.7	0.8	0.9	4.9	1.1
T4	35.3	22.7	10.6	4.6	1.6	4.4	2.1	5.0	2.7	1.8	1.7	0.5	0.6	1.5	0.5	4.2
2014 T1	36.7	21.4	5.9	3.8	2.3	6.0	3.1	4.1	2.3	1.5	3.1	0.4	0.6	1.1	0.8	7.0
T2	36.6	23.7	5.4	4.5	2.1	6.4	2.7	3.2	2.4	1.3	3.3	0.4	0.6	0.6	1.5	5.6
T3	35.5	23.9	4.6	3.6	2.1	6.5	3.4	3.5	2.6	1.9	3.0	0.5	0.7	0.7	1.1	6.5
T4	36.8	21.1	3.8	3.1	4.0	6.1	2.4	2.4	5.5	0.7	3.1	1.0	0.3	0.1	2.2	7.3
2015 T1	35.2	21.8	5.0	3.9	3.3	8.1	2.9	3.6	3.1	1.6	1.6	0.4	0.7	0.9	0.8	7.2
T2	36.9	21.6	3.6	3.5	2.3	8.2	2.5	1.6	4.0	3.5	3.7	0.2	0.6	0.7	0.5	6.6
T3	35.9	23.8	5.6	3.4	2.1	7.4	3.2	3.7	2.1	1.5	3.3	0.3	0.6	0.6	0.7	5.8
T4	38.8	22.2	5.1	3.3	2.2	8.4	2.9	3.3	1.8	1.5	3.0	0.4	0.6	0.7	1.3	4.4

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/32%20Remittances-by%20country.xls

8.1. Investimet direkte – sipas kriterit gjeografik

(Në milionë euro: Gjendja më 31 dhjetor 2015)

Shteti		Gjithsej Investimet Direkte hyrëse			Gjithsej Investimet Direkte dalëse		
			Ekuiteti	Transaksionet kapitale tjera		Ekuiteti	Transaksione kapitale tjera
Bashkimi Evropian		1,101.6	834.6	267.0	84.8	73.4	11.4
AT	Austria	183.4	152.3	31.1	4.1	3.8	0.3
BE	Belgjika	16.1	12.8	3.3	2.8	2.8	…
BG	Bullgaria	33.2	4.6	28.6	0.6	0.6	…
CY	Qipro	6.8	2.0	4.8	3.7	3.7	…
FR	Franca	17.0	17.1	0.0	3.4	3.4	…
DE	Gjermania	299.5	284.3	15.2	26.4	26.4	…
GR	Greqia	9.3	8.6	0.7	1.9	1.9	…
IT	Italia	22.6	22.5	0.1	3.9	3.9	…
NL	Holanda	162.6	124.1	38.5	15.2	4.1	11.1
RO	Rumania	4.0	3.9	0.1	0.3	0.3	…
SI	Sllovenia	222.3	92.8	129.5	8.7	8.7	…
SE	Suedia	26.1	25.8	0.3	1.7	1.7	…
GB	Britania e Madhe	64.5	52.5	12.0	7.5	7.5	…
	Vende tjera të BE-së	34.0	31.1	2.9	4.5	4.5	…
Vende Tjera Evropiane		815.3	599.5	215.7	108.7	107.3	1.4
AL	Shqipëria	142.3	86.2	56.1	46.8	46.0	0.8
HR	Kroacia	11.2	9.5	1.7	4.0	4.0	…
MK	Maqedonia	22.7	12.9	9.8	18.9	18.7	0.3
NO	Norvegjia	18.9	17.7	1.2	0.6	0.6	…
RS	Serbia	15.1	11.0	4.0	6.7	6.7	…
CH	Zvicra	239.5	224.4	15.1	12.8	12.5	0.3
TR	Turqia	351.4	225.4	126.0	4.6	4.6	0.0
	Vende Tjera Europiane	14.3	12.5	1.8	14.3	14.3	…
Vende Tjera		154.7	122.5	32.3	18.0	17.8	0.2
US	Shtetet e Bashkuara	89.0	65.0	24.0	9.8	9.6	0.2
AE	Emiratet e Bashkuara Arabe	38.9	33.7	5.1	1.5	1.5	…
	Vende Tjera	26.9	23.7	3.2	6.7	6.7	…
Vende tjera (jo të alokuar)		1,198.5	935.7	262.8	…	...	…
ZZ	Jo të specifikuara'	1,198.5	935.7	262.8	…	…	…
Gjithsej		3,270.1	2,492.3	777.8	211.5	198.6	13.0

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34a%20Direct%20investment%20in%20Kosovo%20by%20geographical%20breakdown.xls

9.1. Asetet në formë të investimeve portfolio sipas shteteve

(Në milionë euro: Gjendja më 31 dhjetor 2015)

Përshkrimi	Vendi	Ekuitet	Gjithsej letrat me vlerë të borxhit			Gjithsej
				Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë	Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë	
AT	Austria	-	24.0	-	24.0	24.0
BE	Belgjika	-	0.1	-	0.1	0.1
DE	Gjermania	0.2	73.5	-	73.5	73.7
FI	Finlanda	-	22.1	-	22.1	22.1
FR	Franca	35.2	16.0	-	16.0	51.3
GB	Britani e Madhe	-	0.1	0.1	-	0.1
IE	Irlanda	578.1	0.2	0.2	-	578.4
IT	Italia	-	25.7	-	25.7	25.7
LU	Luksemburgu	471.6	38.4	0.1	38.3	510.0
NL	Holanda	-	41.3	0.1	41.2	41.3
PL	Polonia	-	7.9	-	7.9	7.9
PT	Portugalia	-	0.1	0.1	-	0.1
SE	Suedia	-	15.2	0.2	15.1	15.2
SI	Sllovenia	-	2.0	1.0	1.0	2.0
US	Shtetet e Bashkuara	0.7	26.6	0.5	26.1	27.3
HU	Hungaria	-	0.1	0.1	-	0.1
GR	Greqia	-	0.0	0.0	-	0.0
TR	Turqia	-	0.1	0.1	-	0.1
LV	Letoni	-	0.1	0.1	-	0.1
CZ	Republika Çeke	-	0.1	0.1	-	0.1
RO	Romania	-	0.2	0.2	-	0.2
AE	Emiratet Arabe	-	0.1	0.1	-	0.1
BR	Brazili	-	0.2	0.2	-	0.2
BG	Bullgaria	-	8.2	0.1	8.1	8.2
Gjithsej vlera e investimeve portfolio		**1,085.9**	**302.3**	**3.3**	**299.1**	**1,388.2**

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34f%20Portfolio%20Investments%20Position.xls

10.1. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare – komponentët kryesor

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Neto	Asetet										
			Investimet direkte jashtë vendit	Investimet portfolio			Investimet tjera					Asetet rezervë
					Kapital dhe në aksione të fondeve investive	Instrumentet e borxhit		Banka Qendrore	Qeveria	Korporatat depozituese, me përjashtim të Bankës Qendrore	Sektorët tjerë	
2007	1,254.2	2,397.2	15.2	444.4	158.9	285.5	1,285.6	317.7	…	289.6	678.3	652.0
2008	912.4	2,537.1	43.8	463.9	112.5	351.4	1,359.1	225.8	…	360.8	772.5	670.3
2009	484.2	2,816.9	59.1	622.0	140.1	481.9	1,559.4	290.4	…	486.9	782.1	576.5
2010	428.8	3,256.9	96.6	693.8	194.2	499.6	1,832.0	460.2	…	536.4	835.5	634.5
2011	133.9	3,325.1	102.0	740.2	296.0	444.3	1,908.2	592.8	…	473.5	841.9	574.7
2012	248.8	3,705.1	117.8	986.6	666.3	320.3	1,760.6	453.4	…	436.8	870.4	840.0
2013	363.7	4,102.6	147.5	1,192.6	650.8	541.7	1,963.2	472.9	…	493.9	996.5	799.3
2012	248.8	3,705.1	117.8	986.6	666.3	320.3	1,760.6	453.4	…	436.8	870.4	840.0
2013	363.7	4,102.6	147.5	1,192.6	650.8	541.7	1,963.2	472.9	…	493.9	996.5	799.3
2014	297.3	4,276.6	174.6	1,274.7	1,024.4	250.3	2,081.5	512.4	…	524.8	1,044.3	745.9
2015	94.6	4,519.2	211.5	1,388.8	1,086.3	302.4	2,057.9	485.8	…	492.8	1,079.3	861.0

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34b%20International%20Investments%20Position.xls

10.2. Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare - Sipas sektorëve

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare NETO											
	Gjithsej	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës			Bankat			Qeveria			Sektorët tjerë		
			Asetet	Detyrimet		Asetet	Detyrimet		Asetet	Detyrimet		Asetet	Detyrimet
2007	1,254.2	1,057.6	1,057.6	…	319.9	368.5	48.6	…	…	…	-123.3	971.1	1,094.4
2008	912.4	1,110.7	1,110.7	…	318.1	401.3	83.2	…	…	…	-516.4	1,025.0	1,541.4
2009	484.2	1,089.3	1,149.6	60.3	427.3	583.9	156.7	-249.0	…	249.0	-783.3	1,083.4	1,866.7
2010	428.8	1,129.0	1,194.8	65.9	488.0	709.8	221.8	-260.0	…	260.0	-928.1	1,352.2	2,280.3
2011	133.9	1,114.8	1,181.3	66.4	479.1	675.5	196.4	-253.6	…	253.6	-1,206.4	1,468.4	2,674.8
2012	248.8	1,351.9	1,416.8	65.0	458.0	633.6	175.6	-336.5	…	336.5	-1,224.5	1,654.7	2,879.3
2013	363.7	1,497.2	1,559.3	62.1	540.2	748.3	208.1	-321.8	…	321.8	-1,351.9	1,794.9	3,146.9
2012	248.8	1,351.9	1,416.8	65.0	458.0	633.6	175.6	-336.5	…	336.5	-1,224.5	1,654.7	2,879.3
2013	363.7	1,497.2	1,559.3	62.1	540.2	748.3	208.1	-321.8	…	321.8	-1,351.9	1,794.9	3,146.9
2014	297.3	1,247.3	1,313.7	66.3	481.6	715.8	234.2	-326.4	…	326.4	1,105.2	2,247.1	3,352.3
2015	94.6	1,328.1	1,398.7	70.6	480.9	740.0	259.1	-371.2	…	371.2	-1,343.3	2,380.5	3,723.8

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34c%20International%20Investment%20Position%20-%20by%20sectors.xls

10.3.1 Pozicioni i investimeve ndërkombëtare – asetet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	PIN Neto	Asetet ndërkombëtare të Kosovës								
			Ekuitetet			Borxhi				
				Investimet jashtë vendit	Letrat me vlerë të kapitalit		Investimet jashtë vendit	Letrat me vlerë të borxhit	Investimet Tjera	Asetet Rezervë
2007	1,254.2	2,397.2	174.1	15.2	158.9	2,223.1	0.0	285.5	1,285.6	652.0
2008	912.4	2,537.1	152.9	40.4	112.5	2,384.2	3.4	351.4	1,359.1	670.3
2009	484.2	2,816.9	191.7	51.6	140.1	2,625.2	7.4	481.9	1,559.4	576.5
2010	428.8	3,256.9	280.6	86.4	194.2	2,976.3	10.2	499.6	1,832.0	634.5
2011	133.9	3,325.1	398.0	102.0	296.0	2,927.1	…	444.3	1,908.2	574.7
2012	248.8	3,705.1	784.2	117.8	666.3	2,920.9	…	320.3	1,760.6	840.0
2013	363.7	4,102.6	786.2	135.4	650.8	3,316.4	12.1	541.7	1,963.2	799.3
2012	248.8	3,705.1	784.2	117.8	666.3	2,920.9	…	320.3	1,760.6	840.0
2013	363.7	4,102.6	786.2	135.4	650.8	3,316.4	12.1	541.7	1,963.2	799.3
2014	297.3	4,276.6	1,186.3	161.9	1,024.4	3,090.3	12.6	250.3	2,081.5	745.9
2015	94.6	4,519.2	1,284.9	198.6	1,086.3	3,234.3	13.0	302.4	2,057.9	861.0

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34e%20IIP%20Assets%20and%20Liabilities.xls

10.3.1 Pozicioni i investimeve ndërkombëtare – detyrimet

(Në milionë euro: Fundi i periudhës)

Përshkrimi	PIN Neto	Detyrimet							
			Kapitali ndërkombëtar			Borxhi ndërkombëtar			
				Investimet direkte	Kapitali dhe aksione të fondeve investive		Investimet direkte	Instrumentet e borxhit	Investimet Tjera
2007	1,254.2	1,143.0	621.2	621.2	…	521.8	303.2	…	218.6
2008	912.4	1,624.6	886.5	886.5	…	738.1	407.8	…	330.3
2009	484.2	2,332.7	1,139.4	1,139.4	…	1,193.3	450.4	…	742.9
2010	428.8	2,828.0	1,455.3	1,455.3	…	1,372.8	515.8	…	857.0
2011	133.9	3,191.2	1,760.7	1,760.7	…	1,430.5	565.4	…	865.1
2012	248.8	3,456.3	1,938.4	1,938.4	…	1,517.8	585.9	…	931.9
2013	363.7	3,738.8	2,129.9	2,129.9	…	1,608.9	686.5	…	922.4
2012	248.8	3,456.3	1,938.4	1,938.4	…	1,517.8	585.9	…	931.9
2013	363.7	3,738.8	2,129.9	2,129.9	…	1,608.9	686.5	…	922.4
2014	297.3	3,979.3	2,241.4	2,241.4	…	1,737.9	720.0	…	1,017.9
2015	94.6	4,424.7	2,492.3	2,492.3	…	1,932.4	777.8	…	1,154.6

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: **http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34e%20IIP%20Assets%20and%20Liabilities.xls**

11.1. Borxhi i jashtëm – pozicioni bruto

(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës – dhjetor 2015)

Përshkrimi	Gjithsej borxhi i jashtëm bruto															Investimet direkte: kreditimi në mes të kompanive
		Borxhi publik dhe borxhi publik i garantuar							Borxhi i sektorit privat i pagarantuar							
			Qeveria			Banka Qendrore e Republikës së Kosovës				Korporata depozituese, me përjashtim të Bankës Qendrore			Sektorë tjerë			
				Afat shkurt	Afat gjatë		Afat shkurt	Afat gjatë			Afat shkurt	Afat gjatë		Afat shkurt	Afat gjatë	
2007	520.6	-	-	-	-	-	-	-	520.6	48.6	48.6	-	168.8	141.1	27.7	303.2
2008	736.6	-	-	-	-	-	-	-	736.6	83.2	83.2	-	245.6	194.5	51.1	407.8
2009	1,191.4	309.3	249.0	-	249.0	60.3	0.8	59.5	882.1	156.7	156.7	-	275.0	221.2	53.8	450.4
2010	1,371.5	325.9	260.0	-	260.0	65.9	1.7	64.2	1,045.6	221.8	221.8	-	308.0	232.7	75.4	515.8
2011	1,428.4	320.0	253.6	-	253.6	66.4	0.7	65.7	1,108.4	196.4	196.4	-	346.6	259.8	86.8	565.4
2012	1,517.3	401.4	336.5	-	336.5	65.0	0.4	64.6	1,115.9	175.6	175.6	-	354.4	321.0	33.5	585.9
2013	1,608.2	383.9	321.8	-	321.8	62.1	0.3	61.9	1,224.3	208.1	208.1	-	329.7	281.1	48.5	686.5
2014	1,737.1	392.8	326.4	-	326.4	66.3	0.3	66.1	1,344.3	234.2	234.2	-	390.1	294.8	95.3	720.0
2015	1,931.5	441.8	371.2	-	371.2	70.6	0.1	70.5	1,489.7	259.1	259.1	-	452.8	313.8	139.0	777.8

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34i%20Gross%20External%20Debt%20Position.xls

11.2. Plani i kthimit të Borxhit të Jashtëm Publik

(Në milionë euro: Gjendja më 31 dhjetor 2015)

Përshkrimi	Një vit ose më pak (disa muaj)						Mbi një vit deri në dy vite			Viti i tretë	Viti i katërt	Viti i pestë	Mbi 5 vite deri në 10 vite	Mbi 10 vite deri në 15 vite	Mbi 15 vite
		I menjëher-shëm	0 - 3	4-6	7 - 9	10 - 12		13 - 18	19 - 24						
Borxhi i Jashtëm i Sektorit Publik	71.0	-	22.5	12.7	23.1	12.7	63.3	31.7	31.6	24.9	37.9	33.3	99.5	78.9	90.6
Kryegjëja	63.3	-	18.8	12.4	19.6	12.4	56.5	28.2	28.2	18.8	32.3	28.3	81.3	71.1	90.2
Interesi	7.7	-	3.6	0.3	3.5	0.3	6.8	3.4	3.3	6.1	5.6	5.0	18.2	7.8	0.3
Borxhi i Jashtëm i Sektorit Privat i Garantuar nga Qeveria	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kryegjëja	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Interesi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	71.0	-	22.5	12.7	23.1	12.7	63.3	31.7	31.6	24.9	37.9	33.3	99.5	78.9	90.6
Kryegjëja	63.3	-	18.8	12.4	19.6	12.4	56.5	28.2	28.2	18.8	32.3	28.3	81.3	71.1	90.2
Interesi	7.7	-	3.6	0.3	3.5	0.3	6.8	3.4	3.3	6.1	5.6	5.0	18.2	7.8	0.3

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34i%20Public%20Sector%20Debt%20Service%20Payment.xls

11.3. Borxhi i Jashtëm Bruto - Sipas kreditorëve

(Në milionë euro: Gjendja më 31 dhjetor 2015)

Përshkrimi	Gjithsej borxhi i jashtëm bruto						
		Borxhi i jashtëm bruto përjashtuar investimet direkte					Investimet Direkte: Kreditimi ndërmjet kompanive
			Qeveria	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	Korporata Depozituese, me përjashtim të Bankës Qendrore	Sektorët tjerë	
Fondi Monetar Ndërkombëtar	198.2	198.2	127.7	70.5	-	-	-
Banka Botërore	209.8	209.8	209.8	-	-	-	-
BNRZH	181.0	181.0	181.0	-	-	-	-
SHNZH	28.9	28.9	28.9	-	-	-	-
Kreditorët tjerë	1,523.4	745.6	33.6	0.1	259.1	452.8	777.8
Gjithsej Borxhi	1,931.5	1,153.7	371.2	70.6	259.1	452.8	777.8

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34h%20Gross%20External%20Debt%20Statistics%20-%20by%20creditors.xls

11.4. Pozicioni Neto i Borxhit të Jashtëm

(Në milionë euro: Gjendja më 31 dhjetor 2015)

Përshkrimi	Borxhi i jashtëm bruto (1)	Asetet e jashtme në instrumente borxhi (2)	Borxhi i jashtëm neto (3)=(1)-(2)
Qeveria e përgjithshme	371.2	0.0	371.2
Afatshkurtër	...	...	...
Afatgjatë	371.2	0.0	371.2
Alokimet e drejtës speciale të tirazhit (DST-të)	...	...	...
Valuta dhe depozita	...	...	...
Letra me vlerë të borxhit	...	...	...
Kreditë	371.2	0.0	371.2
Kreditë tregtare dhe paradhëniet	...	...	...
Instrumente tjera të borxhit	...	...	...
Banka Qendrore	70.6	1,398.7	-1,328.1
Afatshkurtër	0.1	1,316.9	-1,316.8
Valuta dhe depozita	0.1	1,189.8	-1,189.7
Letra me vlerë të borxhit	0.0	127.1	-127.1
Kreditë	...	...	...
Kreditë tregtare dhe paradhëniet	...	...	...
Instrumente tjera të borxhit	...	...	...
Afatgjatë	70.5	81.8	-11.3
Alokimet e drejtës së tirazhit (DST-të)	70.5	81.8	-11.3
Valuta dhe depozita	...	...	...
Letra me vlerë të borxhit	...	...	...
Kreditë	...	...	...
Kreditë tregtare dhe paradhëniet	...	...	...
Instrumente tjera të borxhit	...	...	...
Korporata depozituese, me përjashtim të Bankës Qendrore	259.1	740.0	-480.9
Afatshkurtër	259.1	740.0	-480.9
Valuta dhe depozita	170.7	400.8	-230.1
Letra me vlerë të borxhit	0.0	247.2	-247.2
Kreditë	85.9	88.6	-2.7
Kreditë tregtare dhe paradhëniet	0.0	0.0	0.0
Instrumente tjera të borxhit	2.4	3.4	-1.0
Afatgjatë	...	...	...
Sektorë tjerë	452.8	1,082.7	-629.9
Afatshkurtër	313.8	12.6	301.2
Valuta dhe depozita	0.0	0.0	0.0
Letra me vlerë të borxhit	0.0	0.0	0.0
Kreditë	146.0	0.0	146.0
Kreditë tregtare dhe paradhëniet	167.8	12.6	155.2
Instrumente tjera të borxhit	0.0	0.0	0.0
Afatgjatë prej të cilave:	139.0	1,070.1	-931.0
Valuta dhe depozita	0.0	1,066.7	-1,066.7
Letra me vlerë të borxhit	0.0	3.4	-3.4
Kreditë	139.0	0.0	139.0
Investimet Direkte: Kreditimi ndërmjet kompanive	777.8	0.0	777.8
Detyrime borxhi të ndërmarrjeve të investimit direkt ndaj investitorëve direktë	…	...	...
Detyrime borxhi të investitorëve direktë ndaj ndërmarrjeve të investimit direkt	777.8	0.0	777.8
Detyrime borxhi ndaj ndërmarrjeve të lidhura	…	...	...
Borxhi i Jashtëm NETO (3)	1,931.5	3,221.4	-1,289.9

Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjinden në linkun: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/time_series/34g%20Net%20External%20Debt%20Position.xls.

10. Referencat

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2016): Statistikat Ekonomike;

European Commission (2016): EU Candidate and Pre-Accession Countries; Economic Quarterly 3, Economic and Financial Affairs;

European Commission (2016): Eurostat Database;

European Central Bank (2016): Monthly Bulletin, European Central Bank, Frankfurt.

International Monetary Fund (2016): World Economic Outlook, WOE Database;

International Monetary Fund (2016): World Economic Outlook, WOE Report;

International Monetary Fund: Global Financial Stability Report, 2016;

Ministria e Financave (2015): Raporti gjashtëmujor i të hyrave dhe shpenzimeve;

ASK (2015):

a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në maj 2015:
http://ask.rks gov.net/cmimet/publikimet/cat_view/988-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-

b)Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në maj 2015:
http://ask.rks-gov.net/cmimet/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-

c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në maj 2015:
http://ask.rks-gov.net/cmimet/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-

d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në maj 2015:
http://ask.rks-gov.net/publikimet/cat_view/12-regjistri-statistikor-i-bizneseve

e) Statistikat ë tregtise së jashtme, qasur në shkurt 2015:
http://ask.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet

f) Llogaritë kombëtare: http://ask.rks-gov.net/llogarite-kombetare/ll-kombetare

European Commission.

FMN (2016): World Economic Outlook 2016, International Monetary Fund (IMF): 2015: http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2015/01/weodata/index.aspx

Ministria e Financave.

Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763
Web:www.bqk-kos.org